



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 13 PRILL 2023, TIRANË

**PROCESVERBAL**

**SEANCËN E DREJTON**  
**KRYETARJA E KUVENDIT**  
**LINDITA NIKOLLA**  
*(Seanca filloi në orën 10:00)*

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 30.03.2023 *(neni 44, pika 2 e Rregullores)*
2. Njoftime *(neni 44, pika 3 e Rregullores)*
3. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar”” *(në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*  
Pyetje  
Shprehet nismëtari.  
Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

4. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë””, i ndryshuar”” *(në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 e Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Integrimin Europian.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

5. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), (agjencia e zbatimit të projektit), për projektin “Zhvillimi i integruar rajonal”” *(në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç” e Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

6. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për ndërtimin e urës ndërkufitare mbi lumin Buna/Bojana *(në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

*(Shprehen grupet parlamentare.)*

Koha e votimit

7. Projektvendimi “Për miratimin e fondit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023 *(në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe nenit 88, pika 1 e ligjit nr. 10 019, datë 28.12.2008,*

*“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” dhe neni 55 i Rregullores së Kuvendit)*

8. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (60’)

**Lindita Nikolla** – Mirëdita!

Hapim seancën plenare.

Ju lutem, kolegë, zini vendet!

Në bazë të nenit 30 të Rregullores, ju bëj të njohur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

*(Pasi lexon rendin e ditës.)*

Fillojmë me çështjen e parë, sipas rendit të ditës: miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 30.03.2023. Procesverbalin e keni marrë në rrugë elektronike. A ka vërejtje për të? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te njoftimet.

Ju njoftoj se në Kuvend gjatë kësaj jave janë depozituar 6 akte nga Këshilli i Ministrave dhe 1 akt i propozuar nga 20 mijë zgjedhës. Titujt e çështjeve të depozituara do t'i gjeni në sistemin e sallës, ndërsa materialet në sistemin *e-Parlament* dhe në faqen e Kuvendit në internet.

Ju njoftoj se sot u mbledh Konferenca e Kryetarëve, ku u diskutua kërkesa e 35 deputetëve të opozitës së Kuvendit të Shqipërisë për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit “Për verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura nga institucionet shtetërore për verifikimin e projektit të investitorit të portit të Durrësit, për negociimin dhe ruajtjen e interesit publik, si dhe lidhjen e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe “*Eagle Hills Real*” “*Estate Development*”, “*Albanian Seaports Development Company*” sh.a., dhe “*Nshmi Development LLC*”. Konferenca e Kryetarëve nuk e arriti konsensusin për ngritjen e komisionit hetimor dhe, në bazë të pikave 2 dhe 3 të nenit 7 të ligjit nr. 8891, datë 02.05.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, përcaktohet se, kur Konferenca nuk arrin t'i përcaktojë elementet e mësipërme me konsensus, këto çështje i adresohen seancës plenare, e cila vendos me shumicën e anëtarëve të pranishëm; kërkesa paraqitet për miratim në seancën plenare më të afërt, por jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve.

Për sa më lart, çështja i është adresuar seancës së sotme plenare, datë 13.04.2023, ku do të vendoset me shumicën e anëtarëve të pranishëm, pas diskutimeve për çështjet e rendit të ditës. Përpara fillimit të votimit do të dëgjohen një folës pro dhe një folës kundër për ngritjen e komisionit hetimor.

Gjithashtu, në Konferencën e Kryetarëve u diskutua edhe propozimi i kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste që në program dhe në kalendar të shtohen edhe tri projektligje të depozituara në Kuvend nga Këshilli i Ministrave, konkretisht: projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, i ndryshuar”; projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, si dhe projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e *start up-ve*””. Të tria projektligjet kanë një afat ligjor të përcaktuar për t'i shtrirë efektet dhe për këtë arsye është kërkuar të miratohen sa më shpejt dhe shqyrtimi i tyre të bëhet duke zbatuar afatet e përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit. Ky propozim nuk pati mirëkuptim, ndaj, në bazë të Rregullores së Kuvendit, vendimi i kalon seancës plenare për miratim.

Votimi është i hapur, me kartonë.

Ju lutem, kolegë, kush është dakord me shtesat e propozuara në program dhe në kalendar? Kundër? Abstenim?

Miratohet me 54 vota pro.

Vijojmë me rendin e ditës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zonja Elisa Spiropali, e keni kërkuar fjalën?

Sepse shikoj që është shtypur dhe më ka dalë këtu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord.

Zoti Tritan Shehu.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ndjesë! Pas zotit Tritan.

**Tritan Shehu** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Në fakt, kam dy çështje për procedurë.

E para, një shkelje e rëndë e procedurës dhe e Rregullores në parlamentin shqiptar po bëhet shkak për implikime të mëdha politike, ku preken interesat kombëtarë shqiptarë, preket imazhi i Shqipërisë, imazhi i Kosovës dhe, realisht, po bëhet shkak edhe për ngritjen e akuzave kaq të rënda ndaj drejtuesve të UÇK-së në Hagë.

Zonja Kryetare, duke shkelur procedurën dhe Rregulloren tonë, me apo pa dashje, ne krijojmë dëme të mëdha të imazhit, të së drejtës

shqiptare, të asaj me të cilën ne duhet të ballafaqohemi ndaj krimeve që janë bërë në kurriz të shqiptarëve.

E kam thënë edhe herët e tjera që ne kemi paraqitur prej muajsh kërkesën për të diskutuar në këtë parlament mocionin me debat dhe me rezolutë për ta njohur dhe për ta dënuar gjenocidin serb në Kosovë në vitet '90. Në shkelje të plotë të procedurës dhe të Rregullores, nuk është bërë asnjë veprim i tillë dhe nuk është sjellë në seancë plenare qoftë për miratim, qoftë edhe për të mos u miratuar, siç thuhet edhe në Rregullore.

Në një kohë kur në Hagë po kërkohet të dënohen drejtuesit e UÇK-së për krime kundër njerëzimit, për krime lufte, për gjenocid, ne këtu nuk kemi guxim të vëmë gishtin për atë çfarë ka ndodhur realisht, për gjenocidin serb në Kosovë. Pra, dominon shpifja, dominon e pavërteta për t'i njollosur shqiptarët për gjenocidin. Edhe në këtë rast ne nuk themi që serbët në Kosovë në atë periudhë kanë bërë gjenocid, i cili duhet dënuar, duhet njohur. Qeveria shqiptare duhet autorizuar që ta mbështesë qeverinë e Kosovës për ngritjen e asaj çështjeje në Gjykatën Ndërkombëtare, sepse Kosova nuk mund ta bëjë, pasi nuk është anëtare e OKB-së. Ne rrimë, flemë, shkelim procedurën, shkelim Rregulloren dhe dëmtojmë realisht imazhin e shqiptarëve, lejojmë të ndyhet lufta çlirimtare e Kosovës, një luftë heroike.

E dyta, zonja Kryetare, ju sot keni një projektvendim për shpërndarjen e fondeve të partive politike për zgjedhjet. Është një vjedhje masive, një korrupsion masiv dhe kjo çështje nuk mund të kalojë pa u diskutuar në parlament, sepse është krijuar një zallamahi, një situatë ku po përfitohen padrejtësisht nga "disa paterica" para që janë realisht për fushatën zgjedhore. Ky është një mashtrim i tyre dhe një vjedhje e qeverisë për t'i paguar ata. Kjo është e vërteta! Nëse ju nuk do ta fusni në seancë diskutimin e kësaj çështjeje, unë do t'i harxhoj 10 minutat që kam në dispozicion për pikën e taksave për të diskutuar këtë problem.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Zonja Zhupa, fjala për ju.

**Ina Zhupa** – E nderuar Kryetare,

Ne kemi ardhur në këtë seancë pas "Javës së gjelbër", ku kemi zhvilluar takime me qytetarët, por pavarësisht se në Rregulloren e këtij Kuvendi është e përcaktuar që pas "Javës së gjelbër" ne duhet të kemi një seancë të posaçme për të diskutuar për çështjet e zgjedhësve, është hera e

dytë radhazi që ju nuk e bëni këtë. Kur them hera e dytë, do të thotë se prej dy muajsh nuk diskutohet për çështjet e zgjedhësve. Kaluan 3 javë dhe "Java e gjelbër", kaluan 3 javë të tjera dhe sërish "Java e gjelbër", pra prej 8 javësh ne nuk diskutojmë në këtë parlament për çështjet e zgjedhësve. Herën e parë thatë se nuk kishim kuorum, ndërkohë që kjo çështje është shumë e zgjidhshme, sepse, sa herë që kemi seancë të enjteve, mund të bëhen dy seanca rresht; në seancën e parë 4 orë mund t'u dedikohen çështjeve të zgjedhësve, dhe më pas të vijohet normalisht. Këtë javë kishit si justifikim pushimin zyrtar. E hëna është pushim, por ditët e tjera të javës janë të gjitha të mundshme për t'i shfrytëzuar për të mbledhur seancën plenare për çështjet e zgjedhësve.

Unë e di shumë mirë që çështjet e zgjedhësve nuk janë shqetësimi juaj i parë, por nuk mund ta merrni kohën tonë, kohën e opozitës. Ne kemi të drejtë, sipas Rregullores, për të diskutuar për çështjet e elektoratit, të zgjedhësve tanë, për problematikat e zonave, për të ngritur zërin për ta dhe për t'i thënë qeverisë këtu, e cila ndoshta nuk i njeh shumë problematikat, sepse jeton në një realitet virtual të aktivistit, se cili është realiteti. Këtë nuk mund të na i mohoni për dy muaj, në shkelje flagrante të Rregullores së Kuvendit.

Çështja e dytë që dua të adresoj, është akti i pashembullt terrorist i ndodhur ndaj kryetarit të Partisë Demokratike, në degën e Vaut të Dejës, i cili është sulmuar me tritol për eliminim fizik. Kjo hapje e fushatës elektorale ishte e padëgjuar ndonjëherë në historinë e Shqipërisë dhe në vendet demokratike. Në nisje të fushatës, për shkak të funksioneve të tij politike, sulmohet një kryetar dhe një drejtues i lartë i Partisë Demokratike.

Ky parlament duhet të distancohet. Ministri i Brendshëm duhet të na thotë se si po vijojnë hetimet, se kush është sot para drejtësisë dhe nëse u gjetën autorët dhe porositësit. Nëse keni ndër mend ta bëni në këtë mënyrë fushatën elektorale, i keni bërë llogaritë gabim! Përgjigjen e merituar do ta merrni. Demokratët, opozitarët nuk tremben. Nuk mund të na kërcënoni dhe të na intimidoni. Hiqni dorë nga këto metoda dhe distancohuni sot publikisht nga kjo ngjarje!

Shumë faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Zoti Shalsi, urdhëroni!

**Eduard Shalsi** – Zonja Kryetare,

Në emër të grupit që ka firmosur amendimet për ndryshimet e ligjit për taksat kombëtare, do të doja t'i kërkoja parlamentit, për shkak të sqarimit të dy-tri elementeve, që ta sponstionim diskutimin për taksat kombëtare në seancën e ardhshme.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Kush është dakord për ta tërhequr nga rendi i ditës projektligjin “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar”?”

*(Diskutime pa mikrofon)*

Patjetër, por qetësohu!

Për këtë çështje nuk e kërkoi askush fjalën.

Po, zonja Tabaku.

**Jorida Tabaku** – Zonja Kryetare,

Projektligji “Për taksat kombëtare” është depozituar prej kohësh nga qeveria pa asnjë konsultim në Komisionin e Ekonomisë. Projektligji është klientelist, sepse prek vetëm një prodhues, kremin “barista” dhe hurrën e qumështit, që, në fakt, i shërben një grupi aq të vogël njerëzish, sa që mund t’ia vendosësh emrin projektligjit pa ardhur ende këtu.

Ne kemi nevojë të diskutojmë se si mund t’i ndihmojë ekonomia fermerët në përgjithësi. Projektligjet me porosi dhe amendimet po me porosi, që vijnë në parlament, mund t’i miratoni e t’i kaloni vetë. Besoj se parlamenti sot ka nevojë të dëgjojë se çfarë skeme incentivimi po bëhet për fermerët, se si ndihmon kjo skemë për t’i rritur dhe për t’i nxitur eksportet, si ndihmon skema aktuale me pagesën e TVSH-së, njëkohësisht edhe me mungesën e rimbursimit për fermerët, për të nxitur ekonominë e fshatit, sepse jemi në një periudhë shumë të vështirë. Diskutimet individuale për një projektligj që prek një prodhues, besoj se ky parlament duhet të ketë turp t’i diskutojë!

Faleminderit!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

**Lindita Nikolla** – Po, zoti Shalsi.

**Eduard Shalsi** – Keqardhje shumë të madhe për zonjën Tabaku, e cila në rastin më të mirë është krejtësisht e painformuar dhe në rastin më të keq po deformon!

Së pari, do të të ftoja të ishe në mbledhjet e komisionit dhe në takimet me grupet e interesit, ku kemi qëndruar deri natën vonë për t’i dëgjuar.

Përmende termin “barista”, që do të thotë se nuk e ke fare idenë se për çfarë po diskutojmë.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Të lutem!

Nëse donit të bënit një shërbim, së paku duhet të merrnit pjesë në diskutimet e Komisionit të Ekonomisë.

Po jua përsëris: kemi zhvilluar disa takime me grupe të ndryshme interesi, kemi debatuar gjatë me ta, kemi vizituar edhe mjediset e tyre. Duam të sigurohemi që po korrektojmë një gabim që është bërë dhe arsyeja e shtyrjes është pikërisht sepse në momentin e fundit kemi marrë edhe një shqetësim, për të cilin ne jemi shumë të ndjeshëm. Së paku, duhej të ishit seriozë. Nëse jeni të shqetësuar, ejani në tryeza, sepse kemi zhvilluar një numër të konsiderueshëm takimesh dhe debatesh, të cilat i keni refuzuar, nuk keni marrë pjesë dhe kujtoheni ditën e seancës për të bërë sikur mbroni. Cilin? Çfarë?

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk ka. Ky ndryshim ka një qëllim të qartë. Nuk kemi rënë dakord për aspektin teknik, por synimi është të korrektohet një gabim i bërë. Kaq e thjeshtë është; lehtësisht e provueshme!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ne nuk kemi droje të pranojmë dhe të korrektojmë një gjë që nuk është bërë mirë. Ky është ndryshimi. Ju jeni të pagabueshëm!

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Duhet të vini në komision, në vizita dhe në debate. Mos hidhni disa shashka këtu në momentin e fundit. Për çfarë?! Më vjen jashtëzakonisht keq!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit, zoti Shalsi!

E hedhim në votim. Kush është dakord për shtyrjen?

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Jo, nuk do të bëjmë diskutim. Foli një folës pro dhe një folës kundër.

Kush është dakord me shtyrjen e projektligjit “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar”?”

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

Kush është kundër? Janë 7 vota kundër.

Miratohet shtyrja e projektligjit “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar”.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

I kam përpara ekranit. Ju lutem, më lejoni të ndjek radhën!

Fjala për zonjën Andia Ulliri.

Përmbajuni procedurës, zonja Ulliri!

**Andia Ulliri** – Zonja Kryetare,

Pashë që në rendin e ditës së sotme do të diskutohet për disa projektligje që kanë të bëjnë me infrastrukturën dhe dua të sjell në vëmendjen e parlamentit që në këta 6-7 muajt e fundit banorët e Bërxullës kanë dalë në protestë çdo të diel dhe deri më sot nuk ka pasur asnjë reagim nga ana e qeverisë për shqetësimin e tyre për projektin Thumanë-Kashar, përkatësisht për mungesën e transparencës dhe të përgjegjësisë për këtë projekt, për shpronësimet që do të ndërmerren, duke cenuar të drejtat e tyre dhe duke mos garantuar sigurinë e pronës dhe sigurinë e banorëve...

**Lindita Nikolla** – Ju lutem, kjo nuk është fjalë për procedurë, zonja Ulliri!

**Andia Ulliri** – Ju lutem, zonja Kryetare, mos ma ndërprisni fjalën!

**Lindita Nikolla** – Ju lutem, duhet t'i përmbaheni procedurës!

**Andia Ulliri** – Po sjell në këtë parlament një çështje shumë të rëndësishme, për të cilën 140 deputetë nuk kanë guxuar ende të flasin. Është e papranueshme dhe e patolerueshme që banorët, të cilët kanë 6-7 muaj që dalin në protestë, të përballen me dhunën policore dhe të mos marrin asnjë përgjigje nga asnjë institucion, nga asnjë ministri dhe nga asnjë drejtues i kësaj qeverie për një projekt të këtij standardi dhe të kësaj rëndësie kombëtare.

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjala për zotin Taulant Balla.

**Taulant Balla** – Zonja Kryetare...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Lindita Nikolla** – Ju lutem, nuk ishte procedurë! E tha thelbin e fjalës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E di unë, sepse dëgjoj dhe reflektoj mbi bazën e Rregullores.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Patjetër! Në Rregullore është e përcaktuar kur merret fjala për procedurë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Balla, ju lutem, përmbajuni procedurës!

**Taulant Balla** – Gazi, vetëm përpara!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kurrë mbrapa, Gazi, kurrë mbrapa; vetëm përpara!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Lindita Nikolla** – Ju lutem, zoti Balla, përmbajuni procedurës!

**Taulant Balla** – Për sa i përket asaj që u propozua ose u kërkua nga deputeti Shehu në mënyrë të përsëritur, besoj se Kuvendi i Shqipërisë e ka adresuar këtë çështje. Madje, Kuvendi i Shqipërisë, edhe falë anëtarëve të delegacionit tonë në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës, dhe këtu nuk dua të bëj ndarje, mazhorancë apo opozitë, sepse atje jemi të gjithë bashkë, në një shprehje kuptimplotë të asaj që Kuvendi ka miratuar, për iniciimin në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës, si një rezolute e re, e lidhur me pretendimet se gjatë luftës çlirimtare në Kosovë gjoja paska pasur trafik organesh apo krime të tjera, ndaj gjej rastin t'i përshëndes dhe t'i mbështes anëtarët e delegacionit që të shkojnë përpara me këtë iniciativë.

E dyta, zonja Kryetare, besoj se të gjithë jemi në dijeni se ditën e djeshme qeveria e Kosovës ka miratuar 14 prillin si ditë memoriale të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës, e cila mund të ishte një çështje që mund të ngrihej nga opozita. Megjithatë, unë mendoj se Kuvendi i Shqipërisë, por edhe institucione të tjera shtetërore shqiptare gjatë kësaj dite duhet të organizojnë aktivitete, si shprehje e solidaritetit tonë me nënat e motrat kosovare, të cilat vuajtën dhe vuajnë akoma pasojat e asaj dhune gjatë luftës në Kosovë.

Unë u lutem shumë deputetëve të opozitës të mos bëjnë më histori dhe politikë me çështjet e Kosovës në Kuvendin e Shqipërisë. Kemi miratuar së bashku një rezolutë, ndaj t'i qëndrojmë asaj rezolute, gjithashtu, të mbështesim delegacionin tonë në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës për të shkuar përpara me procedurën. Firmat mbështetëse janë mbledhur nga më shumë se 5 vende, që është kriteri bazë, ndaj të ecim përpara me atë rezolutë.

Kur kalojmë nga Kosova te paratë e fushatës, pastaj gjëja bëhet shumë groteske, nga ata që e ngrenë si çështje. Sugjerimi im është që të bëni edhe ju siç po bëjmë ne. Kjo fushatë nuk ka nevojë për postera...

**Lindita Nikolla** – Ju lutem, zoti Balla, kjo nuk është procedurë.

**Taulant Balla** – Por pjesën më të madhe të parave t'i shpenzoni për mjedisin duke mbjellë pemë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjalën e ka zoti Alibeaj.

**Enkelejd Alibeaj** – Faleminderit, zonja Kryetare!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Lindita Nikolla** – Të mbarojë zoti Alibeaj.

**Enkelejd Alibeaj** – Me sa duket, ju keni vendosur t’i vendosni kazmën këtij parlamenti. Një deputeteje ia hiqni fjalën, duke mos e lënë ta çojë deri në fund për të kuptuar se cila është kërkesa për procedurë.

Ngrihet një deputet i mazhorancës dhe heq një çështje nga rendi i ditës, pa dhënë asnjë shpjegim, ndërkohë që të gjithë deputetët e tjerë janë përgatitur ta diskutojnë.

Për ta bërë të plotë panoramën, ju keni edhe një detyrim që nuk e bëtë në fillim të seancës, të bëni me dije se çfarë ndodhi në Konferencën e Kryetarëve, por e kaluat duke thënë: “Një kërkesë për ngritjen e komisionit hetimor nuk mori konsensusin e Konferencës”. Në fakt, ju keni detyrim t’i bëni me dije seancës, meqenëse çështja kalon në seancë, arsyet e vërteta përse u vendos në atë mënyrë dhe përse nuk kishte konsensus. Nëse nuk e bëtë ju, atëherë po e bëj unë në mënyrë që të ngrihen e të diskutojnë të gjithë deputetët nënshkrues të komisionit hetimor dhe prisja që ndonjëri prej tyre ta ngrinte si pretendim. Për dy apo tre rastet e tjera arsyeja është bërë me dije.

Arsyeja është fare e thjeshtë. Nga kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste ngrihet si justifikim se, meqë parlamenti ka ndër mend të bëjë një ligj të ri për komisionet hetimore, të gjitha kërkesat për komisione hetimore nuk pranohen. Ndërkohë që Kushtetuta është e qartë, në rastet kur ky parlament ka detyrimin, jo të drejtën për të ngritur një komision hetimor, mjafton të ketë nënshkrimet, të cilat janë, siç u pranua në Konferencë, të ketë një objekt sipas parashikimit kushtetues, të ketë të përcaktuar afatet dhe përbërjen. Kjo është panorama, të cilën, ju si përfaqësuese e këtij Kuvendi, ulur në atë tryezë, me gjithë barrën që ka mazhoranca, duhej t’u tregonit shqiptarëve se ky parlament ka marrë fund. Është detyrimi juaj për ta mbajtur gjithë këtë përgjegjësi. Kjo ishte kërkesa ime për procedurë, përpara se të më hiqni fjalën, për t’u bërë me dije deputetëve, por, mbi të gjitha, publikut arsyen përse asgjësuar një herë e përgjithmonë të vetmin instrument që opozita ka në dorë për të ushtruar kontrollin parlamentar.

Faleminderit, zonjë!

**Lindita Nikolla** – Fjalën për replikë e ka zoti Shehu. Koha në dispozicion 2 minuta.

**Tritan Shehu** – Zakonisht replika jepet menjëherë pas folësit.

Unë mendoj se kryetari i grupit parlamentar të mazhorancës e tjetërsoi fjalën time.

Nuk e kam fjalën për rezolutën në lidhje me çështjen që kemi diskutuar dhe kemi miratuar të gjithë dhe i është paraqitur Këshillit të Europës, sepse duhet të ecë përpara, por e kam fjalën për njohjen dhe dënimin e gjenocidit serb në Kosovë, siç e ka bërë parlamenti i Kosovës, siç e ka kërkuar Presidentja e Kosovës këtu dhe qeveria e Kosovës, për të neutralizuar sulmet që po bëhen ndaj drejtuesve të UÇK-së, të cilët i akuzojnë për krime kundër njerëzimit, për krime lufte dhe për gjenocid, kur dihet se gjenocidi është bërë nga të tjerët. Ne nuk kemi guximin të ngrihemi e të diskutojmë në parlamentin shqiptar për këtë çështje, ta njohim këtë gjenocid, sepse vetëm ne nuk e kemi njohur, të kërkojmë që qeveria shqiptare të asistojë qeverinë e Kosovës në gjykatat ndërkombëtare, sepse Kosova nuk mundet ta bëjë vetë, në këtë mënyrë ne ekuilibrojmë sulmet e padrejta shpifëse që po bëhen ndaj drejtuesve të UÇK-së.

Ndërsa ne heshtim, Vuçiçi ka aktivizuar të gjithë mekanizmat e tij propagandistikë për të inkriminuar UÇK-në me gënjeshtër. Parlamenti shqiptar hesht dhe nuk guxon ta diskutojë këtë çështje e të dalë me një rezolutë dhe të thotë mendimin e vet për atë që është e vërtetë, sepse, nëse nuk pranohet e vërteta, nëse nuk kërkohet ndjesë ndaj krimeve, ato rrezikojnë të përsëriten. Këtë e tha edhe zoti Borelli qartësisht, ndërsa ne në parlament heshtim duke dëmtuar çështjen kombëtare, imazhin tonë, duke shkelur në këtë mënyrë Rregulloren tonë, procedurën dhe Kushtetutën e Shqipërisë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjalën e ka zoti Ramadan Lika. Ju lutem, përmbajuni procedurës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, jeni në listë, më pas vijë zoti Sula, Bujar Leskaj, Petrit Vasili dhe Edmond Spaho. Këtu mbyllet diskutimet për procedurën.

**Ramadan Likaj** – Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

U bënë 8 javë që nuk na jepet e drejta që ta vazhdojmë seancën për ato çështje që realisht

duhet të vazhdojë: për të qarë hallet e problemet e zonave tona, kërkesat dhe problemet që kanë qytetarët. Unë e kuptoj shumë mirë se në situata të tilla ju e devijoni rendin e ditës për interesa elektorale, që tashmë dihen, por absolutisht nuk mund të mendoj që ky parlament të vazhdojë pa fund duke devijuar rendin e ditës.

Unë sot flas si deputet, i cili, e kam thënë që në krye të herës dhe vazhdoj ta them, nuk do të reshtë për asnjë moment të vetëm të ngrejë zërin për problemet dhe hallet e zonës së tij elektorale.

Ngjarja e fundit që ndodhi në qarkun e Shkodrës, në Vaun e Dejës, është një akt kriminal, ndaj shpresoj dhe besoj, meqenëse është edhe ministri i Brendshëm këtu, që autorët, të cilët bënë një krim kaq të shëmtuar, të marrin ndëshkimin e merituar. Në këtë situatë ku ndodhemi, në vitin 2023, ku të gjithë shqiptarët çdo ditë e më shumë kërkojnë t'i afrohen sa më shumë Bashkimit Europian dhe t'i plotësojmë të gjitha kriteret e tij, mendoj se me akte të tilla ne jo vetëm që nuk afrohem, por bëjmë shumë hapa mbrapa, sa nuk i kuptojmë as ne.

Për sa i përket tërheqjes së projektligjit në momentin e fundit, kur fermerët kanë nevojë për ndihmë më shumë se kurrë, ne e kuptojmë se kjo nuk është një çështje teknike, siç thanë parafolësit, por arsyet dihen. Kjo shtyrje për pas zgjedhjeve, sigurisht është një taktikë tjetër elektorale.

Duhet të përmend edhe një akt tjetër që ka ndodhur dje në Malësinë e Madhe. Mora vesh se kryetari i këshillit bashkiak i Bashkisë së Malësisë së Madhe, një njeri i jashtëzakonshëm, i cili në vitin 2021 ka bërë një luftë jashtëzakonisht të ashpër në zonat e tij elektorale dhe i ka shërbyer për 8 vjet Partisë Socialiste, nuk pranon të përfshihet në fushatë elektorale dhe ndaj tij ka ardhur shkarkimi i menjëhershëm, sikur të ishte në ajër. Këto taktika nuk janë të mira, të nderuar kolegë, nuk i shërbejnë të ardhmes, nuk i shërbejnë stabilitetit, përkundrazi. Sado të ndodhin të tilla situata, në atë bashki dhe në shumë bashki të tjera, me presion nuk mund të arrihet të fitohet.

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjalë për zotin Dashnor Sula. Ju lutem, përmbajuni procedurës.

**Dashnor Sula** – Dakord, asaj që thua ti, zonja Kryetare, do t'i përmbahem.

Faleminderit për këshillën! Sigurisht, si një nxënës i klasës së parë do t'i kem parasysh këshillat!

Zonja Kryetare, meqenëse kryetari i Komisionit të Veprimtarive Prodhuese ishte shumë i shqetësuar për këtë projektligj, i cili është në të mirë të fermerëve, unë kam një pyetje të drejtpërdrejtë për mazhorancën dhe për kryetarin e komisionit. Përse e vendosët taksën e hirrës para një viti, ku efektet në buxhetin e shtetit ishin 170 milionë lekë të vjetër? Pra, ju nuk lini gjë pa rënë në tokë, edhe hirrën, edhe ujin, edhe frymën e taksoni.

Tani, meqenëse kanë dalë probleme, doni ta hiqni këtë taksë. Ne nuk jemi kundër heqjes së kësaj takse, por kur shqetësoheni për taksën e hirrës, përse nuk shqetësoheni edhe për taksat e tjera, si për taksën e qarkullimit të naftës, e cila është motori i ekonomisë, përse nuk hiqni 10% të TVSH-së për pesticidet për të gjithë fermerët, sepse ata vuajnë çdo ditë?

Zonja Kryetare, më 23 dhjetor të vitit 2022 për rialokimin e fondeve të buxhetit të shtetit që kishin tepruar, unë dhe zonja Tabaku paraqitëm një amendament për bujqësinë, që t'i jepeshin asaj 1,7 milionë euro, në një kohë që për rindërtimin dhatë 120 milionë euro, por nuk e morët parasysh. Gjithashtu, paraqitëm një amendament për t'i ulur produktet e shportës nga 20% në 6%, përsëri nuk e morët parasysh.

A e dini ju, zonja Kryetare, se FMN-ja, Banka Botërore, EUROSTAT-i dhe të gjithë organizmat ndërkombëtarë e radhisin Shqipërinë, vetëm Kosovën kemi lënë në vendin e fundit, si vendi më i varfër deri në vitin 2025? Pra, jemi përsëri vendi më i varfër në të gjithë rajonin, qoftë për të ardhurat për frymë, qoftë për konsum dhe për çdo gjë. Më gjeni një raport nga gjithë organizmat ndërkombëtarë ku ju të keni diçka pozitive. Ekonomia shqiptare është në ditët e saj më të këqija. Të jeni të sigurt se rruga që keni nisur është një rrugë pa krye.

Së fundi, për çdo propozim që ka bërë opozita, edhe për rritjen e rrogës, të cilin kemi kohë që e kemi kërkuar, ju kujtoheni ta bëni tani, gjatë periudhës së zgjedhjeve. Pra, ju gënjeni, mashtroni, joshni gjatë fushatës zgjedhore, në një kohë kur kishit të gjithë kohën e nevojshme përpara 2, 3 apo 4 vjetësh, por nuk e bëtë një gjë të tillë. Kjo është për të ardhur keq.



Unë jam i sigurt se parlamentin keni për ta mbyllur dhe deri më 14 maj nuk ka për të pasur më parlament, sepse e keni mendjen te fushata. Jo, more jo, nuk duhet mbyllur, por duhet të bëhet parlament çdo javë sipas kalendarit, në mënyrë që të merremi me problemet e qytetarëve. Edhe kjo seancë, që nuk u bë, për “Javën e gjelbër” duhet bërë, sepse kemi hallin e qytetarëve. Ne në zonat ku jemi përballlemi çdo ditë me hallet e tyre, të cilët thonë: “Mjaft më, mjaft më”.

Zonja Kryetare, ju tërheq vëmendjen juve dhe Konferencës së Kryetarëve që të mos e mbyllni parlamentin, por të vazhdojmë, sepse me Rregullore nuk lejohet ndërprerja e punimeve kur nuk ka arsye.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjalën e ka zoti Bujar Leskaj.

**Bujar Leskaj** – Unë dua të flas vetëm për projektligjin në fjalë, pra vetëm për taksën e hirrës dhe të qumështit.

**Lindita Nikolla** – Jo, duhet të flisni vetëm për procedurë.

**Bujar Leskaj** – Dua të shpjegoj votën time.

Çështja është shumë e thjeshtë, zonja Kryetare, ndaj më vjen shumë keq. Në vitin 2021 vendosët taksën 150 lekë për kilogram, për hirrën dhe për qumështin. Kjo taksë nuk bëri gjë tjetër veç ua shtoi prodhuesve vendas me 5% koston e produkteve, si kroasantë, biskota e të tjera. Tani me të drejtë kujtoheni ta hiqni, pas një viti e ca. Me taksën që vendosët në vitin 2021, në thelb keni favorizuar importuesit, pra një gabim që po përpigjeni ta korrigjoni.

Tani ka 4 muaj që po diskutohet në komision, megjithëse ne deputetët e opozitës munguakemi! Po cilat janë faktet e reja që kjo taksë të mos hiqet dhe prodhuesit vendas, pra ata që eksportojnë, të vendosen në kushte të barabarta me importuesit, sepse për importuesit e kroasantëve, biskotave, çokollatave e të tjera ju e keni të hequr taksën? Ne rëndojmë vetëm prodhuesit vendas.

Unë kam një pyetje për ju, sepse ju merrni informacione konfidenciale dhe sekrete. Mos ndoshta drejtuesit e rinj të shërbimit sekret sollën informacion për taksën e hirrës dhe të qumështit, apo mos ndoshta e sollli ndonjë ndërkombëtar që ka ardhur për të vizituar Tiranën? Kjo nuk ka kuptim. Ndaj më vjen shumë keq.

Më e pakta që mund të bëni, është ta tërhiqni këtë pas 4 muajsh diskutimesh të stërmëdha për taksën e hirrës dhe të qumështit, e cila ka një ndikim modest në buxhetin e shtetit, por ka një ndikim të madh te prodhuesit vendas, qoftë që të konkurrojnë në tregun vendas, qoftë që të eksportojnë, ndërsa ju e kaloni dhe na vendosni edhe ne në pozitë të vështirë.

Zonja Kryetare, mua më vjen shumë keq, se nuk ka nevojë të përsëris respektin që kam për ju, por parlamenti në këto raste kthehet në një pozicion qesharak. Kryetari i komisionit duhet të thotë se çfarë faktesh shtesë ka që e bëjnë të tërhiqet ky projektligj kaq i “rëndësishëm”, ndryshe, ju si mazhorancë ktheheni në qesharakë.

**Lindita Nikolla** – Edhe një herë, projektligji nuk është tërhequr, por është shtyrë për një seancë tjetër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ne votuam dhe parlamenti votoi shtyrjen.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, kjo pikë është e ezauruar, sepse është votuar.

Fjala për zotin Petrit Vasili.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Thjesht shpjegova procedurën që bëme.

**Petrit Vasili** – A mundem?

**Lindita Nikolla** – Po, zoti Vasili.

**Petrit Vasili** – Zonja Kryetare e Kuvendit, unë dua të sjell një shqetësim të përsëritur, se ky projektligj u tërhoq pasi mazhoranca ka të gjithë pronësinë procedurale të parlamentit, jo rregullësinë, por pronësinë procedurale, e cila fut dhe heq ligje si të dojë vetë. Pra, parlamenti nuk është më sovran dhe i rregulluar në bazë të Rregullores, por në bazë të tekave apo ndërhyrjeve klienteliste. Pra, çdo gjë që nuk jepet publikisht e motivuar, sigurisht është një ndërhyrje që vjen erë. Për një ligj që e ka përfunduar rrugën e tij dhe vjen në parlament, duhet shpjeguar shumë qartë tërheqja e tij përpara parlamentit, sepse nuk është biznesi privat i kësaj mazhorance, por është një diskutim në parlament.

Kjo nismë që është depozituar në fund të nëntorit, pra që ka rreth 4 muaj, ka mundësi të shqyrtohet, të tërhiqet, pra të bëjnë çfarë të duan, ndërsa nisma të tjera që lidhen përsëri me taksat kombëtare, por që afektojnë të gjithë popullsinë, siç është nisma për rishikimin e taksës së qarkullimit të karbonit, për karburantet, të cilat janë depozituar që në mars, nuk i prek njeri me

dorë. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se parlamentin e kanë futur në dorë dhe bëjnë çfarë të duan. Kjo është një sjellje shumë e turpshme, sepse çdo kush që e dëgjon, thotë: si ka mundësi që ka nisma, të cilat kanë një vit të depozituara dhe nuk u shqyrtohen, ndërsa këta e marrin, e fusin, e nxjerrin bëjnë çfarë të duan?

E njëjta gjë ndodh edhe me projektligjet e tjera. Në Komisionin e Ligjeve është paraqitur një tjetër nismë ligjore për respektimin e një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, për të cilin dëgjojmë përgjigjen më të marrë në botë, se ka ndër mend një ministri e caktuar të rishikojë një ligj, ndaj kur t'i vijë terezia, atëherë mund të respektohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese, për të cilin Kuvendi ka detyrimin e tij të bëjë ndryshimet, nuk ka vend t'i bëjë ministria. Pra, është e qartë që ka një shpartallim në pikëpamje të funksionimit të parlamentit, ka klientelizëm shumë të qartë.

Ishte një gjë e mirë që do të hiqej kjo taksë, ndërsa për taksë të tjera, si ajo e pijeve alkoolike, dyfishohet akciza, ndërkohë që bizneset shqiptare mbyllen masivisht, ka një qëndrim tjetër. Mirë që shkatërrohet Rregullorja, por të bëhet pazar i hapur parlamentar me ligje të komisionuara, është kaq e turpshme. Ndaj ju bëj thirrje që me autoritetin tuaj ta ndalini një herë e përgjithmonë këtë shpartallim parlamentar që po ndodh këtu.

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Kanë kërkuar fjalën zoti Spaho, zoti Majko dhe zoti Shalsi, më pas mbyllen diskutimet për procedurë.

Po, zoti Spaho.

**Edmond Spaho** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Zonja Kryetare, në rendin e ditës është parashikuar për t'u miratuar edhe projektvendimi për ndarjen e fondeve mes partive politike për zgjedhjet e datës 14 maj. Ky projektvendim u diskutua edhe në Komisionin e Ekonomisë, ku unë jam shprehur kundër dhe kam kërkuar që ky vendim të ridiskutohet, pasi, sikurse e parashikon edhe Kodi Zgjedhor, këto para duhet të shkojnë për ata të cilët angazhohen në fushatë zgjedhore. Në rastin konkret këtu jepem para për individë apo për grupe, të cilat nuk marrin pjesë në fushatë zgjedhore dhe kjo nuk është e drejtë. Paratë duhet të shërbejnë për qëllimin për të cilin janë parashikuar në buxhetin e shtetit, ndaj do t'ju kërkoj që ky projektvendim të debatohet.

Më vjen shumë keq kur dëgjoj kryetarin e grupit parlamentar të mazhorancës, i cili shprehet se nuk duam para për zgjedhje, se do t'i mbjellin pemë. Po paratë ku do t'i gjejnë pastaj?! A do t'i marrin nga krimi i organizuar?! Kjo i ngjan të folurës te libri “Si u kalit çeliku”, pasi dalin vullnetarë që të na hiqen edhe financimet për nevoja të domosdoshme.

Në këtë kuadër kam dëgjuar se edhe grupi parlamentar i mazhorancës do të dalë vullnetar që të mos u rritet rroga. Iniciativë më idiote dhe më qesharake nuk mund të gjendet për të poshtëruar dhe për të shkelur me këmbë deputetin, që të renditet baras me një përgjegjës sektori në ministri. Kjo tregon se sa seriozë jeni ju në të gjitha iniciativat që ndërmerri.

Kështu, ju bëj thirrje që të jeni të arsyeshëm dhe të mos veproni sipas interesave tuaja politikë, por sipas ligjit.

**Lindita Nikolla** – Zoti Majko, keni kërkuar fjalën.

Ju lutem, përmbajuni procedurës, se po zgjatemi dhe nuk po hymë dot në rendin e ditës.

**Pandeli Majko** – Absolutisht do t'i përmbahem procedurës.

Zonja Kryetare,

Dëshiroj të ritheksoj për procedurë kërkesën e një grupi deputetësh për të rishikuar më esencialisht disa shqetësime të grupeve të interesit, siç janë interesat e blegtorëve apo të industrisë së qumështit në Shqipëri. Mua më duket shumë e bazuar dhe nuk mendoj se është e nevojshme që sot këtu në parlament të bëhet fushatë e çuditshme elektorale. Nëse ka vend për të ngritur shqetësime për metoda komuniste të drejtimit të parlamentit, unë e ftoj zotin Leskaj, i cili kërkon informacion deri edhe nga Shërbimi Informativ pse ne po ndryshojmë programin dhe rendin e ditës, që të reagojë si përfaqësues i një shtrese që i takon të reagojë lidhur me faktin që sot përfaqësuesi i Partisë Komuniste sponsorizohet nga partia juaj. Madje, citoj shprehjen e kryetarit të Partisë Komuniste, i cili duke lavdëruar Partinë Demokratike të zotit Leskaj thotë: “Sot Partia Demokratike është pastruar nga servilët, i ka marrë të gjitha Partia Socialiste”. Me një fjalë: zonjën Jorida, zotin Bardhi dhe zotin Alibeaj i kemi marrë ne.

Unë shpresoj që këtij lloj diskutimi t'i jepet fund dhe uroj që kolegët të vijnë në komision dhe

të diskutojmë së bashku për atë që ngriti zoti Shalsi.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Po, zoti Shalsi.

*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

Ju lutem, të mos zgjatemi pa fund dhe të futemi në rendin e ditës.

Po, zoti Shalsi.

**Eduard Shalsi** – Në fakt, nuk e dëgjove...

**Lindita Nikolla** – Ju lutem, mos përmendni emrat e kolegëve, që të mos zgjatemi në diskutime pa fund.

**Eduard Shalsi** – Jo, nuk do të përmend emra, por nga njëra anë bëjnë muhabet dhe nuk e dëgjuan se çfarë tha zoti Majko.

Zoti Majko tregoi respekt ndaj tyre, duke dëshmuar faktin se përfaqësuesi i kandidatit të Partisë Komuniste është autorizuar nga njëri prej tyre.

Gjithsesi, një koleg deputet mbështeti ndryshimet, një tjetër tha se nuk e kemi debatuar, një tjetër tha se ka interesa klienteliste, njëri gozhdës, tjetri potkoit. Çështja është shumë e thjeshtë: nuk po e tërheqim pikërisht se jeni të ndjeshëm dhe po mundohemi të saktësojmë ligjin për të mos lënë asnjë shteg për abuzime. Pra, nuk ka tërheqje, ka vetëm shtyrje. Unë ju ftoj gjatë ditëve në vijim, nëse jeni të interesuar, të vini të kontribuoni dhe të kuptoni se për çfarë bëhet fjalë, se ndryshe nuk do të flasë njeri për pite e tjetri për simite.

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Zoti Leskaj, 2 minuta replikë dhe më pas 2 minuta replikë zonja Tabaku.

**Bujar Leskaj** – Unë e kam shumë miqësore për zotin Majko.

Zoti Majko, kjo ishte ndërhyrja më e gabuar që keni bërë për fjalët që thatë, ndërkohë që edhe Kryetarja jua lejon të politizoni.

Unë fola për taksën e hurrës dhe të qumështit dhe thelbi është që ju tani po tërhiqeni. Ju keni 4 muaj që po diskutoni dhe stërdiskutoni për shtyrje për arsye se, si gjithmonë, edhe në ato të mëdhatë, edhe te kjo e vogla, jeni në pozita klienteliste, jeni në shërbim të importuesve të biskotave, të kroasantëve e të tjerë. Ju jeni pjesë e asaj reklame që bëhet për kroasantet, për moltot, se nuk e kam idenë mirë se çfarë janë. Juve nuk jua bën zemra të bëni gabimin që bëtë në 2021-in për prodhuesit dhe eksportuesit vendas, të cilët ju i goditët duke

ua shtuar koston me 5% dhe praktikisht i keni vendosur në pozita jokonkurruese në treg, e para.

E dyta, atë që thashë për drejtuesit e rinj të Shërbimit Sekret, e kisha me ironi. Ju besoj se e kuptoni shumë mirë, pasi jeni edhe ekspert i politikave të sigurisë dhe ne mund të flasim edhe 10 apo 20 minuta për shërbimet sekrete.

E treta, edhe atë që thashë për një ndërkombëtar, e thashë për ta relaksuar pak situatën se ju jeni bërë shumë të lehtë. Nuk dua t'ju ofendoj, pasi këtë muaj jam me agjërime, por ju këshilloj të lexoni të gjithë një roman të Ylljet Aliçkaj “Rrëfenjë me ndërkombëtarë”.

Për sa u përket politizimeve dhe interpretimeve që ju bëtë për deputetët, për drejtuesit e Partisë Demokratike, për drejtuesit e koalicionit “Bashkë fitojmë”, ata janë këtu, e kanë gojën dhe jua kthejnë përgjigjen vetë, por ju nuk duhet të provokoni. Me sa duket, përcaktimi “gjysh” ju ka dhënë vlera dhe ju ka dhënë pjekuri. Pra, “djali”, “babai”, ju përcaktuan “gjysh” në një ceremoni të rëndësishme dhe ju kaluan pemën e 62-të.

**Lindita Nikolla** – Faleminderit, zoti Leskaj! Zonja Tabaku, 2 minuta replikë.

**Jorida Tabaku** – E nderuar zonja Kryetare,

Unë besoj se nuk kishte asnjë diskordancë në atë që diskutuan të gjithë përfaqësuesit e opozitës, që ligjet në këtë parlament vijnë me porosi, ashtu siç erdhi me porosi edhe taksa që u vendos për hurrën e qumështit, që prekte vetëm një grup të vogël prodhuesish për të ndihmuar kompani të caktuara në treg. Ashtu siç tha edhe zoti Leskaj, ka muaj që diskutohet në Komisionin e Ekonomisë, ku disa kolegë, të cilët e njohin mirë fushën, kanë marrë pjesë në diskutime. Ne nuk i marrim dot leje zotit Shalsi nëse vijnë apo nuk vijnë në komision.

Në fakt, unë e kërkova fjalën për një replikë me zotin Majko, të cilit unë si gjithmonë i referohem me respekt si për moshën, si për eksperiencën, ashtu edhe për faktin që këtij parlamenti i mungojnë zërat ndryshe, i mungojnë debatet dhe argumentet ndryshe, por kur moshë dhe eksperiencia keqpërdoren dhe, sigurisht, përdoren pa të drejtë emrat e kolegëve, unë nuk mund të rri pa folur.

Zoti Majko, ju mund të keni gjithë të drejtën që në debatin dhe në shërbimin tonë në Partinë Demokratike të përdorni ato që kanë thënë disa kolegë kundër nesh. Në fakt, turp për ata që i kanë

thënë, se unë nuk e kam përdorur kurrë parlamentin për një gjë të tillë, por më turp për ata midis jush këtu në parlament që e përdorin debatin e Partisë Demokratike për argumente politike.

Zoti Majko, nuk kam nevojë që të them se sa opozitë bëj unë dhe se sa opozitë bëjnë të tjerët, këtë e gjejnë njerëzit. Kush është i shitur dhe kush është i blerë, kush ka leje hidrocentrali apo kush ka leje koncensionit, këtë e dinë qytetarët, por, të lutem, herë tjetër respekt për moshën, për eksperiencën kur përdor emrat e kolegëve në këtë parlament.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Kalojmë te rendi i ditës. Fillojmë me projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Referuar nenit 73, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, ka pyetje? Nuk ka.

Atëherë, fillojmë me paraqitjen e projektligjit nga nismëtarja.

Zonja Balluku, keni fjalën.

**Belinda Balluku** – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Pandi, ti moshën e mban shkëlqyer dhe nuk e di se sa ta dinë, por nuk je kaq i vjetër, thjesht ke flokët e bardhë! Unë nuk e di nëse moshja ka filluar të jetë një element i keq për ne.

Pa dyshim, transformimi i shpejtë dhe i prekshëm nga të gjitha grupmoshat dhe kategoritë e përdoruesve tashmë është hapësira digjitale, kjo me gjithçka të mirë që ka sjellë në jetën tonë, sidomos gjatë pandemisë, ku ne provuam kufij të rinj të botës digjitale, por, nga ana tjetër, sjell implikime dhe impakte negative, si rrjedhojë edhe tregu i shërbimeve të medieve audiovizive ka evoluar ndjeshëm dhe me shpejtësi për shkak të konvergencës së vazhdueshme të shërbimeve të televizionit me ato të internetit që rriten çdo ditë e më shumë.

Zhvillimet teknike kanë lejuar futjen në treg të përvojave dhe të përdoruesve të rinj. Zakonet e shikimit, veçanërisht ato të brezave të rinj, kanë ndryshuar ndjeshëm, ndërsa ekrani i televizorit mbetet ende një mjet i rëndësishëm për shpërndarjen e informacionit, sidomos për brezat që janë mësuar me këtë shërbim.

Llojet e reja të përmbajtjes, të tilla si videoklipet apo përmbajtja e krijuar nga vetë përdoruesit, që tashmë është diçka që ndodh me të

gjitha moshat, po zënë vazhdimisht një pjesë të madhe të konsumit audiovizual për shkak edhe të aksesit më të shpejtë dhe më të gjerë. Kjo konvergencë e medieve kërkon një kuadër të ri ligjor të përditësuar dhe të pasqyruar me të gjitha zhvillimet e tregut audioviziv për të arritur një ekuilibër ndërmjet aksesit të shërbimeve dhe përmbajtjes *online* ndërmjet mbrojtjes së konsumatorit, sigurisht, konkurrencës.

Në këtë frymë vjen sot edhe projektligji i propozuar, i cili synon rishikimin e rregullave për transmetuesit audiovizivë, si dhe për ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove, me objektiv kryesor mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme, sigurimin e aksesit të personave me aftësi të kufizuara në informacion, rritjen e transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve medietike, si dhe përforcimin e detyrimeve për ofruesit e shërbimeve audiovizive me kërkesë.

Ky projektligj vjen, gjithashtu, si pjesë e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të anëtarësimit për harmonizimin e legjislacionit tonë me atë të Bashkimit Europian, pikërisht sepse mjedisi i medieve audiovizive dhe sjellja e shikuesve kanë ndryshuar. Në vitin 2018 Bashkimi Europian ka rishikuar direktivën e vitit 2013 “Për shërbimet medietike audiovizuale”, të cilën transpozon ky akt.

Në këtë projektligj gjen, gjithashtu, vend edhe trajtimi i koncepteve të reja, si: bashkërregullimi, vetërregullimi, edukimi medietik, shërbimi i platformave të shpërndarjes së videove, si dhe videot e krijuara nga përdoruesi.

Unë do të doja të ndalesha pak te koncepti i “edukimit medietik”, i cili ka ngritur edhe një sërë debatesh në komisione gjatë diskutimit që ka pasur ky projektligj. Koncepti “edukim medietik” nuk ka të bëjë me edukimin e medieve, në të kundërt, u referohet aftësive, njohurisë dhe të kuptuarit të përdoruesit.

Edukimi medietik ka të bëjë me rritjen e ndërgjegjësimit të audiencave për të drejtat e tyre në raport me mediet, me platformat e shpërndarjes së videove *online*, si dhe rritjen e cilësisë së medieve dhe informimit të publikut kur lajmet e rreme, dezinformimi, gjuha e urrejtjes apo ekstremizmi i dhunshëm përbëjnë kërcënime serioze ndaj vlerave dhe të drejtave të njeriut.

Në këtë drejtim, projektligji parashikon, gjithashtu, dhe rregulla të reja lidhur me ofruesit e platformave të shpërndarjes të videove *online*, si: Facebook, Instagram, Tik-Tok, Youtube apo platforma të tjera të parregulluara më parë. Ajo çka mbetet më e rëndësishme, është mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet që cenojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre motorik mendor, moral dhe emocional, në një kohë kur rreziku ndaj ekspozimit, ndaj përmbajtjeve të dëmshme është çdo ditë e në rritje.

Projektligji përforcon detyrimet e ofruesve të shërbimeve audiovizive për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përmes masave që përfshijnë përzgjedhjen e kohës së transmetimit, mjetet e verifikimit të moshës apo masa të tjera teknike, si dhe mbrojtjen e të dhënave të tyre personale.

Megjithëse jo pjesë e direktivës, por tashmë pjesë e legjislacionit për barazinë gjinore dhe me kërkesë të Shoqatës së Grave në Medie drejtuar komisioneve të Kuvendit, në projektligj është shtuar edhe përkufizimi i konceptit të “seksizmit në medie”, si dhe detyrimi i ofruesve të shërbimeve audiovizuale dhe platformave të shpërndarjes së videove për të respektuar parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit gjinor, ndalimit të seksizmit dhe përfaqësimit gjinor në medien audiovizive në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përmbyllje, dëshiroj të theksoj se ky projektligj është hartuar me vëmendje dhe përgjegjshmëri nga stafet teknike, duke u konsultuar, gjithashtu, dhe duke marrë dakordësi edhe nga “DG Near” dhe “DG Connect” pranë Komisionit Europian, si dhe ekspertët e Organizatës Europiane Observatore të Medieve Audiovizive, ndaj dhe unë jam besimplotë që ky projektligj do të marrë mbështetjen e deputetëve sot gjatë votimit.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Hapim diskutimin.

Fjala për zonjën Flutura Aça.

Të përgatitet zonja Etilda Gjonaj.

**Flutura Aça** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Kur një muaj më parë, vrasësi i katër grave hyri në sallën e gjyqit, kamerat e pothuajse të gjitha televizioneve shqiptare u përqendruan mbi fytyrën e tij dhe e dhanë drejtpërdrejt e me një

pritje trishtimisht të papranueshme nëse do të kthente përgjigje kur u pyet në ishte penduar për vrasjet makabre që kishte bërë.

Gjithçka, drejt e nga salla e gjyqit, po ndodhte në emër të lirisë së medias, me qëllimin e dukshëm për të bërë lajm dhe jo me qëllimin për të dënua femicidin, media po shkaktonte lehtësish etikëcid, moralicid, pra një shoqëricid të frikshëm.

Ju lutem, kolegë, shihni mbrëmjet shqiptare. Ato prodhojnë shumë nervozitet, konflikt që, natyrisht, buron edhe nga politika konfliktuale që kemi ndërtuar të gjithë bashkë. Plot 12 programe politike i ke çdo mbrëmje në televizionet shqiptare, ku ndonjëherë janë thirrur edhe specialistë të hapjes së dyerve të blinduara të Partisë Demokratike, duke harruar, në fakt, se po u mësonin keqberësve sesi hapen dyert e blinduara të familjeve shqiptare.

Mjedisi ynë audiovizual është një mjedis i ndotur akustik dhe etik, me njerëz që i gërthasin njëri-tjetrit, që zgjedhin më mirë të hedhin mllaf se të argumentojnë, që flasin me zë të lartë, aq sa ua hapën kafkën shqiptarëve dhe po e kthejnë Shqipërinë në çmendinë. A është kjo ajo që duan shqiptarët?

Në këtë kontekst shumë të brishtë nga pikëpamja e ndarjes ndërmjet të drejtës dhe së drejtës, pra, ndërmjet të drejtës së medias dhe së drejtës për mbrojtjen e fëmijëve nga ekspozimi i vrasësve, të drejtës së prezumimit të fajit, të drejtës së privatësisë, por edhe të drejtës njerëzore të ruajtjes nga pamje të padëshirueshme, ky ligj, dhe as armimet që duam të kalojmë sot, nuk rregullojnë dot gjë. Pra, nuk e rregullojnë atë rol thelbësor që Shimon Peres ia quan si detyrim të medias: që ta bëjë diktaturën të pamundur, por jo demokracinë të padurueshme.

Në Shqipëri kjo lehtësi e së padurueshmes shkon nga represioni dhe shantazhi i hapur shtetëror mbi medien tek abuzimi publik me kast i operatorëve dhe individëve të caktuar, me lirinë e medias. Në këtë hapësirë pa kontroll, ky ligj në disa pjesë të tij, e shton edhe më shumë paqartësinë. Kolegët e mi, që do të flasin më pas, do ta thonë specifikisht.

Kur Edi Rama erdhi në pushtet në vitin e harruar 2013, mes përvojave të tjera personale, kishte edhe atë me medien, dhe ishte po kjo shoqëri, e cila sulmin personal ndaj tij si njeri i fjalës e kishte perceptuar si sulm ndaj fjalës së

lirë, pa në këta dhjetë vjet shndërrimin trishtimisht të papranueshëm të atij vetë si kryeministër i shqiptarëve në raport me medien.

Të gjitha këto shërbime të shqiptarëve i ka harruar dhe i ka tejkaluar vetë me pushtetin e tij tashmë gati absolut, jo me thyerje kockash të hundës ndaj kritikëve, por me blerje të hapura të medias kur mundet ose me rrënimë televizionesh si “Agon Channel”, duke u lënë shqiptarëve faturën e 110 milionë eurove; me tritol në mes të plazhistëve ditën e lume në një nga asetet e “Fokus media”, me qëllimin që ta shkatërrojë, sepse kushedi se ku i ka mbetur kunji; me shkujdesjen për të gjetur autorët e sulmit mbi “Top Median” me kushedi çfarë qëllimi në prapaskenë; me fyerjet e tij personale ndaj gazetarëve të faqeve shqiptare, me qëllim intimidimin dhe depersonalizimin e tyre; me gërmushjet dhe talljet e tij nëpër studiot televizive, veçmas ndaj gazetarëve femra nga kushedi çfarë inatësh të vjetra.

Kryeministri ynë është një nga politikanët më të përkëdhelur nga media, në mos personazhi i krijuar nga media apo spektakli i rremë, apo nga koraca pa substancë e pashaizmit shqiptar. Ai tashmë i kontrollon gati të gjitha mediet, shenjë kjo që nuk e ndryshon fare nga diktatorët klasikë. Jo vetëm i kontrollon, por qeras me to bujarisht edhe ato pjesë të opozitës që ia sigurojnë më mirë pushtetin. E thotë progresraporti i Bashkimit Europian, e thotë raporti i fundit i DASH-it, e thonë relacionet e shoqatave të medieëve europiane, si dhe shkalla e ulët e lirisë së shprehjes në pikëzimin botëror të vendeve.

Dhjetë vjet më pas, pupaci i spektaklit mediatik duket i nginjur nga media, aq sa nuk e merr seriozisht as nisjen e një fushate zgjedhësh, duke zbritur në nivelin e tallavasë, të cilën madje po e promovon si gjetje shumë të zgjuar të vetën. Është po i njëjti njeri që në fund të vitit të tij të parë në pushtet i thirri në një darkë të pagabuar figurat kryesore të medias shqiptare, duke i fyer dhe duke i bullizuar drejtpërdrejt në televizion si t’ua parathoshte kthimin e tyre, me hir a pa hir, në shqyrtarë të tij.

E kush e mendonte se njeriu i cili në ato takime tentoi të ishte si Baraku i Obamës, sot, nga lodhja mediatike e turbofolkut, po i ngjan Farukut të barakës, i cili, ngaqë i janë ngatërruar akrepat e kohës dhe të mendjes, fle ditën i dehur nga rakia dhe natën bën saze e gostira, duke i bërë stërvitje

nervash lagjes sime, me detyrën si dishepulli i prijësit të shoqërisë shqiptare, i cili, qysh prej çështjes “McGonigal”, ka hyrë në agjërime politik, duke na e zbehur shumë teatrin këtu në parlament, e, me sa duket, edhe në agjërime mediatik.

Nxitimi për arnat e këtij ligji ngre shumë dyshime. Vonesa nga mbyllja e procesit të diskutimit publik, deri në përcjelljen në parlament, shqyrtimi me publikun në vetëm një muaj kohë, mospërshirja e të gjitha grupeve të interesit në amendimet e nevojshme, mungesa e konsultës me shoqatat që mbrojnë të drejtat e fëmijëve, edhe pse ligji bën rregullime të tilla, shtyrja për një kohë tjetër e sugjerimeve të përfaqësuesve të biznesit të fushës, si dhe nxitimi për ta kaluar në parlament veshur me ambalazhin e detyrimit për procesin e integritetit, më bëjnë skeptike, gjë që do ta bëjë skeptike edhe votën time.

Ndreqjet e këtij ligji do të kërkojnë akte të reja nënligjore nga AMA, madje shumë shpejt edhe një infrastrukturë të re për kryerjen e detyrave që i lë ky ligj AMA-s.

Jam e bindur se AMA do të vijë shumë shpejt me një kërkesë të re për shtimin e personelit, kur nuk ka as pak javë që kemi kaluar në heshtje të plotë një rritje prej 30% të tij, më së shumti me personel joefektiv, si magazinierë e postierë, jo monitorues e mbikëqyrës të tregut audioviziv, ndryshe nuk do të ndodhte që në orët e paradites së një të shtune, kur të gjithë fëmijët janë para ekranit dhe nëpër shtëpitë e tyre, një televizion i nderuar të jepte këshillat e një seksologeje, që fliste për përparësitë e lodrave të seksit. Ishte kjo frikë që më bëri të mendoja se kjo strukturë joefektive që kaluam për AMA-n kohët e fundit, ishte vetëm një qokë elektorale për t’i gjetur punë një shpure patronazhistësh apo aktivistësh në tentativë, meqenëse keni ndërruar term.

Rregullimi në ligj kërkon që pronarët e platformave autodiovizive të jenë transparentë dhe të qartë, por po të mos kujtoheshe se vetëm disa ditë më parë dy portale të rëndësishme të informimit të publikut, si “Jeta osh qejf” dhe “Lolita” janë sulmuar nga personazhi më abuziv mediatik që kanë njohur ndonjëherë kohët shqiptare, kryetari i Bashkisë së Tiranës, do ta besojë se rregullimi është i sinqertë.

Ndreqjet e këtij ligji kërkojnë që tregu audioviziv të veprojë në bazë të vetërrregullimit,

por, në fakt, në një treg pa rregulla të qarta “vetërregullim” do të thotë “abuzim”, do të thotë “gjoba”. Gati 3 mijë euro shkon heqja e një shkrimi të padrejtë nga portalet abuzive, pjesa më e madhe e të cilave janë medie të licencuara, që nuk mbajnë asnjë përgjegjësi askund.

Pra, kush na siguron se pas miratimit të këtij projektligji do të ecim mbarë, kur, në fakt, po ecim me kaq nxitim? Kështu që më mirë të ecim ngadalë, por kurrë të mos ecim së prapthi, siç na mëson Linkolni.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjala për zonjën Etilda Gjonaj.

Të përgatitet zonja Jorida Tabaku.

**Etilda Gjonaj** – Faleminderit, e nderuar zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Ne jetojmë në një botë ku informacioni është i disponueshëm vetëm me klikimin e një butoni dhe fuqia për të transmetuar mesazhe dhe imazhe në çdo cep të botës i takon medias. Media ka një fuqi të madhe, ka aftësinë për të formuar opinionin publik, duke ndikuar në politika, duke vendosur norma dhe vlera shoqërore, duke i mbajtur institucionet dhe njerëzit të përgjegjshëm dhe duke inkurajuar dialogun dhe ndryshimet shoqërore.

Në përmbushje të angazhimeve tona për anëtarësimin në Bashkimin Europian, ky projektligj bën një përafrim të pjesshëm me normat e direktivave europiane, në kuadrin rregullator të medias, siç janë: përcaktimi i standardeve dhe i praktikave që duhet të respektohen nga ofruesit e shërbimeve mediatike, adresimi i problematikave të evidentuara për aksesueshmërinë në informacion për personat me aftësi të kufizuar (për herë të parë), si dhe risitë në konceptin e edukimit mediatik apo të mbrojtjes së fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme.

Po ashtu, siç kanë fuqi në opinionin publik, mediet kanë edhe një përgjegjësi të madhe, dhe është thelbësore që mediet ta përdorin atë me etikë, duke raportuar në çdo rast dhe kurdoherë të vërtetën në mënyrë objektive.

Do të ishte shumë mirë që ky projektligj të kishte një përafrim të plotë me direktivat e BE-së jo vetëm në aspektet që rregullon, por edhe në një sërë çështjesh të tjera të paadresuara ende. Sasia e madhe e të dhënave që mblidhen nga platformat e medieve digjitale ka ngritur shqetësime serioze

për privatësinë individuale, për të drejtat themelore të njeriut jo vetëm në vendin tonë, por edhe në vendet europiane, ku dezinformimi ose lajmi i rremë është, gjithashtu, një çështje që adresohet në vijueshmëri. Kjo do të duhet të ndiqet edhe nga autoritetet përkatëse shqiptare, e për këtë arsye nxis institucionet përgjegjëse dhe AMA-n për të ndërmarrë ndryshimet e duhura, me qëllim përafrimin 100% me direktivat e BE-së, si dhe për t'i ndjekur të gjitha strategjitë e tyre, tashmë të hedhura në letër, lidhur me ndalimin e dezinformimit dhe të lajmit të rremë.

Patjetër që një mjedis mediatik dinamik, funksional, i hapur dhe i larmishëm është ideal, por deri në pikën ku nuk cenohet liria dhe dinjteti i një personi tjetër. Në medien audiovizive pasqyrohet një hendek gjinor, që shpërfaqet në mënyra të ndryshme, përfshirë dhe programet që transmetohen, i cili kontribuon në shkeljen e të drejtave të grave e vajzave.

Një shqetësim i vazhdueshëm, që është ngritur edhe nga disa organizata të shoqërisë civile, që luftojnë për të drejtat e grave, me të cilat bashkohem plotësisht, është fakti se jo në pak raste media shfaq stereotipet gjinore, intimidimin, pabarazinë gjinore, gjurmët seksiste dhe dhunën, kryesisht ndaj grave dhe vajzave, një fenomen ky negativ, që cenon thelbësisht dinjtetin njerëzor dhe me pasoja të rënda jo vetëm për rolin e gruas në shoqëri, por për të gjithë shoqërinë në tërësi, ashtu siç ndodh me fenomenin e cenimit të figurës dhe me intimidimin në medie të grave në politikë, duke sjellë një ndikim serioz në pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e tyre.

Ky shqetësim është në të gjitha vendet europiane, por mbase është pak më i ashpër në Shqipëri, dhe është ngritur jo thjesht nga organizatat e shoqërisë civile, por është një fenomen që ne e shohim përditë, si dhe një çështje që ne, si Aleancë e Grave Deputete, e kemi trajtuar dhe e kemi ngritur.

Sipas direktivës së BE-së për çështjet e barazisë gjinore, do të duhet të merren masa për ndalimin e gjuhës së urrejtjes ndaj grave, me qëllim mosdekurajimin e tyre për t'u përfshirë dhe për t'u angazhuar në politikë. Kjo është evidentuar edhe gjatë samitit të fundit për demokracinë, të mbajtur nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bajden, në një agjendë për trajtimin e kërcënimeve më të mëdha me të cilat përballen demokracitë, ku një ndër çështjet e

adresuara ishte edhe dhuna dhe kërcënimi i grave nga teknologjia, e cila ndikon në mënyrë disproporcionale te gratë, te vajzat, si figura politike dhe publike, si lidere, gazetare dhe aktiviste.

Vlen për t'u theksuar se është shumë pozitive që në këtë projektligj fëmijët gjejnë mbrojtje të posaçme nga dhuna, seksualizmi, agresioni dhe përdorimi i imazhit të tyre nga media. Me rritjen e aksesit në mediet digjitale, fëmijët dhe adoleshentët janë tashmë më të ekspozuar ndaj një game të gjerë përmbajtjesh, disa prej të cilave mund të kenë ndikim negativ në zhvillimin e tyre.

Qëllimi i ndryshimeve është promovimi i zakoneve të shëndetshme të konsumit të medias dhe marrja e masave të rrepta për të siguruar mbrojtjen e të miturve nga përmbajtje potencialisht të papërshtatshme dhe të dëmshme, një masë kjo shumë e rëndësishme, e cila duhet të zbatohet siç është shkruar në letër.

Sigurimi i një marrëdhënieje pozitive midis të miturve, medias dhe platformave të ndryshme të saj është jetik. Patjetër, duhet një kombinim më i gjerë masash, që fëmijët tanë të jenë të mbrojtur nga çfarë u serviret nga mediet *online* apo nga televizionet, aq më tepër në këtë shoqëri, ku teknologjia është pjesë e pandashme e jetës sonë dhe përbën një problematikë për mbrojtjen e tyre. Me keqardhje kemi dëshmuar edhe raste ekstreme, ku, duke ndjekur shembujt e paraqitur në rrjetet sociale, të miturit kanë pasur pasoja fatale për jetën e tyre.

Të nderuar kolegë,

Unë besoj fort se liria e medias është një aspekt themelor i një shoqërie demokratike dhe, si pushtet i katërt, duhet të ketë njëkohësisht lirinë dhe rregullimin e nevojshëm, me qëllim moslejimin e një konkurrence të padrejtë, por edhe respektimin e të drejtave dhe dinjitetit të njeriut.

Dezinformimi është një fenomen, që po luftohet në të gjitha vendet europiane, dhe jo vetëm, duke gjetur mjetet efikase për t'i diferencuar gazetarët dhe mediet që kryejnë punë të ndershme (ashtu siç ka tek ne gazetarë të ndershëm, që gjëmojnë edhe gërmojnë për të vërtetën) nga ata që dezinformimin e kanë mjet përfitimi.

Për këtë arsye nevojitet një kornizë ligjore balancuese, që ndryshimet e fundit të këtij

projektligji ta përmirësojnë situatën e medieve audiovizive. Megjithatë, duhet të bëjmë akoma më shumë, jo vetëm për të përafuar legjislacionin tonë me direktivat e BE-së, por me qëllim që media të shërbejë si një informuese e drejtë për publikun.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjala për zonjën Jorida Tabaku.

Të përgatitet zonja Blerina Gjylameti.

**Jorida Tabaku** – Të nderuar kolegë të paktë në sallë,

Të nderuar qytetarë,

Së pari, më lejoni t'ju them që ligjin dhe ndryshimet e sotme, të cilat u sollën nga qeveria në një kohë shumë të shkurtër, unë dhe zonja Açka, si drejtuese komisionesh dhe përfaqësuese të opozitës, i futëm menjëherë në kalendar për të parë nëse ndryshimi i ligjit ishte me aq prioritet sa thuhej.

Sot thuhet rëndom nga politika: “Na duhen për procesin e integritetit; po i kalojmë me urgjencë, se duhen për integritetin; po i kalojmë me urgjencë se na i ka kërkuar Brukseli”, dhe këto janë shprehjet më normale të ditës.

Bashkë me zonjën Bushka, kryetaren e Komisionit të Ligjeve, kam qenë në një dëgjuesë të gjatë me shoqërinë civile dhe me përfaqësuesit e sektorit, për të diskutuar se cilat janë problemet reale të medias, se çfarë po ndodh sot me tregun, se përse Shqipëria ka rënë me 20 vende në renditjen e “Reporterëve pa kufij”, se përse progresraporti, nga 33 kapituj, vetëm atë për medien e ka në regres. Ndër të tjera citoj: “Nuk është bërë asnjë progres në periudhën raportuese. Pavarësia e medieve dhe cilësia e gazetarisë mbeten të penguar nga ndërthurja e interesave të biznesit me politikën. Fushatat e dezinformimit janë të përsëritura veçanërisht në mediet *online*. Gjatë periudhës së raportimit u panë raste kërcënimesh dhe fushata shpifjesh *online* kundrejt gazetarëve, sulme fizike dhe verbale kundrejt gazetarëve, fushata shpifjesh, që, sigurisht, vendosin në pikëpyetje çështjet e sundimit të ligjit, të korrupsionit dhe të drejtësisë. Rekomandimet e vitit të kaluar nuk janë zbatuar ende. Duhet patjetër të zbatohet një politikë me tolerancë zero për kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve dhe medieve. Është problematike transparenca e pronësisë dhe e financimit të medias, dhe kufizimet e saj. Kërkesat për reklama



publike duhet të jenë në harmoni me standardet ndërkombëtare. Duhet garantuar zbatimimi i Kodit të Punës dhe të fuqizohet mbrojtja e punës së gazetarëve, nëpërmjet miratimit edhe të një statusi për gazetarin”.

Këto janë problemet që ka media sot.

I dëgjova kolegët të shqetësuar për atë që transmetojnë mediet, me orar e pa orar, se si trajtohen zonjat në politikë ose jo, se çfarë gjuhe përdoret në medie, se çfarë aksesit kanë fëmijët në medie, por këtu nuk ka asnjë çudi, sepse media është fytyra e politikës, se ashtu siç është politika sot, është dhe media. Gjuha që përdoret sot në politikë, përdoret dhe në medie. Ashtu siç sulmohet media me kallash e me tritol, ashtu bëhet dhe në politikë. Nuk ka absolutisht asgjë për t’u çuditur për atë çfarë ndodh sot me medien.

Raporti i fundit i Departamentit Amerikan të Shtetit theksonte se ka pak medie të pavarura sot, se shumica e medieve janë në pronësi të biznesmenëve, që kanë interesa të mëdha (sigurisht, jo nga opozita në këtë rast) dhe i përdorin ato për të avancuar jo vetëm në politikë, por edhe në biznes, duke përfshirë edhe promovimin e interesave të tyre me partitë politike. DASH-i shprehet se ka raporte të besueshme për përfaqësuesit e lartë të medieve, që i përdorin organet e tyre për të shantazhuar biznesin, për të kërcënuar me mbulim të pafavorshëm mediatik biznese konkrete; ka presion politik; korrupsioni, por njëkohësisht dhe mungesa e fondeve kanë kufizuar medien e pavarur dhe gazetarët, të cilët praktikojnë autocensurën.

Këto janë shqetësimet që kanë sot mediet, këto janë shqetësimet që ka sot mjedisi mediatik, si pushtet i katërt, siç tha parafolësja, zonja Gjonaj. Unë nuk besoj se ka një ligj që i rregullon këto shqetësime, nuk besoj absolutisht që ka një akt, që mund të miratohet në parlament, i cili mund ta ndryshojë situatën e medias, por kjo është çështje e vullnetit politik, për mënyrën sesi është ngritur sistemi i medias, sesi janë lidhur interesat politikë me ato të biznesit, sesi ushtrohet presion mbi medien, për hapësirën që u japin mediet individëve të caktuar.

Në këtë parlament ka deputetë, në këtë qeveri ka ministra, të cilët e kanë parë dhe e kanë provuar në kurrizin e vet, kur një herë kanë qenë të preferuar nga media e herën tjetër janë bërë të papreferuar, e pastaj bëhen fushata sulmesh dhe

denigrimesh, që të gjitha lidhen me interesa dhe konflikte biznesi; të gjitha në dorën e qeverisë, asnjëra prej tyre në dorën e opozitës.

Kjo situatë duhet të ndryshojë, jo sepse na e thotë Europa, jo se është një detyrim në progresraport, por duhet të ndryshojë si një balancë e drejtë e një shteti demokratik, i cili sot ka në pikëpyetje strukturën sesi funksionojnë institucionet, ka në pikëpyetje kapjen e pushtetit, ka në pikëpyetje medien, balancën dhe kontrollin, rolin e parlamentit. Të gjitha shtyllat e demokracisë sot janë në pikëpyetje. Sigurisht, ashtu siç janë politika dhe demokracia, ashtu është edhe media sot! Nuk ka asgjë për t’u çuditur me situatën në të cilën ndodhet media.

Me shumë dashamirësi e diskutuam ligjin e paraqitur nga qeveria, me idenë për të parë se cilat ishin ndryshimet që përputheshin me direktivën e BE-së. Ligji nuk përputhet tërësisht me direktivën e BE-së. Direktiva e BE-së i përcakton në ligj dhe nuk i lë me akte dytësore, me VKM, një sërë elementesh, që i përmendi këtu zonja Açka.

Sasia e gjobave e vendosur në këtë ligj është disproporcionale për sa u përket operatorëve dhe individëve. Hapësira që i jepet këtu AMA-s është e jashtëzakonshme, për të vendosur për gjëra që kërkojnë një rritje në strukturë dhe në kapacitete, që nuk i ka për momentin. Zonjën ministre e kanë keqinformuar, sepse ne ngritëm pyetjen nëse AMA i kishte kapacitetet për ta bërë edukimin mediatik dhe jo se çfarë është edukimi mediatik; nëse përputheshin me direktivën e BE-së apo jo funksionet që po i jepeshin AMA-s dhe nëse AMA duhet t’i merrte këto.

Ligji “Për mediet audiovizive” nuk mund të kalojë në parlament një herë në tre muaj. Nuk mund ta ndryshojmë ligjin sa herë shohim se ka diçka që nuk shkon. Ligji ka nevojë për një rregullim të plotë, tërësor për t’i zgjidhur të gjitha shqetësimet që ekzistojnë sot (për ato që mund të zgjidhen me ligj, se për ato që nuk zgjidhen me ligj është e pamundur, sado të përpiqemi këtu në parlament, pasi lidhen me interesa biznesi e interesa politike).

Ka qenë në dëshirën dhe në vullnetin tonë që të kalonim çdo gjë që lidhej me direktivën, ashtu siç kemi mbështetur sugjerimet dhe kërkesat nga dhomat e tregtisë, nga organizatat e shoqërisë civile, nga individët, të cilët prekeshin nga zbatimimi i këtij ligji, duke u përpjekur që të mos e ndryshojmë ligjin prapë pas tre muajsh.

Paqëndrueshmëria ligjore është kthyer në problem real sot edhe për funksionimin e institucioneve, për ligje që vijnë këtu e ndryshohen për tre rreshta, ndërkohë që nuk flasim për problemet reale dhe konkrete që ka sot media dhe për pavarësinë e saj.

Këto shqetësime i ngritëm ne në komision. Ashtu si zonja Açka, edhe unë nuk do të votoj, do të abstenoj për këtë ligj. Jemi të gatshëm të diskutojmë me të gjithë operatorët në treg, me shoqatat e gazetarëve, siç diskutuam herën e parë, se cilat janë problemet reale që ka sjellë sot ky sistem dhe si mundemi ne, me kaq pak sa na takon, me kaq pak sa mund të bëjmë me punën tonë në komisione dhe me votën tonë në parlament, ta ndryshojmë këtë situatë. Fjalët e tjera: “E bëmë për integrimin dhe për Brukselin” i merr era pa mbaruar ende seanca!

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjala për zonjën Blerina Gjylameti.

Të përgatitet zoti Tritan Shehu.

**Blerina Gjylameti** – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë që na ndiqni,

Pas vitit 1990, me ndryshimin e sistemit, edhe në Shqipëri media mori një zhvillim të vrullshëm, jo thjesht si një mjet për të plotësuar nevojën për informim, por edhe si element dallues i një sistemi të ri demokratik. Bashkë me rritjen e numrit të medieve, qoftë atyre të shtypit të shkruar apo atyre radiofonike dhe televizive, ka lindur nevoja për ta normuar më mirë dhe për të adresuar gjithë ato shqetësime që kanë lindur në këta 30 vjet për sa i takon funksionimit, por, mbi të gjitha, mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve.

Edhe nisma e sotme për mediet audiovizuale ka si qëllim rishikimin e rregullave për transmetuesit audiovizivë, si dhe për ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove; mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme, përfshirjen e rregullave për sigurimin e aksesit në informacione personale dhe sigurimin e aksesit për personat me aftësi të kufizuar; rritjen e transparencës së pronësisë së medieve dhe për ofruesit e shërbimit audiovizivë me kërkesë. Në të gjen vend trajtimi i koncepteve të reja si një mënyrë për t’i adresuar të gjitha problematikat që ka sot media, si: bashkërregullimi, vetërregullimi, edukimi mediatik, ofruesi i platformave të shpërndarjes së videove, shërbimi i platformave të

shpërndarjes së videove dhe i videove të krijuara nga përdoruesit.

Me futjen e pajisjeve teknologjike, çdo i ri dhe e re nën moshën 14 vjeç rrezikon të bjerë pre e dhunës apo e mashtrimit që mund të shfaqet në media. Dëgjova disa kolegë, të cilët i kam ndjekur edhe në diskutimet në komisione, ku të gjithë ngrënë të njëjtin shqetësim se me çfarë përballen fëmijët tanë, fëmijët shqiptarë, duke pasur akses në media, duke pasur akses nëpërmjet teknologjisë edhe në informacione që jo vetëm nuk përshatën me moshën e tyre, por edhe e cenon integritetin e tyre.

Kemi diskutuar me kolegët në komisionin përkatës për shqetësimet që kemi të gjithë për gjuhën që përdoret në medie, për gjuhën që përdorin portalet, për gjuhën linçuese, për gjuhën e urrejtjes dhe për dezinformimin. Ndërkohë, nuk e kuptoj pse këtu dalin kolegë të caktuar të thonë se ky është një ligj që nuk adreson shumë problematika. Besoj se gjëja më e shtrenjtë që ka gjithsecili prej nesh janë fëmijët. Çdo qytetar gjënë më të shtrenjtë ka fëmijët, dritën e syve, dhe ky ligj adreson pikërisht një problem kaq të madh, nga i cili cenohen shumë fëmijë. Shpeshherë kemi dëgjuar edhe nga përfaqësues të autoriteteve përkatëse se informacioni i pakontrolluar cenon pikërisht fëmijët dhe të thuash këtë gjë këtu, është tërësisht e papranueshme.

Politikë ne bëjmë çdo ditë. Jemi në dy kahe, disa qëndrojnë majtas e disa qëndrojnë djathtas, por ajo që na bashkon janë fëmijët, qytetarët që na kanë votuar, e drejta, transparenca, që ky pushteti i katërt të ketë funksionin e tij parësor, që është informimi, jo dezinformimi.

Dëgjova nga kolegët më parë, e kam dëgjuar edhe në komisione, që nga një anë ngrënë shqetësimin e madh që media shpeshherë përdoret si kamxhik për të dënuar dhe për të cenuar disa njerëz, duke e lidhur median me interesa të caktuar ekonomike-politike për të promovuar disa, ndërkohë në anën tjetër shqetësohen për masat që ky projektligj ka sanksionuar pikërisht për t’i adresuar këto lloj problematikash. Kemi diskutuar me kolegët në Komisionin e Medies dhe të Arsimit për shqetësime të tjera që lidhen me portalet, për teknologjinë dhe risitë dhe se si mund të adresohen këto. Shqetësohemi për lirinë e medieve, ndërkohë, në anën tjetër diskutojmë se si përdoret media për të dezinformuar, për të linçuar, për të përdorur gjuhë urrejtjeje.

Shpeshherë kemi thënë, dhe nuk duhet ta vazhdojmë më, por duhet ta adresojmë, sepse ne pikërisht këtë detyrë kemi, se si humbet edhe pjesa humane vetëm për disa klikime më shumë apo për më shumë shikueshmëri.

Do të kisha dashur që me kolegët këtu të flisnim për çfarë është më e rëndësishmja. Politika duhet të lihet pas kur flasim për interesat që na bashkojnë. Jam më se e bindur se ka elemente që duhet t'i vlerësojmë në këtë projektligj dhe të merren masa më të rrepta për të siguruar që shërbimet e medieve audiovizive, të ofruara nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive, si dhe ofruesit e platformave mund ta dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor apo edhe moral të fëmijëve. Ndaj do të duhet të vendosim në dispozicion një informacion më të kontrolluar.

Në anën tjetër, këto lloj masash që parashikohen në ligj, përcaktojnë edhe kohën e duhur për transmetimin e materialeve apo informacionit që lidhet me fëmijët, por po ashtu edhe mjetet që verifikojnë moshën e fëmijës dhe aksesin që mund të kenë ata në informacione të caktuara.

Nërkohë, në periudhën e COVID-it (apo edhe gjatë fushatave, meqenëse flasim për politikë këtu) të gjithë ishim koshientë dhe u përballëm me pjesën e lajmeve të rreme, se si ky aspekt apo edhe gjuha e urrejtjes dhe linçuese merr përmasa të tjera. Jemi të vetëdijshëm që mund t'i hedhim hapat me shumë kujdes për të mbajtur një ekuilibër sa më të plotë ndërmjet nevojës për informacion cilësor dhe për një informacion që i garanton të gjitha liritë dhe të drejtat kushtetuese të njerëzve, por edhe domosdoshmërinë për të mos u cenuar liria themelore e shprehjes. Sigurisht, as nuk presim që ligjet që kemi aktualisht, por edhe këto amendamente që po bëjmë, ta zgjidhin sa hap e mbyll sytë problematikën në këtë fushë. Gjithsesi, mendoj se vendosja e një sistemi rregullash më të mirë dhe më të qarta, është pa diskutim në funksion të përmirësimit të situatës dhe në funksion të përmirësimit të marrëdhënieve mes ndjekësve të medias dhe burimeve të informacionit.

E mirëkuptoj, pse jo, edhe frikën e njerëzve të medias sa herë që bëhet fjalë për ndryshime ligjore në këtë fushë, por besoj se kuadri ligjor që ka Shqipëria, që nga përcaktimi në Kushtetutë për të drejtën informimit dhe të shprehjes, besoj se

sigurojnë terrenin e duhur për të vepruar. Kam besimin e plotë se shumë gazetarë, drejtues medias, po ashtu edhe pronarë punojnë me përkushtim për përmbushjen e misionit të tyre të vështirë. Edhe për ne si mazhorancë një media e pavarur është më se e domosdoshme për të rregulluar edhe ato gjëra që nuk i bëjmë ashtu siç duhet, por si në çdo fushë, edhe në media ka persona, që përhapin portale anonime, të cilët janë mëkatarë.

Vitet e fundit në Shqipëri janë regjistruar mbi 20 mijë portale, me prapshitesën "al" dhe dhjetëra mijëra të tjera në gjuhën shqipe, që funksionojnë në vendin tonë, por me prapshitesa të tjera. Nga këto, mbi 700 portale janë portale lajmesh, prej të cilave, deri pak kohë më parë, vetëm 12 administroheshin nga struktura redaksionale dhe vetëm 72 prej gazetarëve. Të tjerat, më shumë se 600, për një pjesë të madhe të tyre, as nuk dihet se kush i ka në zotërim apo si financohen. Besoj se është në interesin tonë, të shoqërisë tonë që, cili është mashtrues, linçues, që përdor gjuhën e urrejtjes, që keqpërdor misionin e mediave, është gjobëvënës, duhet të marrë dënimin që meriton, sipas ligjit, për shpifje dhe për fyerje. Kush punon drejt në këtë fushë, pa diskutim duhet të ketë të gjithë të drejtën të meritohet respekt dhe vlerësim nga shoqëria për misionin fisnik që kryen. Kjo nuk është vetëm një sfidë ligjore, por është një sfidë e të gjithë shoqërisë shqiptare. Po ashtu, do të duhet të punojmë më shumë për pjesën e vetërregullimit të medieve.

Për sa i takon shqetësimit të ndonjë kolegu nga opozita, do ta siguroj se këto ndryshime dhe nisma të mëparshme, të marra nga mazhoranca, nuk e cenojnë aspak lirinë e medias dhe të shprehjes. Ka ikur koha që për shkrime të caktuara që cenonin Presidentin, digjej një gazetë. Ka ikur koha kur cenoheshin gazetarët, madje arrihej edhe në cenime fizike shumë të rënda. Këtu dua t'ua sjell pak në kujtesë, sepse e keni harruar, gazetën "Koha Jonë", e cila ra pre e hakmarrjes primitive të shtetit dhe veglave të tij të bindura, duke rrezikuar jo vetëm jetën e gazetarëve, që sapo kishin mbyllur numrin e gazetës së nesërme, por e kam fjalën edhe për atë që ishte Kryeministër më 21 janar, i cili dha urdhër për të cenuar jetën e një gazetari.

E kam fjalën edhe për ndonjë që sot nuk është në këtë sallë, por që vjen shpesh dhe e

përdor gjithmonë këtë foltore për të cenuar gjithkënd, çdo medie e çdo gazetar që flet për bëmat e korrupsionit. Ndaj, të nderuar kolegë, ka ikur koha kur mazhoranca, qeveria dhe pushteti ishin në funksion të interesave personale të familjarëve të atyre që e drejtonin, por është koha që të respektojmë liritë personale dhe lirinë e shprehjes për të pasur një media të lirë.

Jam e bindur se kjo nismë që miratojmë sot, vendos një gurë më shumë në përpjekjet tona për ta siguruar lirinë e shprehjes së medieve, por në të njëjtën kohë edhe për të krijuar një mjedis të shëndetshëm për shoqërinë. Ndaj, do t'ju bëj thirrje të gjithëve ta votojmë këtë nismë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Po, zonja Aça. Replikë keni kërkuar?

**Flutura Aça** – Jo, nuk kam replikë. E kam kërkuar fjalën për procedurë. Zonja Kryetare, përderisa po diskutohet një ligj, kam përshtypjen se edhe ligjërisht, por edhe për njëfarë etike, ministrja e linjës duhet të jetë në sallë, apo jo? Nuk shkon. E ka detyrim ligjor.

Vura re herën e parë, kur zonja Tabaku me ministrën patën një diskutim në lidhje me një ligj të caktuar, gjithë kohës zonja pas shpinë as që i dëgjonte fare kritikën që i adresoheshin asaj personalisht, por gjithë kohës merrej me telefonin. Kjo nuk është normale. Këtë vërejtje kisha.

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Tritan Shehu.

Të përgatitet zonja Merita Bakiu.

**Tritan Shehu** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë, pa dyshim të diskutosh për mediat dhe për ligjet që lidhen me to, është një eveniment i madh në çdo parlament të botës demokratike, sepse media është një nga kolonat thelbësore dhe bazale të demokracisë së një vendi. Media është shëmbëlltura e nivelit të demokracisë së çdo vendi. Këtu realisht dua të përfitoj nga rasti për të shprehur të gjithë respektin e thellë, admirimin tim që kam për gazetarët, për punonjësit e medieve, pavarësisht nga opinionet e ndryshme që mund të kenë, pavarësisht nga pyetjet e vështira, që ndonjëherë edhe mund të na nervozojnë, por në atë mënyrë ata bëjnë vetëm detyrën e tyre, misionin e tyre, rolin e tyre kaq të rëndësishëm për një vend demokratik.

Media e lirë është baza e lirive të njeriut, baza e lirive të fjalës së lirë dhe mendimit, pra

është në esencë të demokracisë. Fatkeqësisht, në Shqipëri nuk ka medie të lira. Ka gazetarë të lirë që përpiqen të shfrytëzojnë hapësirat e demokracisë, por nuk ka medie të lira. Shqipëria pas kaq vitesh demokraci ka bërë një regres të madh në nivelin e lirive dhe në nivelin e medies. Këtë e tregojnë qartësisht edhe raportet ndërkombëtare, të cilat nuk dua t'i përmend. Këtë e tregojnë qartësisht ngjarjet dhe zhvillimet konkrete në Shqipëri. Pra, unë do të them se në Shqipëri ekziston realisht një media e cunguar apo më mirë të themi një media e privuar. Një medie e tillë, e cila edhe vetë vuan, e ndien këtë privim nga liria dhe demokracia. Shqipëria ka një gjendje të tillë, sepse kjo është pa dyshim në sinkron me nivelin e demokracisë, sepse Shqipëria sot ka një nivel demokracie të cunguar. Shqipëria ka kaluar dhe po kalon nga demokracia në autokraci dhe po futet në një autokraci të thellë lindore, e cila pa dyshim pasqyrohet edhe në nivelin e lirisë që ka vetë media.

Jam dakord me shumë kolegë të opozitës që thonë se ligji që ju paraqisni, nuk rregullon gjë. Ky ligj nuk rregullon gjë, sepse është i cunguar dhe i lë shumë elemente qeverisë, administratës, pushtetit dhe shtetit, kur media duhet të jetë e pavarur. Fatkeqësisht, te ne edhe institucionet që merren me mediat, të cilat duhet të mbrojnë, të kontrollojnë lirinë e medieve dhe të sinkronizojnë lirinë e medieve me nivelin e demokracisë së një vendi, janë krejtësisht nën varësinë e shtetit dhe politikës. Kështu kërkojnë të krijojnë një ansambël të rrezikshëm për demokracinë e çdo vendi.

Këtu u fol për dhunë, për kërcënime dhe për përdorime fondesh ndaj medieve, të cilat absolutisht që kanë marrë dimensione të frikshme. Do të them vetëm diçka, të cilën e kemi parë së bashku kohët e fundit, atë që u bë ndaj një medieje, sepse e thoshte fjalën ashtu se si e mendonte ajo, se si u rrënuan pronat e saj, se si u rrënuar resorti në Durrës, se si u dërguan fadromat në mënyrë krejtësisht të paligjshme, arbitrare, antidemokratike dhe diktatoriale për ta rrënuar atë medie dhe për ta detyruar të ndryshojë linjën e saj editoriale.

Çdo medie ka linjën e saj editoriale. Kjo është liria e medies, kjo është e drejta e medies, por këtu kjo gjë nuk pranohet dhe nuk tolerohet dot, sepse linjat e një medieje duhet të jenë në përputhje me linjën e propagandës së shtetit, me

interesat e shtetit, sepse një medie, e cila nuk pranon të tjetërsojë linjat e saj, goditet dhe shkatërrohet, siç ndodhi me “Prestige Resort” në Durrës, e cila ishte një nga pamjet më të dhimbshme dhe tragjike të nivelit të demokracisë së një vendi. Ne në këtë mënyrë po e kthejmë përdorimin e medias si fasadë e shtetit, po e kthejmë përdorimin e medias për propagandën e shtetit.

Ju, të nderuar kolegë deputetë, po keqpërdoren nga një shtet, i cili ka në themelin e tij propagandën gebelsiane dhe Gebelsin si model të propagandës. Në një vend demokratik nuk mund të ketë një bashkëjetesë mes demokracisë, të parimeve demokratike me propagandën gebelsiane. Ju doni t’i indoktrinoni njerëzit, ju doni të përdorni çdo gjë për të bërë shpëlarjen e trurit dhe për të futur më pas brenda tij propagandën tuaj, por kjo nuk është demokraci, madje për ta arritur këtë ju përdorni çdo mjet. Nuk keni hezitim para mjeteve. Ju i përdorni fondet shtetërore për reklama për mediet, fonde gjigante, të cilat ua jepni atyre që doni, nuk ua jepni atyre që kanë një diskordancë me ju për çështje të ndryshme të vendit. Ju përdorni presionet ndaj njerëzve, pastaj përdorni edhe buldozerët, ekskavatorët, policinë dhe bëni që edhe gjykatat të heshtin kur ju kryeni dhe realizoni këtë terror ndaj medieeve.

Duke goditur një medie, ju kërkon t’i terrorizoni të gjitha mediet shqiptare. Ky ligj që keni sjellë nuk i përmirëson dhe nuk u kundërvihet këtyre gjërave, pra nuk sjell diçka të re. Veçanërisht kjo arrin kulmin gjatë fushatave elektorale, kur ju i keqpërdorni në ekstrem mediet, administratën dhe përdorni propagandën shtetërore kur nuk lejohet. Ky është kulmi. Ju përdorni blerjen masive në fushata elektorale. Ju arrini deri aty sa kërkon t’i tjetërsoni politikën dhe partitë politike për interesat tuaja dhe për kohën mediatike. Ju i “varni” dikujt një vulë dhe thoni se kjo është Partia Demokratike dhe kjo është opozita, duke i dhënë 2 milionë euro (1 milion për aktivitetin vjetor dhe 1 milion për fushatën) një njeriu që nuk përfaqëson asgjë. A nuk është ky deformim i realitetit politik? A nuk është kjo vjedhje e dimensionit të madh? A nuk është ky dimension i korrupsionit të madh për të tjetërsuar realitetin politik edhe mediatik të vendit?

Ju, duke i dhënë këto fonde, e bëni pa dyshim influent në media dhe i jepni kohën

mediatike një paterice që nuk përfaqëson asgjë, që nuk është askush dhe ata që ka vënë në Shqipëri si kandidatë, po i ikin një nga një. A është kjo e moralshme? Unë them se politika ka moral. Në thelbin e saj politika është vlerë, moral dhe nuk është një vendim i Gjykatës së Apelit apo një “vulë e varur në qafë” nga Rama patericës së tij, por ka vlera. Por ju nuk keni vlera. Në këtë mënyrë deformoni edhe medien, sepse e vini edhe medien në pozita për të deformuar realitetin politik të vendit në fushatën që po vjen.

Ky ligj nuk e ndalon këtë gjë, nuk ka se si ta ndalojë, por këtë e ndalon morali, parimet, drejtësia e lirë dhe media e lirë që ju e keni shkelur. Kjo është e vërteta. Po ju them se kjo është hajdutëri e pasurisë kombëtare, edhe e vlerave, e taksapaguesve shqiptarë, për t’u keqpërdorur, përveçse është imoralitet i atyre që pranojnë të përdoren në këtë pikë. Nga ana tjetër, kjo që po ndodh në Shqipëri, është memecllëk i atyre që rrinë të heshtur kur shikojnë këtë deformim kaq të thellë të demokracisë, këtë keqpërdorim të fondeve shtetërore, këtë blerje politikanësh (ta themi qartë që është një blerje e thellë politikanësh dhe korrupsion masiv). Kjo pa dyshim reflektohet edhe te media, sepse në këtë mënyrë shkatërrohet edhe media e lirë, por ky ligj nuk bën absolutisht gjë për ta rregulluar këtë gjë. Ky ligj hedh një mballomë mbi një sëmundje të rëndë që ka media, demokracia shqiptare, sepse ajo reflekton sëmundjen e demokracisë shqiptare për respektimin e vlerave morale, dhe tashti, në prag fushate, kërkohet të përdoret si një gjethe fiku e një realiteti tragjik që kemi në vendin tonë, në nivelin mediatik dhe në nivelin e demokracisë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjala për zonjën Ina Zhupa!

Përgatitet zonja Lindita Buxheli!

**Ina Zhupa** – Faleminderit!

Diskutojmë në lidhje me projektligjin për AMA-n, ndaj duhet ta nisim me një realitet: çfarë përfaqëson AMA sot? Sipas ligjit, AMA sot duhej të ishte një institucion i pavarur, por që në fakt drejtohet nga ish-zëdhënësja e Edi Ramës, një njeri politik që drejton një institucion të pavarur për kontrollin e medieeve audiovizive. Kjo për të kuptuar mjedisin që është ndërtuar për median, mjedisin që është ndërtuar për ligjshmërinë e veprimeve të këtij autoriteti në lidhje me median, se si trajtohen mediet proqeveritare, ndryshe nga

mediet që guxojnë të bëjnë opozitë, që guxojnë të thonë realitetin. Sepse, të thuash realitetin sot në Shqipëri, konsiderohesh si opozitar dhe vihesh nën dritën e prozhektorëve për t'u sulmuar.

Sot Shqipëria ka 110 milionë euro për të paguar për shkak të një sulmi politik të bërë ndaj një medieje, siç ishte Agon Channel, për shkak të sms-ve të dërguara në celularin e pronarit nga politikanë, për shkak të mbylljes shtetërore, vetëm sepse kjo medie transmetonte të vërteta për qeverisjen e Rilindjes. Cila është përgjigjja që sjell qeveria? Në vend që të bëjë një *mea culpa* dhe të ndryshojë mjedisin për mediet, kundërpërgjigjja është: po e mendojmë të dalim nga Traktati i Arbitrazhit. Asgjë më shumë se një diktator i vogël, që tenton të izolojë Shqipërinë nga një traktat me 160 vende të botës, që siguron klimën e biznesit për investimet e huaja, që jep garanci dhe siguri ligjore jo vetëm për mediet, për biznesin mediatic, por edhe për çdo biznes tjetër.

Përgjigjja është: të dalim nga ky traktat. Ne do të izolohehi. Ne do të kthehemi në Shqipërinë komuniste, ku ligjet tona i bëjmë vetë, ku ligjet tona do të na detyrojnë ne që të mos i shkelim, por që ne i ndryshojmë ato sa herë të duam, apo siç thoshte figura e adhureshme e këtyre: pse, ligjet tona do të na ndalojnë ne? Me këtë citat, ju sot keni vendosur mënyrën si trajtoni mediet, mënyrën si trajtoni bizneset, mënyrën si trajtoni qytetarët në këtë vend. Për herë të parë në historinë demokratike, pesë dhoma tregtie janë bashkuar dhe kanë dalë me një deklaratë të përbashkët pikërisht në lidhje me rreziqet dhe klimën antibiznes, që është ndërtuar nga fryma e kësaj qeverie. Në momentin kur pesë dhoma tregtie: Dhoma Amerikane e Tregtisë, Dhoma Gjermane e Tregtisë, Dhoma Italiane e Tregtisë, Confindustria, Dhoma Franceze e Tregtisë, të gjitha këto dalin me një deklaratë të përbashkët, për qeverinë duhej të kishte një moment reflektimi, një moment për të kuptuar se çfarë po ndodh në këtë vend. Përkundrazi, për ju është një moment tjetër tallavaje, një moment tjetër propagande, një moment tjetër në të cilin me paratë e buxhetit të shtetit, ministria e propagandës të shpërndajë kaseta të gatshme në prag të fushatës elektorale. Sot ministria e propagandës ka ngelur pa ministrin e vet të propagandës, sepse i duhej në bashkinë e Tiranës, për ta bërë këshilltar të kësaj bashkie.

Kryeministrit shqiptar nuk i pëlqejnë gjykatat, madje aq shumë, sa u çudit kur i rrëzuan ligjin e medias, sepse kishte vendosur që gazetarët do të paguanin 20 mijë euro gjobë pa prituri vendimin e gjykatave dhe pa u çuar në gjykatë. Tha: çfarë problemi ka? Le t'i paguajnë. U çudit kur ia rrëzoi Komisioni i Venecias, sepse ai

ka zero respekt për shtetin e së drejtës, zero respekt për gjykatat, zero respekt për ata që bëjnë një punë të ndershme, siç janë gazetarët. Në fakt, janë gazetarët ata që e vuajnë edhe më shumë se pronarët e medieve gjithë represionin e kësaj qeverie, që nga qeverisja lokale, nga këta bajraktarët lokalë në krye të bashkive, që bëjnë kërcënime sa herë që del një lajm kundër tyre, sa herë del një lajm në lidhje me keqmenaxhimin e bashkive të tyre, sa herë flitet për një rrugë të pashtruar, që me demokracinë është e shtruar, gjë për të cilën ju keni kryebashkiakë në burg, në këto raste kërcënohen gazetarët, kërcënohen familjarët e tyre, i çohet mesazhi pronarit të medias. Dhe kur linja editoriale e ca medieve nuk pëlqehet, përfundohet në raste që ne i njohim sot, se si konfiskohet media, si televizionet Ora dhe Ora News, se si pronarët goditen në biznese të tjera të ndershme, me synimin për të goditur medien.

Kemi rastin flagrant të dramës me tre akte, deri më tani, të zhvilluar në "Prestige Resort", që ende nuk dihet a do të vazhdojë drama dhe paligjshmëria vetëm sepse nuk e ka ndryshuar akoma linjën editoriale, sepse i përgjigjet më shumë të vërtetës se sa porosive të agjencisë së propagandës dhe të Kryeministrit. Ne diskutojmë sot këtu se do të përafrojmë legjisllacionin me Bashkimin Europian, se do të përafrojmë standardet e Bashkimit Europian, ndërkohë që këtu porositen se cilët do të jenë pronarët e medieve, porositen shitje dhe blerje të medieve. Pastaj ne diskutojmë se po përafrojmë legjisllacionin, që të ketë më shumë mundësi, më shumë të drejta për të kuptuar se cilët janë ofruesit e shërbimeve.

Gjatë fushatave elektorale, gjë që do ta shikoni edhe në këtë fushatë elektorale, sepse nuk pres të jetë e ndryshme, televizionet nuk pyesin për sanksionimet, për rregullat, për kohën televizive, për barazinë e kohës televizive, por e trajtojnë Kryeministrin si Kryeministër, në kuptimin se nuk po bën fushatë elektorale kur bën një promovim, nuk po bën fushatë elektorale kur shpërndan leje legalizimi, nuk po bën fushatë

elektorale kur shkon e përruron një copë rrugë, por po bën punën e tij si Kryeministër. Kësaj i thonë të kesh syzet e pushtetit, të vëna një institucioni të pavarur, i cili duhej të kishte barazi edhe për shkak të legjislacionit, edhe për shkak të asaj që thotë ligji, sepse, kur ne votojmë në mënyrë të përbashkët disa ligje, i votojmë me shpresën se këto ligje do të zbatohen. Nuk i votojmë thjesht për t'u hedhur hi syve institucioneve të Bashkimit Europian, që ja, ne u përfruam me *Acquis communautaire* dhe tani jemi më të gatshëm të afrohemi në familjen europiane.

Ne duhet të afrohemi me veprime në familjen europiane. Nuk duhet të kemi një Kryeministër që kërcënon median, një Kryeministër që shan e ofendon mediet dhe gazetarët, që i çon ata në riedukim, një Kryeministër që mbyll mediet, dhe ne pastaj paguajmë gjoba në arbitrazh, një Kryeministër që nuk arrin të dallojë dot se ku fillon liria e medias dhe ku mbaron liria e tij si Kryeministër për t'i ushtruar presion apo për t'i kërkuar llogari medias, si një pushtet tjetër që nuk varet nga ai. Por në këtë Shqipëri, ku ai ka kapur të gjitha pushtetet, ku ka kapur edhe institucionet e pavarura, i duket normale të kërkojë të kapë e të udhëheqë, për të qenë edhe në krye të pushtetit mediatic, tashmë, me emisionet e reja, me podcast-et e reja që prodhon ai vetë, në orarin e tij si Kryeministër.

*(Bie gongu.)*

Vetëm pajisjet, siç e thoshte eksperti Gent Progni, kushtonin mijëra euro. Ju, që do të bënit fushatë të lirë, vetëm pajisjet e podcast-it, i kushtonin mijëra euro Kryeministrit. Vetëm pushteti i tij si Kryeministër, për të marrë me detyrim atje personazhet, është i dënueshëm.

*(Bie gongu)*

Dhe ju që do të bënit fushatë të lirë, fushatë që e keni vendosur vetë, që do të quhet ashtu siç keni qeverisur: për para!

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zonjën Lindita Buxheli!

Përgatitet zoti Flamur Noka!

**Lindita Buxheli** – E nderuara Kryetare!

Të nderuar deputetë!

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, pasi diskutoi gjatë dhe dëgjoi grupet e interesit, shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013, “Për

mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””. Ky projektligj ka për qëllim rishikimin e rregullave për transmetuesit audiovizivë, si dhe për ofertuesit e platformave të shpërndarjes së videove, për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme, përfshirjen e rregullave për sigurimin e aksesit në informacion të personave me aftësi të kufizuara, rritjen e transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatiche, përforsimin e detyrimeve për ofruesit e shërbimeve audiovizive me kërkesë.

Gjithashtu, përmes këtyre ndryshimeve propozohet rishikimi i detyrimeve të mbartjes në linjë me direktivën 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Europës, datë 11 dhjetor 2018, mbi krijimin e Kodit të Komunikimit Elektronik Evropian.

Objektivat që synohen të arrihen me miratimin e këtij projektligji janë:

-Mbrojtja e dinjitetit, të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, veçanërisht të fëmijëve, nga përmbajtje që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor apo moral të tyre

-Garantimi i së drejtës së informimit dhe lirisë së shprehjes

-Rritja e transparencës së pronësisë së ofertuesve të shërbimeve mediatiche

-Nxitja e vetërregullimit dhe bashkërregullimit, si një plotësim i mekanizmave legjislativë, gjyqësorë dhe administrativë

-Përcaktimi i rregullave të reja për platformat e shpërndarjes së videove

-Sigurimi i aksesit në përmbajtjet audiovizive të personave me aftësi të kufizuara  
Konsultimi publik.

Ky projektligj është konsultuar përmes regjistrimit të konsultimeve publike gjatë periudhës shtator-tetor 2022, si dhe është rishikuar gjatë periudhës 12.12. 2022. Gjatë konsultimit publik u paraqitën sugjerime nga organizata të shoqërisë civile në mbrojtje të grave. Gjithashtu, në rrugë elektronike paraqitën disa komente Dhoma Amerikane e Tregtisë, dhe pranë AMA-s disa operatorë të shërbimeve audiovizuale. Për sugjerimet e dhëna është kthyer përgjigje, duke sqaruar që pjesa më e madhe e tyre janë pjesë e rregullimit përmes akteve nënligjore, si kodi i transmetimeve që është në proces rishikimi dhe konsultimi nga AMA.

Projektligji është konsultuar me Komisionin Evropian, si dhe me ekspertët e organizmave

europiane të medieve audiovizive. Komisioni European u shpreh se përfshirja e këtyre rregullimeve përbën kusht për vijimin e përfitimit të Shqipërisë nga programi Creative Europe. Nga ekspertët e Organizatës Europiane Observatore të Medias u dhanë sugjerime dhe eksperiencia të vendeve të BE-së për rregullimin e platformave online.

Më konkretisht, në këtë projektligj parashikohet marrja e masave të rrepta për të siguruar që shërbimet e medias audiovizive, të ofruara nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive si dhe nga ofertuesit e platformave të shpërndarjes së videove, që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve, të vihen në dispozicion vetëm në atë mënyrë që siguron se, normalisht, fëmijët nuk do t'i dëgjojnë ose nuk do t'i shohin ato.

Këto masa mund të përfshijnë përzgjedhjen e kohës së transmetimit, mjetet e verifikimit të moshës ose masa të tjera teknike. Të dhënat personale të fëmijëve, të mbledhura apo të nxjerra nga OSHMA-të nuk do të përpunohen për qëllime tregtare, të tilla si për shembull marketingu i drejtpërdrejtë, profilizimi apo për çdolloj arsye tjetër. Edhe për personat me aftësi të kufizuara janë zgjeruar dhe rritur kërkesat për OSHMA, duke shtuar detyrimin e tyre, që në mënyrë progresive t'i bëjnë shërbimet e tyre më të arritshme për këtë kategori personash. Për herë të parë, në këtë projektligj përfshihen konceptet e bashkërregullimit dhe të vetërregullimit, përmes kodeve të sjelljes, akte të cilat do të përcaktojnë standardet dhe praktikën që duhet të respektohen nga ofertuesit e shërbimeve mediatike që ofrojnë shërbime mediatike audio dhe audiovizive.

Tjetër risi që sjell ky projektligj është përfshirja në të e konceptit të edukimit mediatik, ose thënë ndryshe, aftësia, njohuria dhe të kuptuarit, që u lejon individëve të përdorin në mënyrë të sigurt dhe efektive përmbajtjet e shërbimeve mediatike audiovizive. Aktualisht, nuk ka një parashikim të këtij koncepti në ligjin aktual dhe promovimi i tij është parashikuar si një nga funksionet e autoritetit rregullator.

Ndryshimet e propozuara do të sjellin rritjen e nivelit të përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit lidhur me përmbajtjet e transmetuara nga OSHMA, forcimin e masave lidhur me fëmijët, garantimin e të drejtave të tyre në komunikimet tregtare, mbrojtjen e të dhënave të tyre personale

si dhe garantimin e të drejtës kushtetuese për informimin e personave me aftësi të kufizuara. Institucioni përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e ndryshimeve që sjell ky projektligj është Autoriteti i Mediave Audiovizive, nëpërmjet hartimit të legjislacionit nënligjor, si dhe ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive dhe ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik u vlerësua se projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2013, “Për mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë””, në aspektin procedural është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit; në aspektin ligjor është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Kësisoj, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me shumicën e votave, ndaj ju ftoj të gjithëve që ta miratojmë këtë projektligj.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjala për zotin Flamur Noka!

Përgatitet zoti Florenc Spaho!

**Flamur Noka** – Ndoqa çdo diskutant, që nga mëngjesi, kur ka filluar kjo seancë e deri më tani. Prita që diskutantët e maxhorancës të kishin një qëndrim në lidhje me një ngjarje makabër, me një akt të terrorizmit politik, të ushtruar ndaj drejtuesit të opozitës në bashkinë e Vaut të Dejës.

Këtu, në këtë parlament, hartime bëhen pa fund, teori boshe tirren gjithnjë pa fund, por ajo ngjarje është diçka e rëndë, zonja kryetare, që më së paku është dënuar nga çdo qytetar, nga çdo njeri normal. Aq më tepër, zonjë, ne që jemi politikanë e kemi detyrë, pasi me mandatin tonë kemi marrë përsipër të përfaqësojmë qytetarët. Ndërsa ju, që jeni në pushtet dhe e keni për detyrë të mbroini jetën, pronën dhe liritë e çdo qytetari shqiptar, duhej të kishit reaguar. Reagoi Elisa, duke vënë gishtin te Sali Berisha dhe Ilir Meta. A ka gjë më të neveritshme se kjo: që situata e shkaktuar ishte faji i Sali Berishës dhe i Ilir Metës?



Askush nga kjo maxhorancë nuk belbëzoi as edhe një fjalë për të dënuar këtë akt terrorizmi politik.

Familja e Bernard Ndrecës, zonjë, se ti vjen nga ajo zonë komshije me të, është një familje e nderuar në atë vend, është një familje që brez pas brezi nuk ka pasur kurrë as hasmëri, as problematika. Gjon Ndreca ka rritur 3 djem dhe një vajzë, fëmijë të mrekullueshëm, të cilët nuk i kanë hyrë në hak askujt në historinë e tyre jetësore. Ata kanë vetëm një faj: kanë përfaqësuar dhe përfaqësojnë Partinë Demokratike dhe opozitën e këtij vendi sot. Për këtë faj, duke qenë se kolegu ynë, Zef Hila, dorëzoi mandatin për të shkuar për t'u shërbyer banorëve të Vaut të Dejës dhe Bernard Ndreca, si kryetar i Partisë Demokratike atje dhe i opozitës, mori përsipër të drejtojë fushatën e kolegut tonë, ai duhet likuiduar politikisht. Ky ishte vendimi që u mor, një vendim politik.

Ta harroni ju se mund të kalojnë situata dhe ngjarje të tilla duke mbyllur gojën, duke bërë memecin. Po jua përsëris: as Benard Ndreca dhe as familja e tij nuk kanë pasur problematikë me ligjin apo me shoqërinë. I gjithë ky atentat politik i është bërë vetëm për arsye politike. Çfarë tregon kjo? Kjo tregon qasjen tuaj, qasjen e kësaj mazhorance, qasjen e këtij regjimi ndaj opozitës. Pse? A mund të shpjgohet ndryshe që Kryeministri, pa u bërë disa orë nga ngjarja, ishte në aktivitet dhe nuk e përmendi fare?! Askush nga ju sot nuk e përmendi fare, a thua se atje ishte goditur një mizë, jo lideri i opozitës i një prej bashkive të këtij vendi, dhe jo një njeri, një familjar i shkëlqyer, pa asnjë problematikë me ligjin. Bëtë gjithçka kundër opozitës; bëtë gjithçka për ta përçarë; bëtë gjithçka për ta likuiduar politikisht, tani, ngaqë nuk ia dolët, po tentoni të bëni edhe likuidime fizike. Vini këtu e fusni kokën në ato tavolina si “struci në rërë”, dhe nuk keni kurajë, kur edhe një kriminel, kushdo qoftë në këtë vend, po t'i ndodhin ngjarje të tilla, duhet reagim, duhet dënim. Pse?! Sepse edhe për kriminelin nuk është tritoli një zgjidhje e shtetit demokratik, nuk është likuidimi, por është ligji, drejtësia, jo më për liderin politik të një zone.

Çfarë tregoni me këtë?! Që mbrapa atij atentati politik jeni ju, është Edi Rama. Prandaj nuk bëzani asnjë fjalë për ta dënuar. Pa lejen e Edi Ramës dhe të ministrit të familjes, nuk ka asnjë delikuent në këtë Shqipëri që guxon të shkojë të

ndërmarrë një akt terrorizmi politik ndaj një drejtuesi politik. Këtë ta harroni! Pse? Sepse ju e shihni veten të pashpresë. Askush nuk ju pret, askush nuk ju takon. Ndaluar edhe takimet me idenë e kursimeve, sepse Edi Rama takohet vetëm nga administrata; nuk ka qytetar që del t'ju takojë, t'ju mirëpresë dhe t'ju mbështesë, as ju dhe as administratën. Prandaj e bëtë këtë, sepse për shpenzime e bëri Edi Rama takimin, prezantimin e kandidatëve aty në shesh. Pastaj futi një milion euro festën, duke u harbuar gjithë natën. Harroi që disa nga qejflinjtë brenda asaj feste, të pirë dhe nën avujt e alkoolit, ia nxorën, e bënë publike atë festë për shqiptarët. Sa?! Pesë orë pasi tha: “Ne nuk do të shpenzojmë”. Po, po, nuk do të shpenzoni ju, sepse strategjia juaj është terror dhe blerje. Çfarë keni bërë? Pse nuk ka folur asnjëri? Ku është zotëria këtu?

Zonja Kryetare e Kuvendit, duhej të kishit folur, të paktën të kishit dhënë një mesazh që dënohet akti terrorist, pra të dënohet ky veprim. Mendoni sikur ai tritol t'i ishte vënë ndonjërit prej jush, çfarë do të thoshit? Do të drejtonit gishtin direkt, ndërsa këtu fërkoni duart. A ka fytyrë njerëzore kjo qeveri, moj zonjë? A mund ta quajë kush më këtë qeveri? Ju jeni regjim, por tani keni kaluar çdo limit. Përgjigjen do ta merrni më 14 maj në Vaun e Dejës dhe në të gjithë Shqipërinë. Nuk ka presion, shantazh, para apo tritol që do ta ndalojë vrullin e demokratëve, të opozitarëve të këtij vendi për t'ua treguar vendin të parit Edi Ramës, por edhe ju të gjithëve, se vetëm mazhorancë nuk jeni; jeni një grup i strukturuar kriminal dhe asgjë më tepër.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Zoti Berisha, për çfarë e keni kërkuar fjalën? Për procedurë?

Po, urdhëroni.

**Sali Berisha** – Sot seanca duhet t'i kushtohet aktit të shëmtuar terrorist shtetëror, me të cilin partia terroriste e krimit, Partia e Punës e Shqipërisë, u rishfaq me të gjithë shëmtinë e saj në Paçram të Vaut të Dejës, ku vendosi tritolin për t'i marrë jetën një politikani të ri, një politikani të shkëlqyer, një qytetari shembullor, bir i një familje shembullore.

Nuk ka diskutim se në tërë historitë e botës mbrapa çdo atentati politik qëndron politika. Nuk ka atentat politik me shkaqe të tjera përveçse politike. Këtë Edi Rama e faktoi në mënyrën më të shëmtuar me heshtjen e tij kriminale 48-orëshe.

U godit, siç e patë ju, për t'i marrë jetën një politikan i ri, mbi të cilin janë vetëm ëndrrat dhe idealet më fisnike të njeriut, të atdhedashurisë, të besimit të liria. U godit si kundërshtar politik në mënyrën më kriminale, më të shëmtuar. Natyrisht ata që panë se shpëtoi, nuk guxuan dot të shqipërojnë një fjalë të vetme dënimi, solidariteti me familjen, përkundrazi, u strukën në labirintet e kriminit të tyre të shëmtuar.

Dhe ky është Edi Rama. Nuk ka kryeministër në botë, në qoftë se do të ishte dorëjashtë, që nuk do ta dënonte në mënyrën më të fuqishme një akt të tillë, të dokumentuar mirëfilltë si krim politik, përveç atij që e ka porositur, atij që është kthyer te gjenet e etërve të tij.

Unë edhe një herë u shpreh solidaritetin tim më të madh Benard Ndrecës, familjes, demokratëve të Vaut të Dejës. I falënderoj me mirënjohje për shpirtin e tyre të pamposhtur, vendosmërinë e tyre për të fituar dhe për të vendosur Zef Hilën qytetar të parë të bashkisë së tyre! Dënoj heshtjen e shëmtuar kriminale të Edi Ramës, i cili faktoi me këtë heshtje se qëndron kryekëput me falangat e tij mbrapa këtij akti të vërtetë të terrorizmit shtetëror.

Sot diskutohet këtu për AMA-n. Ajo faktikisht është një institucion i arkivuar.

**Lindita Nikolla** – Zoti Berisha, mbaroi koha.

**Sali Berisha** – Dakord. Dy fjalë dhe nuk do të flas.

Nuk mund të flasësh sot për AMA-n. AMA është kompromisi më i shëmtuar “Rama-Basha”, “Basha-Rama”, “Brava-Rama” e me radhë. Që të dy kanë vendosur, si kurrë ndonjëherë në historinë e atij institucioni, zëdhënëset e tyre. E çfarë mund të presësh ti? Të dyja janë një, si ajo zonja, Armela, si ajo tjetra, që ishte zëdhënësja reale e Bashës. Faktikisht ato i ka emëruar Edi Rama, i cili sot ka kontroll të plotë mbi AMA-n.

**Lindita Nikolla** – Zoti Berisha, e kaluat minutazhin.

Mos më detyroni...

**Sali Berisha** – E para një herë, duhet të ndryshojë ligji dhe të hiqen të gjithë zëdhënësit nga AMA. Nuk mund të ketë zëdhënës në AMA, në qoftë se duam të mos tallemi me Europën.

**Lindita Nikolla** – Mbaroi koha, kaluat edhe 1 minutë e gjysmë.

**Sali Berisha** – Dakord.

**Lindita Nikolla** – Fjala për zotin Florenc Spaho.

Të përgatitet zoti Vangjel Dule.

**Florenc Spaho** – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Në fakt, ky ligj që sapo u përmend nga parafolësi, paska marrë një emër të ri, por besoj se ndryshon sa herë që ndryshon edhe klima politike brenda llojit dhe ndoshta do të marrë një emër tjetër!

Projektligji që kemi sot është sipas dispozitave të BE-së. Natyrshëm që integrimi i vendit tonë nuk mund të bëhet pa përafrimin e këtyre dispozitave. Iku koha kur vetëm një televizion apo një televizion e gjysmë bënte çfarë thoshte partia në pushtet. Sot media është e lirë. Në fakt, një vend që nuk ka një medie të lirë, nuk ka demokraci. Absolutisht nuk mund të keqpërdoret një medie nga persona të caktuar, të cilët e shohin median vetëm si biznes personal, gjobëvënës apo intimidues.

Hapësira digjitale sjell patjetër impakte pozitive dhe negative. Impakti pozitiv është informimi i publikut apo dhënia shoqërisë atë që kërkon. Intimidimi i shoqërisë, bullizimi apo përcmimi i grupeve të ndryshme shoqërore nuk mundet të bëhen më. Doja të sillja në vëmendje se në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik u bëmë të gjithë bashkë, kolegë të pozitës dhe të opozitës, për një qëllim të mirë: për një medie, e cila informon ashtu siç duhet, për një medie e cila e integron shoqërinë, përmirëson, rregullon dhe jep mesazhet e duhura, mbi të gjitha, jep mesazhe, të cilat sot, për shkak të aksesit që grupe adoleshentësh kanë në medie, mund të keqpërdoren, të intimidohen dhe mund të krijojnë një klimë aspak të favorshme për fëmijët tanë, një medie pa kontroll.

Themi shpeshherë se media është pushteti i katërt. Në fakt, sot shohim që media audiovizive, TikTok-u, Youtube, portalet, media *online* kanë ndikim shumë herë më të madh në shoqërinë tonë. Edhe pse është një media, e cila nuk është ekzekutive, mesazhet që përçon, janë mesazhet e një shoqërie që po rritet apo që duhet të rritet siç duhet. Nuk mundet që pas kaq vitesh çdokush, që investon në një medie, e cila mund të kapet apo kapet nga qarqe të caktuara, të përçojë mesazhet e gabuara.

Më vjen mirë që në projektligj ishin përfshirë për të dhënë mendim shumë grupe interesi, edhe forumi i zonjave që janë në medie, të cilat folën për ndalimin e gjuhës së seksizmit, të bullizimit apo të përcmimit. Shpresojmë që kjo lloj gjuhe sot e tutje të marrë fund. Zonjat janë jo vetëm pjesa jonë më e mirë, por janë motori i shoqërisë dhe gjuha seksiste që përdoret shpeshherë nëpër televizione, nuk duhet të ndodhë më. Shpeshherë ka televizione që përdorin etiketime, përcmime edhe për besimet fetare, për besimtarë, duke i bullizuar, duke i intimiduar, duke cenuar të drejtën dhe lirinë e fesë. Sot ka televizione që e bëjnë këtë, por jam besimplotë që me këtë projektligj, i cili vjen edhe për përafrimin e dispozitave të BE-së, këto gjëra nuk do të ndodhin më. Çfarë mund të themi sot, pas kaq vjetësh demokraci?! Do të thotë shprehje të mendimit të lirë, por pa cenuar, pa intimiduar figurën, qoftë edhe të një qytetari, jo më të një grupi të caktuar apo të një fryme, nuk ka rëndësi se cilit besim i përket. Shqiptarët kanë treguar që dinë të jetojnë dhe të bashkëjetojnë në një harmoni fetare të mrekullueshme. Këtë e kanë zili shumë vende të Europës, të Ballkanit dhe të rajonit. Ka media që paguhën pikërisht për t'i përçarë, për t'u vënë ngjyra, epitete, qoftë edhe duke i përcmuar.

Çfarë sjell tjetër ky projektligj?! Masat mbrojtëse kundër fëmijëve; akses më të madh, në fakt nuk më pëlqen të them “për personat me aftësi të kufizuara”, edhe pse në komision e kemi përdorur shpesh si term, do të preferoja të thosha “personat me aftësi speciale”, sepse vërtet ata persona kanë një gjë speciale, që ndoshta të gjithë ne nuk e kemi aq sa duhet. Këta persona me aftësi të kufizuara kanë një dashuri pa kushte, një energji që vetëm ata dinë ta japin. Falë këtij projektligji që vjen sot, do të bëhet më e aksesueshme media audiovizive, pikërisht edhe për këtë target grup.

Dëgjova këtu shpeshherë një frymë “e krimi”, disa terma që, në fakt, nuk shkojnë për shtat. U kërkoj ndjesë të gjithë shqiptarëve qoftë edhe për zërin tim, sepse, duke qenë edhe në agjërime, ndoshta timbri i zërit nuk është i duhuri. Nuk është mirë që, përderisa flasim për një medie të lirë, që pas kaq vjetësh, pas 50 vjetësh diktaturë, keqpërdorje edhe pas diktaturës, sot me rregullimin dhe përafrimin me dispozitat e BE-së, të bëjmë politikë, pasi nuk i shërben askujt. Nëse

duam që fëmijët tanë, shoqëria jonë të ecin në rrugën e drejtë, të mos bëjmë politikë, të japim opinione, mendime, të mos përdorim terma “u kap”, “nuk u kap”, “medie e kapur”, “qeveria bëri këtë, bëri atë”. Media është e lirë, por nuk mund të cenohet integritetin e askujt. Të mos përdorim terma që nuk na shkojnë.

Duke qenë se jemi edhe në një muaj të shenjtë, filloni bëni paqe me veten. Kush nuk ka agjëruar, të fillojë të agjërojë dhe të thotë gjëra me mend. Jam besimplotë që ky projektligj do t'u vijë në ndihmë të gjithë shqiptarëve, pikërisht për atë që kanë nevojë: për klimën e duhur të dëgjimit të gjërave, por gjërat e drejta vijnë nga një medie e lirë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Vangjel Dule.

Të përgatitet zonja Dhurata Çupi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Dule tërhiqet? Atëherë, fjala është për zonjën Dhurata Çupi.

**Dhurata Çupi** – Faleminderit, zonja Kryetare e Kuvendit!

Të nderuar kolegë,

Sot, në fakt, teksa diskutojmë për projektligjin “Për mediet audiovizive”, në të njëjtën kohë kemi dëshmi të raporteve ndërkombëtare, ku gjendja e sotme e medieve është më kritike se kurrë ndonjëherë. Mediet janë të censuruara, gazetarët janë nën presion dhe linja *editoriale* diktohet nga qeveria. Kjo është ajo që thuhet pothuajse në çdo raport ndërkombëtar, vit pas viti Shqipëria ka humbur shumë vende për sa i përket lirisë së medias. Në fakt, nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Në një vend ku Kryeministri i quan mediet “kazan”, i quan gazetarët “budallenj”, në një vend ku përpiket të shndërrohet vetë në pronar e drejtor televizioni, është e vështirë të imagjinohet se do të kishim media të lira dhe të pavarura.

Sot do të ndalem në tri raste tipike të të tria mandateve të kësaj qeverie dhe të këtij Kryeministri.

Në mandatin e parë, e mbani mend, Kryeministri dhe ministrat e tij iu vërsulën, me gjithë makinerinë shtetërore që kishin në dispozicion, televizionit “Agon Channel”. Ky është fakt publik, me të vetmen arsye sepse ishte një media opozitare, një media kritike me

qeverinë dhe kishte në organikën e saj gazetarë me integritet.

Sulmet dhe reprezaljet nuk ndaluan derisa ia dolën të shkatërronin një investim 40-milioneurosh. Ndryshe nga sa thoshte Kryeministri, se ato ishin para të pista, arbitrazhi ndërkombëtar në vendimin e tij thotë se vinin direkt nga Deutsche Bank, ndërkohë 110 milionë euro është detyrimi që sot qytetarët shqiptarë duhet të paguajnë për sjelljen e paligjshme të Edi Ramës dhe Kryeministrit të vendit.

Presioni ndaj medieve të pavarura dhe për të kontrolluar linjën e tyre *editoriale* vijoi sërish në mandatin e dytë ndaj një tjetër medieje. Kryeministri dhe ministrat përdorën të njëjtin mekanizëm, me paligjshmëri të plotë për të shkatërruar një tjetër media kombëtare, kritike dhe opozitare, kësaj radhe televizionin “Ora News”. Personalisht, vetë apo të tijtë, kërcënuan me prokurori e gjykata sikur këto të mos ishin institucione të pavarura, por mekanizma në shërbim të Edi Ramës. Edhe këtë televizion arritën ta konfiskojnë, por, fatmirësisht, nuk ia kanë dalë të shuajnë zërin e gazetarëve të këtij televizionit.

Ama, nuk u mjaftua me kaq. Në fillim të mandatit të tretë, pasi nuk ia doli të blejë nëpërmjet oligarkëve të tij, Edi Rama, me gjithë makinerinë shtetërore, me ruspa, me tritol, me polici dhe inspektorë, iu vërsul bizneseve të “Hysenbelliu Group”, duke shkatërruar një prej investimeve më të mëdha përgjatë bregdetit të Adriatikut, hotelin, ku Rama, ministrat dhe deputetët e tij kishin ngrënë dreka e darka, kishin skicuar projekte dhe ishin mburrur përpara miqve ndërkombëtarë si në rastin e afganëve. Papritur resorti u kthye në simbol të paligjshmërisë dhe duhej shkatërruar me çdo kusht.

Askush nuk di të thotë sot përse hoteli u shkatërrua me tritol, ndërsa godinat e tjera u konfiskuan, ndërkohë që së paku mund të ruhej i njëjti standard. Por ndoshta kësaj radhe Kryeministri druhej se, pasi gjykatat kombëtare e ndërkombëtare të shpallnin paligjshmërinë e këtyre veprimeve, shteti duhej t’i kthente godinat e konfiskuara. Prandaj hoteli duhej të shkatërrohej që të mos kthehej më kurrë.

Opinioni publik, i shokuar, u vu sërish para një akti të paprecedentë dhe, në paligjshmëri të plotë, në emër të institucioneve shtetërore u shfaqën individë të maskuar me mjete rrethanore

për të hapur dyert, sikur të ishin një bandë mafioze dhe jo nëpunës të administratës publike.

Tashmë është e njohur botërisht se ajo çfarë ndodhi në Prestige Resort ka zero lidhje me Kushtetutën apo me ligjin. Ajo është fund e krye e lidhur vetëm me faktin se Edi Rama nuk pranon kurrësesi që ndaj tij të ketë zëra kundër, të ketë zëra kritikë e opozitarë. Këtë nuk e them vetëm unë dhe opozita, këtë e thotë edhe Departamenti Amerikan i Shtetit në raportin për vitin 2022: “Sulmet ndaj Prestige Resort ishin për shkak të linjës *editoriale* të medieve të “Hasanbelliu Grup”.

Sjellja ndaj televizioneve “Agon Channel”, “Ora News” dhe “News 24” është fytyra e qeverisë shqiptare në raport me lirinë dhe pavarësinë e medias. Prandaj çdo iniciativë që ju sillni këtu, duke pretenduar se do të përmirësoni tregun medietik, është e gënjeshtërt, është fasadë, është hipokrizi. Qëllimi juaj i vërtetë është t’i shndërroni të gjitha mediet në ERTV dhe, meqë ra fjala për ERTV-në, unë u bëj thirrje ministrave dhe zotit Kryeministër: thuajuni shqiptarëve, me çfarë parash i keni paguar xhirimet, gazetarët, kameramanët dhe montazhierët, që punojnë për televizionin tuaj privat?

Hajdeni dhe thuajuni shqiptarëve: me çfarë parash e financoni *podcast*-in? Me çfarë parash i keni blerë pajisjet dhe keni mobiluar studion? Me çfarë parash i paguani kameramanët, montazhierët dhe stafin që punon për *podcast*-in tuaj?

Hajdeni këtu dhe bëni transparencë për fondet dhe për paratë që financojnë propagandën tuaj. Nëse nuk e bëni ju, atëherë këtë gjë duhet ta bëjnë organet ligjzbatuese, sepse nuk mund të kërkoni nga mediet atë që ju vetë nuk e bëni, zoti Kryeministër, transparencë të plotë, aq më tepër kur mediet punojnë me fonde private, ndërsa ju përdorni paratë e taksapaguesve shqiptarëve!

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Fadil Nasufi.

Të përgatitet zonja Monika Kryemadhi.

**Fadil Nasufi** – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” është përafuar thuajse plotësisht me direktivën 2010/13 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 10.03.2010, dhe, për

shkak të dinamikës, evoluimit dhe pasurimit pothuajse të përditshëm me risitë e teknologjisë së internetit, kërkohet që në këtë ligj të transpozohet direktiva 2018/1808 e BE-së, që ndryshon direktivën 2010/13 “Direktiva për shërbimin medietik me zë dhe figurë”.

Ndryshimet kanë për qëllim rishikimin e rregullave për transmetuesit audiovizivë, si dhe për ofruesit e platformave të shpërndarjes së videove, për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme, përfshirjen e rregullave për sigurimin e aksesit në informacion të personave me aftësi të kufizuara, rritjen e transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve medietike, përforcimin e detyrimeve për ofruesit e shërbimeve audiovizive me kërkesë.

Projektligji përfshin formulime, koncepte të reja dhe terma, si: bashkërregullimi, vetërregullimi, edukimi medietik, ofruesi i platformave të shpërndarjes së videove, shërbimi i platformave të shpërndarjes së videove e të tjera. Në thelb, të gjitha ndryshimet konsolidojnë garantimin e mëtejshëm të lirisë së shprehjes dhe të së drejtës së informimit.

Në këndvështrimin tim, aq rëndësi sa kanë ndryshimet koherente të ligjit “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, po me kaq vëmendje duhet parë edhe statusi dhe trajtimi i Këshillit Drejtues dhe i vetë institucionit të AMA-S, duke marrë në konsideratë peshën e përgjegjësisë në raport me vendimmarrjen ekskluzive në rregullimin e të gjithë veprimtarisë, qëllimit dhe funksionit të medie audiovizive, si dhe të ndjeshmërisë dhe varësisë që kanë institucionet dhe opinionin publik ndaj këtij sektori. Ndaj për këtë çështje kam propozuar edhe një amendament shtesë, që do ta paraqes gjatë diskutimit nen për nen të këtij projektligji.

E gjithë jeta dhe veprimtaria jonë është sot nën efektin e internetit dhe të hapësirës audiovizive. Ne çfarë jemi biologjikisht, e kemi në gen, por për atë çfarë bëjmë dhe si sillemi, ndikohemi nga politika dhe nga media.

Vlerat dhe efektet e këtij revolucioni digjital janë të jashtëzakonshme, por po kaq edhe dëmsjellëse.

Nga pamundësia e kontrollit të internetit dhe e platformave të shumta, që janë në qarkullim, në jo pak raste ne jemi viktimë të shpifjes, të dezinformimit dhe të marrjes peng prej manisë për të denigruar dhe për të përbaltur tjetrin.

Në kohët e hershme, autokratët kanë nxjerrë shprehjen “Fjala vret më shumë se shpata”, ndërsa sot interneti është një armë që të vret pa dalë fare nga shtëpia, pa harxhuar as naftë dhe as fishekë, por vetëm montazhe dhe fjalë.

Nga ky hall apo shqetësim nuk na shpëtojnë as oferta e legjislacioneve medietike, as kornizat e posaçme kufizuese dhe ndëshkuese, madje as gjykatat.

Ne, si deputetë, duhet të japim shembullin e një dialogu të kulturuar, të një gjuhe të zgjedhur dhe të zhveshur nga zhargoni intimidues e denigruar, si dhe duhet të luajmë rol kyç dhe emancipues për edukimin e publikut.

Të gjithë duhet të lëmë shenja të mirë në artikulum, jo njolla dhe gropa në raport me informimin dhe të vërtetën, nuk duhet të bëjmë garë kush duhet ta bëjë më pis njëri-tjetrin dhe kush shan e urren më shumë. Gjuha e urrejtjes çon në agresion dhe mbjell në shoqëri instinkte dhune.

Nga ana tjetër, shërbimet medietike priren nga komercializmi dhe rendin pas sensacionit dhe jo drejt të vërtetës. Ndërkohë, sensacioni dhe shpifja bëhen bashkë me anonimatin dhe ky i fundit i jep fuqi shpifjes.

Nuk është legjitime të përhapësh gënjeshtria dhe të pavërteta, që po vazhdojnë edhe në seancë, por kjo çështje nuk zgjidhet me arbitër. Duhet urtësi për të mos kaluar vijën e kuqe, pa dyshim duhet edhe një kornizë ligjore për shpifjen dhe dezinformimin.

Mendoj se rastet negative që qarkullojnë në fushën e informimit do të eliminojnë me mekanizmat e cilësisë së profesionalizmit të medie, me të kuptuarit e lirisë jo thjesht si e drejtë e pakufizuar për t’u shprehur, por edhe si një përgjegjësi dhe edukim, si dhe një angazhim i gazetarëve profesionistë për të qenë gardianë që ruajnë demokracinë me lajme relevante dhe me vërtetësi.

Në fluksin e pamatë të hapësirës digjitale dhe të medie audiovizive, ne si parlament duhet të vlerësojmë shërbimin publik të medias. Tani është bërë bashkëjetesë dhe pjesë e sistemit të kemi arsim privat, spitale private, të kemi medie private. Po shërbimi publik në ç’raport, sa konkurrues dhe bashkëkohor është?

Pa dyshim që mediet zotërohen dhe dominohen nga të pasurit, por a janë i varfri dhe publiku i thjeshtë pjesë e dialogut dhe e së drejtës për të qenë objekt dhe subjekt i informimit, a po

konsumon ofertën medietike të privatit, ndërkohë që mediet digjitale dhe portalet nuk regjistrohen dhe as paguajnë taksa? Këto janë sfidat që duhen rregulluar nga institucionet përkatëse për tregun medietik.

Në të gjitha parashtrimet që bëhen nga diskutimet për këtë projektligj, të gjithë konfirmojmë evoluimin dhe progresin në fushën e medieve audiovizive dhe qëndrimin se nuk duhet të jemi ankues, konstataues apo pasojavuajtës të gënjeshtërs dhe të shpifjes, por duhet të jemi kontribuues dhe reflektues për të bashkëjetuar me të vërtetën dhe me kohën digjitale.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Zonja Kryemadhi nuk është prezente.

Fjalën e ka zonja Lindita Metaliaj.

Të përgatitet zonja Albana Vokshi.

**Lindita Metaliaj** – Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Shteti, i bërë njësh me krimin, po i shkakton Shqipërisë një kosto të tmerrshme për të ardhmen. Brezat që do të vijnë nuk do t'juja falin kurrë atë që po i bëni vendit, duke i vrarë lirinë, shpresën, ëndrrat dhe të ardhmen.

Pushteti rilindas ka në gjenezë veprimet që paraardhësit e tyre politikë i bënë rreth 50 vjet më parë, duke sulmuar këdo që nuk është dhe nuk mendon si ata, duke i piketuar dhe shënjestruar të gjithë ata që u dalin përballë. Por ajo kohë nuk kthehet më. Demokratët e shembën para 32 vjetësh dhe do ta shembin, me po aq mllef, pushtetin tuaj dhunues më 14 maj.

Nuk i ndal demokratët tritoli i frikacakëve, që vepruan në terr për të ekzekutuar kryetarin e Partisë Demokratike të Vaut të Dejës, Bernard Ndrecën.

Ngjarja kriminale kaloi nga pushteti juaj si një gjë e zakonshme, në fakt, pa marrë aspak parasysh se Bernard Ndreca, përveçse demokrat, është bir i një nëne, është një bashkëshort, është një qytetar i kësaj Republike, të marrë peng nga ju dhe krimi që bashkëpunon me ju.

Nga kjo foltore, si deputete e parlamentit shqiptar, por, mbi të gjitha, si qytetare e këtij vendi, i bëj thirrje prokurorisë dhe Policisë së Shtetit të zbardhë ngjarjen kriminale dhe të vërë para drejtësisë përgjegjësit, porositësit dhe nxitësit e këtij akti terrorist. Ngjarje të tilla kriminale pa dyshim që marrin hov nga gjuha e Kryeministrit dhe e oborrtarëve të tij, të cilët nuk

kursejnë askënd dhe asgjë përballë revanshit që kanë për karrigen dhe pushtetin.

Vau i Dejës, Lezha dhe mbarë Shqipëria janë sot më të vendosur se kurrë më parë në fitoren e zgjedhjeve vendore dhe ky akt tregon qartë se pushteti i Ramës është në përpëlitjet e fundit dhe ka humbur tashmë çdo shpresë.

14 maji do të jetë dita e mbarë lezhjanëve dhe shqiptarëve për të shpëtuar nga kthetrat e qeverisjes lokale tërësisht të dështuar, do të jetë dita që të emëruarit në bashkitë e vendit, që nuk pyesin për ligjin, por rikonfirmohen nga Maliaqi, do të shkulen nga zyrat e shtetit përmes votës së qytetarëve!

Është e patolerueshme ligjërisht se si drejtuesi në ikje i Bashkisë së Lezhës, aktori i dosjes “184”, sfidon ligjet e shtetit në kohë fushate, sfidon KQZ-në dhe çdo institucion tjetër, madje ndërmerr edhe veprime në emër të institucioneve të tjera pa pyetur askënd. Nga ne, demokratët, e ka një përgjigje për paligjshmërinë e tij: të bëjë çfarë të dojë me ligjet e shtetit, të sfidojë KQZ-në apo çdo autoritet tjetër mbi të, le të mbushë gropa me zhavor, të mashtrrojë sa të dojë, pasi më 14 maj lezhjanët do t'i presin biletën pa kthim. Nuk u shitet lezhjanëve sapuni për djathë.

Ata që kanë pushtet absolut dhe bëjnë punë vetëm në javët e fundit të fushatës, e dinë mirë se çfarë i pret.

I tmerruar nga përballja me votën, i emëruari 6% i Ramës, që, në fakt, nuk u bë kurrë kryetar, po përdor çdo makinacion dhe makiazh për t'i shpëtuar ndëshkimit të lezhjanëve. Nën pritjen e humbjes, ka ndërmarrë në shkelje të ligjit punime të cilat nuk janë në kompetencën e tij, dhe këtë e ka bërë për fushatë dhe për efekt punimesh. Ai i di, apo nuk do t'ia dijë, janë problemet e tij, se cilat janë problemet realisht që administrojnë bashkia. Ndryshe, nuk justifikohet vendimi nr. 21/72 prot. datë 09.03.2023 i Autoritetit Rrugor Shqiptar, sipas të cilit (dhe ky është dokument i Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe nuk është bërë nga Partia Demokratike), nga inspektimi i specialistëve të ARRSH-së në kuadër të punimeve të kryera në kontratën e mirëmbajtjes loti 1 “Mirëmbajtje me performancë të akteve kryesore të rajonit verior”, u konstatua se: “Në segmentin rrugor kombëtar K/Shëngjin-Shëngjin po kryhen punime për realizimin e projektit të Bashkisë së Lezhës me objekt “Ndërtimi i trotuarit të ri në

lagjen Xhenio””. Ky është një akt, pjesë e inventarit të rritit rrugor kombëtar, që administrohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

“Në këto kushte, për sa më sipër, në zbatim të Kodit Rrugor”, - thotë ARRSH-ja, - “kërkojmë nga ana juaj ndërprerjen e menjëhershme të punimeve dhe dërgimin sa më parë në Autoritetin Rrugor Shqiptar të projektit të plotë që po zbatohet, i cili duhet të miratohet nga ana jonë”.

Siç e shikoni, punimet atje vazhdojnë ende, Bashkia e Lezhës po e përfundon trotuarin, edhe pse ka një vendim nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për ndërprerjen e punimeve.

Të dashur qytetarë, si mundet një kryebashkiak të veprojë në këtë mënyrë, të kryejë punime në vepra që nuk janë kompetencë e tij? Si mundet që ARRSH-ja të kujtohet aq vonë, në një kohë kur puna kishte filluar shumë më herët? Çfarë interesash u përplasën në mes dy palëve të së njëjtës shtëpi politike? Dhe secili qytetar këtu e nënkupton përgjigjen.

Si mundet që një kryetar bashkie, të cilin nuk e lidh asgjë me Lezhën, t’i lejojë vetes të ndërmarrë gjoja financime që vetëm sa e dëmtojnë rëndë sezonin turistik? Kaosi i trafikut dhe radhët kilometrike do ta shoqërojnë këtë sezon turistik në Shëngjin, pasi punimet janë tejet të zgjatura dhe përtej pikut të turizmit.

Kaq është shqetësimi juaj, të bëni çfarë të mundni vetëm e vetëm që t’i gënjeni banorët për vota. Ndaj unë u bëj thirrje prokurorisë së Lezhës dhe organeve të tjera ligjzbatuese të marrin të gjitha masat dhe të hetojnë skandalin me punimet që po kryhen në hyrje të rrugës Lezhë-Shëngjin. Abuzimet janë tërësisht të verifikueshme qoftë këto me analizën dhe përplasjen mes Bashkisë së Lezhës dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar.

Gjithashtu, kërkoj nga prokuroria që të hetohen edhe fasadat e tyre, po ashtu punimet, që kanë të bëjnë me asfaltet elektorale, që kryetari në ikje i Bashkisë së Lezhës, i pavotuari, po bën në të gjithë Bashkinë e Lezhës.

*(Deputetja Metaliaj tregon disa fotografi.)*

Kjo është foto e një rruge, e cila vetëm sa është ngjyer me asfalt dhe, siç e shikoni, kanë mbirë sallata jeshile në mes të “asfaltit elektoral” të kryetarit në ikje të Bashkisë së Lezhës. I vetmi investim i Bashkisë së Lezhës është ai në bujqësi, ku bimët, sallatat jeshile kanë mbirë kudo.

Kjo është një tjetër foto në lagjen Semete, në Ishull-Lezhë, dhe po një tjetër foto në Ishull-

Lezhë, por ku asfalti, siç shihet, nga i gjerë, vjen e ngushtohet, duke u shndërruar kështu edhe në burim aksidentesh.

Kjo është një tjetër vepër e punëmbuarit në Shën Koll, rruga ishte e gjerë, por asfalti elektoral e ka ngushtuar gjysmë për gjysmë rrugën aktuale. Pra, kjo është cilësia e punimeve dhe kështu shpërdorohen paratë e taksapaguesve, vetëm e vetëm që të mashtrojnë qytetarët dhe banorët e Lezhës për vota. Nuk ka asnjë tabelë informuese për rrugën as se sa është vlera e punimeve dhe as se kur fillojnë dhe kur mbarojnë punimet. Është e pajustificueshme se si veprohet në këtë mënyrë, se si keqpërdoren paratë e lezhjanëve. Kjo pa dyshim që nuk është zgjidhje për komunitetin, pasi këto janë rrugë që në shumë pak kohë do të rikthehen përsëri në gjendjen e mëparshme. I pavotuari në ikje duhet të hetohet, pasi të gjitha punët që ka bërë në këto kohë janë vetëm mashtrome elektorale. Pra, në një shtet ligjor, në një shtet të së drejtës, ku mbizotërojnë ligji dhe drejtësia, nuk duhet të lejohej që kryetari i një bashkie të bënte një kasaphanë të tillë.

Si mundet KQZ-ja të mbyllë sytë, ndërkohë që çdo gjë është e publikuar në rrjetet sociale dhe në media? Por pa dyshim, demokratët dhe lezhjanet as nuk e kanë në listë propagandën e tyre, as nuk e kanë në listë paligjshmërinë e tyre, pasi më 14 maj do t’i penalizojnë me votë dhe do t’u presin biletën pa kthim.

Edhe pse po tentohet t’i bëhet presion administratës publike, nga ana tjetër edhe subjekteve private po u kërkohet me detyrim që të plotësojnë disa formularë. Ky është një tip formulari që administratës publike dhe subjekteve private në Bashkinë e Lezhës po u kërkohet ta plotësojnë me 20 deri në 25 votues të Partisë Socialiste. Sado të përdorni mekanizma të tillë, sado të mendoni se po i intimidoni apo po i dhunoni banorët e Lezhës, ta harroni se mund ta bëni, pasi më 14 maj ata do t’ju ndëshkojnë me votë, nga i pari tek i fundit.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Fjala për zonjën Ermonela Felaj.

Të përgatitet zoti Taulant Balla.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, Kryetare!

Faleminderit edhe kolegëve që e gjetën më të vlefshme të ndjekin në sallë diskutimin e këtij projektligji që sjell disa ndryshime në ligjin për

mediet audiovizive, sesa të qëndronin në kafenenë e Kuvendit!

Të them të drejtën, Kryetare, unë e kam bërë këtë propozim edhe më përpara dhe realisht, nëse do të kem mbështetje dua ta avancoj. Seriozisht, mendoj që çështjen e diskutimeve të lira duhet ta sjellim si çështje të parë të rendit të ditës dhe jo si çështje të fundit të rendit të ditës, sepse kështu do të disiplinojmë edhe zellin e atyre që praninë në parlament e lidhin vetëm me fjalën për procedurë, njëkohësisht edhe të atyre që i japin të drejtë vetes të zhbëjnë agjendën e parlamentit, duke ulur vlerat e parlamentit dhe tonat si të zgjedhur, duke folur për ato që ata i konsiderojnë prioritare dhe jo çfarë është prioritare për Kuvendin e Shqipërisë.

Unë dua të sjell në vëmendjen e kolegëve se ligji për mediet është dekretuar më 15 mars të vitit 2013, atëherë kur Kryeministër ishte zoti Berisha, kur Kuvendin e drejtonte zonja Topalli dhe kur President ishte i ndjeri, Bujar Nishani. Pavarësisht se ka kaluar kohë dhe pavarësisht se çfarë mund të thuhet, ky ligj dhe ligje të tjera, por sidomos ky ligj, nuk duhej të futej në pjesën e konfrontimit të rëndomtë politik që ndodh këtu te ne. Konfrontimi politik për çështje që s'kanë fare lidhje me ligjin fillon në komisionet parlamentare dhe, fatkeqësisht, vazhdon edhe në parlamentin e Shqipërisë. Çfarë shkakton kjo gjë? Kjo shkakton shpërqendrim nga fokusi, duke i bërë njerëzit të mërziten, sepse çfarë dëgjojnë nuk ka lidhje me atë që thuhet se do të diskutohet. Natyrisht, edhe ne biem në grackën e llomotitjeve të zakonshme për ligjin, që nuk sjellin asnjë gjë dhe nuk e pasurojnë as debatin parlamentar dhe as debatin shoqëror. Për hir të së vërtetës, unë u mundova sot të ndjek me kujdes shumicën e diskutantëve pa i selektuar prej përkatësisë së partisë politike që kanë këtu në Kuvendin e Shqipërisë, por më vjen keq të them se nuk pati vëmendje në momente të veçanta diskutimi. Diskutimi për këtë ligj është shumë kompleks, po a jemi të sigurt ne që i kuptojmë të gjitha nocionet e këtij ligji? A jemi të sigurt ne se të gjithë deputetët këtu e dinë objektin e ligjit? Unë mendoj që jo, sepse kjo u shfaq hapur këtu.

Po, patjetër, Bujar, që kam të drejtë, sepse ti je një nga ata njerëz që lexon dhe besoj se dëshira e njerëzve që lexojnë është që gjërat që i vlerësojnë, që janë parimore, të drejta dhe që i

shërbejnë shoqërisë, ata t'i sjellin përmes kontributit të tyre edhe në ligjërbërje.

Do të them dy fjalë për ligjin, për ndryshimet që janë sjellë në ligjin për medien. U tha këtu dhe unë po e them në mënyrë të përmbledhur se në përmbajtjen e ligjit për mediet audiovizive synohet që të ndërfitet përmbajtja e dy direktivave recente, të afërta në kohë të Bashkimit Europian. Këto direktiva duke u transpozuar në ligj kërkojnë të përmirësojnë përmbajtjen e ligjit për medien. Në ç'mënyrë? Duke rritur detyrimet e atyre që bëjnë mediet audiovizive në Shqipëri, e atyre që ofrojnë shërbime nëpërmjet platformave që shpërndahen video. Këtu kemi parasysh të gjitha rrjetet sociale si Facebook-u, Twitter-i, TikTok-u dhe të tjera me radhë. Më hollësisht detyrimet u referohen rregullave që do të kenë të gjithë ofruesit medietikë në raport me programet që ata shfaqin në mediet audiovizive. Këto programe duhet të jenë të tilla që të mbrojnë fëmijët ose minimalisht të sigurojnë mbrojtjen e fëmijëve, sepse shpeshherë programet dëmtojnë fëmijët në shëndetin e tyre sa fizik aq edhe emocional dhe kjo e dyta ndeshet rëndomë. Unë jam e sigurt që nëse do të ishim jashtë kësaj sale dhe do të kishim diskutime të lira për këtë çështje, sigurisht që do të sillnim në vëmendje shumë programe apo emisione televizive me përmbajtjen e të cilave nuk jemi aspak dakord. Disa nga këto programe u thanë këtu edhe nga kolegët.

Nga ana tjetër, synohet të rritet aksesimi në informacion për personat me aftësi ndryshe. Deri këtu jemi shumë dakord dhe jemi shumë të qartë. Po kështu, synohet të rritet transparencja mbi të gjithë ata që janë pronarë të këtyre shërbimeve medietike. Ne shpeshherë nuk e dimë se kush qëndron pas këtyre shërbimeve. Këta njerëz duke mos qenë të njohur në publik i kanë dhënë vetës të drejtën të thonë çfarë të duan në emër të lirisë së shprehjes, por liria e shprehjes si çdo liri tjetër, kolegë, ka kufizimet e veta. Kjo liri nuk mund t'i cenohet njerëzit. Kjo liri nuk mund t'i bëjë njerëzit të ndihen keq për atë që nuk duhet të ndihen keq. Pikërisht, në mbrojtje të këtyre vlerave dhe parimeve të tjera të rëndësishme duhet ta kishim konsideruar po aq të rëndësishëm edhe pjesëmarrjen në këtë debat, edhe temat që mund të ngrinin për diskutim në këtë ligj.

Unë dëgjova kolegen Tabaku që tha: "Ne e pamë në Komisionin e Integritetit që ligji ishte transpozuar pjesërisht", por, në fakt, në raportin



që shoqëron ligjin e diskutuar në Komisionin e Integritimit nuk gjendet asnjë vërejtje se përse është transpozuar pjesërisht ligji dhe nuk është transpozuar plotësisht. Unë mendoj se qenia opozitarë apo qenia pozitarë nuk duhet të çojnë deri në pikën sa të themi: “Unë nuk bëj asgjë, sepse ligji është sjellë nga qeveria”. Mendoj se nuk duhet të ndodhë kështu, sepse edhe këto gjëra, që mund të duken minimaliste dhe që janë vendosur në ligj, janë të rëndësishme. Media dhe kushdo tjetër, nëse duhet të edukohet, nuk edukohet nëpërmjet fjalimeve tona, por edukohet përmes asaj që ne të gjithë bashkë biem dakord të vendosim në ligj.

E pra, ne ramë dakord në komisionet tona parlamentare (unë e kam ndjekur me vëmendje edhe në mbledhjen që u zhvillua në Komisionin e Mjeteve të Informimit Publik), që të fusim në ligj termin “seksizëm”. Besoj se kemi bërë gjënë më të mirë të mundshme, për faktin se ne gratë dhe vajzat të parat, me sa duket, mbartim paragjykimin lidhur me gjininë. Na duket sikur jemi mbrojtëset më të flakta, por në vetvete ne e mbartim, e shprehim dhe nganjëherë bëhemi edhe pengesa për të futur këta terma në ligj. Unë e vlerësoj futjen e përkufizimit “seksizëm” në ligj, sepse besoj fort se do të na duhet, në radhë të parë, ta kuptojmë drejt të gjitha shfaqet e tij dhe njëkohësisht të bëjmë të mundur që organet që kanë për detyrë të mbikëqyrin veprimtarinë e medieve audiovizive dhe të gjithë atyre që ofrojnë platforma që shpërndajnë video të bëjnë detyrën e tyre.

Këtu parlamenti ka diçka të rëndësishme për të bërë dhe nuk ka lidhje fare nëse je i majtë apo je i djathtë. Komisionet parlamentare nëpërmjet rolit mbikëqyrës së tyre le ta rrisin kërkesën e llogarisë, parlamenti vetë le ta rrisë kërkesën e llogarisë ndaj AMA-s, që kjo e fundit ta rrisë kërkesën e llogarisë ndaj gjithë këtyre ofruesve të shërbimeve audiovizive. Këtë duhet të bëjmë. Unë nuk e di, a ka ndonjë kolege deputete këtu që mendon se nuk është bërë asnjëherë objekt i një sulmi të padrejtë nga ana e medieve audiovizive? Po, ne të gjitha jemi bërë objekt sulmi. Dhe për çfarë jemi bërë objekt? Mos jemi bërë vallë objekt për inteligjencën tonë, për pikëpamjet tona, për qëndrimet tona?! Jo. Jemi bërë objekt për veshjen. Jemi bërë objekt për paraqitjen tonë. Ky është seksizmi. Seksizmi nuk ka brirë. A na ka lënduar kjo gjë? A na ka prekur? Po, na ka prekur, kolege.

Na ka prekur ne, ka prekur fëmijët tanë, familjarët tanë, të gjithë. Unë mora si shembull ne të parat, sepse ne nuk mund t'i fshihemi kësaj gjëje. Ne nuk mund të bëjmë sikur kjo gjë nuk na bën përshtypje dhe sikur nuk ka bërë përshtypje. Prandaj sot është koha, që disa deputetë në vend që të abstenojnë, kanë ende kohë deri në fund të kësaj dite të mendohen edhe një herë, me qëllim që t'i mbështesin ndryshimet në ligj.

Ashtu sikundër u premtua në Komisionin e Medies, le të vazhdojnë diskutimet për këtë ligj, por, ju lutem shumë, mos vendosni barriera duke thënë: “Kjo media është e këtij, ajo media është atij.” Unë nuk dua të bëj komente për një gjë që në mos është fakt, është perceptim. Në Shqipëri perceptohet qartësisht që këto media janë të majta apo ato media janë të djathta. Nuk dua të bëj komente për faktin sesi disa media dje shaheshin dhe sot lavdërohen. Nuk dua të bëj asnjë koment për medie që pushtetin medietik të tyre e kanë ngritur mbi bazën e pastrimit të parave, ku mbrapa tyre nuk qëndrojnë njerëz që kanë dëshirë të shprehin shpirtin artistik të tyre, që kanë dëshirë të formësojnë kulturë, por nganjëherë qëndrojnë njerëz që janë marrë me veprimtari kriminale. Kështu ishte Beketi. Është dënuar penalisht, kolegë. Dhe ju vini këtu dhe tundni vendimin e arbitrazhit. Po e dini se çfarë është arbitrazhi? Nuk janë gjykatës ndërkombëtarë, por janë persona privatë të zgjedhur si arbitër. Unë nuk e njoh marrëveshjen e Beketit, nuk e di se si e keni bërë, sepse e keni bërë ju në kohën që ka ardhur Beketi këtu. Çfarë janë këta arbitra? A janë vërtet të pavarur? Se duhet ta dini kolegë, nëse provohet që këta arbitra janë të varur, vendimet e tyre nuk zbatohen.

Por përtej kësaj, ju lutem kolegeve deputete të jenë në mbrojtje të ndryshimeve të bëra në këtë ligj, që edhe pse mund të duken të vogla, realisht janë një hap i madh për të shndërruar kulturën e komunikimit në këtë vend.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** - Fjala për zotin Taulant Balla.

**Taulant Balla** – Para pak minutash foltoja u bë pis, siç ka ndodhur shpeshherë prej vitit 1997, kur Sali Berisha është rikthyer në këtë sallë. E ka bërë pis dhe vazhdon ta bëjë pis më shumë prej 19 majit të vitit 2021, kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës e shpallën *non grata*. Më lejoni të ndaj me ju një konstatim që nuk është vetëm imi, por

është i shumë kolegëve të vjetër në këtë sallë, por besoj edhe i të gjithë opinionit publik. Sa herë që ndodh një ngjarje, i pari që del të bëjë denoncuesin, prokurorin, gjyqtarin, policin është Sali Berisha. E ka bërë këtë në të gjitha rastet, edhe më 12 shtator 1998, kur sapo kishte ndodhur një ngjarje e rëndë doli dhe ngriti akuza, ku asokohe fajësonte Kryeministrin e Partisë Socialiste të asaj kohe, Fatos Nanon. Ndërkohë, faktet treguan se ajo ishte një histori komplet tjetër, ku vetë ky person që bën akuzuesin ishte një ndër personat e lidhur, që e nxori mikun e tij, bashkëpunëtorin e tij në pritë.

Unë nuk dua t'i hyj asaj historie, por e përgëzoj ministrin e Brendshëm që nuk dha një përgjigje për ngjarjen e ndodhur, sepse mendoj se përgjigjen duhet ta japin institucionet, nuk duhet ta japin politikanët. Ka ndodhur një ngjarje në Vaun e Dejës dhe ajo duhet hetuar, duhet zbardhur, por politika nuk bën policin, politika nuk bën prokurorin.

Ka një nen në Kodin Penal, i cili thotë se moskallëzimi i krimit dënohet, apo jo, zonja Çupi? Zotëria tha se ka emra, kështu që e sfidoj Sali Berishën të shkojë dhe t'i çojë në prokurori këta emra, por të mos harroj se kallëzimi i rremë dënohet. Thojani ju që erdhët t'i mbanit këngën sot, me ne krye Flamurin! Shkoni dhe bëni kallëzim, nëse keni prova ose ndryshe mbyllni gojën dhe prisni, se mund të ketë gjëra që nuk dihen! Dakord?

Thënë të gjitha këto, më lejoni të kaloj tek ajo për të cilën jemi mbledhur sot, që ka të bëjë me disa ndryshime në ligjin për mediet, ndryshime të mirëpritura, të kaluara dhe diskutuara në të gjitha komisionet. Ajo që për mua vlen dhe që duhet ndarë në këtë diskutim, është domosdoshmëria e kësaj nisme në lidhje me fëmijët, të cilët jetojnë në një botë virtuale të rrezikshme, ku kalojnë më shumë kohë se para disa vitesh. Sipas disa raporteve të fundit ndërkombëtare, fëmijët e moshës 8 deri në 18 vjeç tani kalojnë mesatarisht 9 orë në ditë në mediet apo në rrjetet sociale pas shkollës. Pikërisht, për këtë qëllim ne duhet të bëjmë gjithçka, që të sigurohemi se fëmijët tanë mbrohen nga përmbajtjet që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor apo moral të tyre. Kjo nismë është pikërisht synimi për të krijuar një mekanizëm vetërregullimi dhe edukimi medietik, nga ana e të gjithë ofruesve të platformave të shpërndarjes së

videove për të mbrojtur grupimet më vulnerable të shoqërisë.

E kam thënë edhe gjatë diskutimit në Komisionin për Çështjet Europiane në Kuvendin e Shqipërisë dhe nuk i heq as një pikë, as një presje, që diskutimi për një prej platformave të rrjeteve sociale, siç është TikTok-u duhet bërë sot më shumë se kurrë, pa u vonuar. Unë e mbështes qasjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës përkundrejt këtij rrjeti social, për ato dyshime që janë ngritur nga Kongresi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nga Senati, nga administrata aktuale dhe ajo pararendëse Republikane, se ne duhet të mbrojmë të gjitha pajisjet në pronësi të qeverisë, të parlamentit dhe të institucioneve të tjera shtetërore. Pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, institucionet e Bashkimit Europian, Këshilli dhe Komisioni, Franca, Holanda, Norvegjia, Belgjika, Danimarka dhe, në mos gaboj, dje apo pardje, edhe Australia, kanë shprehur shqetësime në lidhje me keqpërdorimin e dhënave personale të qytetarëve nga kjo platformë ose ky rrjet social. Mendoj se edhe ne jemi në kohën e duhur.

Meqenëse kam edhe pak minuta në dispozicion, dua të them se sfida jonë e përbashkët është që ta rregullojmë sa më shumë këtë pjesë pa prekur lirinë e medias. Natyrshëm e vërteta është që Partia Socialiste ka bërë dhe vazhdon të bëjë një sërë rregullimesh, për të cilat besoj se kemi edhe mirëkuptimin tuaj, sepse këto janë çështje që janë adresuar edhe gjatë procesit *screening* me Komisionin Europian.

Sa herë që dëgjoj diskutimet tuaja, një gjë më vjen si konfirmim i një nevojë më fort se çdo herë tjetër, se çdo ditë tjetër, që udhëtimi ynë i përbashkët me shqiptarët është Europa dhe se me ekipin tonë, me Partinë Socialiste, ne mund të vazhdojmë të ecim përpara. Është shumë e rëndë që sot alternativë ose udhëheqës të opozitës të kesh Sali Berishën dhe Ilir Metën. Madje, më e rëndë akoma bëhet situata për demokratët ose për një pjesë të demokratëve, të cilët kur të shkojnë të votojnë, do të shikojnë në fletën e votimit një treshe musketierësh të paimagjinueshme. Opozita drejtohet nga Nard Ndoka, Vangjel Dule dhe Ilir Meta. Kandidatët e partisë së foltores mbështeten nga Nard Ndoka, Vangjel Dule dhe Ilir Meta. Fat i madh, shyqyr që ju kemi dhe kështu ju pafshim gjithmonë!

Ne do të vazhdojmë të ecim përpara, sepse, shyqyr Zotit, shqiptarët e dinë që ju jeni e shkuara, ju jeni Sali dhe Ilir, dy emra që kanë marrë nga Shqipëria këto 32 vjet gjithçka kanë pasur mundësi. Sali Berisha ka qenë dy herë President, dy herë Kryeministër dhe gjithë kohën kryetar i opozitës, kurse Ilir Meta ka qenë dy herë Kryeministër, Kryetar parlamenti, President, zëvendëskryeministër dhe ministër i Jashtëm. Gjithçka ka qenë Ilir Meta, por se do të vinte dita që Sali Berisha të fshihej nën poturet e Ilir Metës, fund më tragjik nuk ka.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

Ne do të vazhdojmë përpara, kurse ju vazhdoni t'u rri nga mbrapa Saliut dhe Ilirit!

**Lindita Nikolla** – Po, zonja Ulliri.

**Andia Ulliri** - Faleminderit, zonja Kryetare!

Si anëtare e Komisionit të Medies do të doja të kisha pasur emrin në listën e folësve, por duke qenë se nuk pata mundësi ta marr fjalën, po kërkoj të paktën tri minuta për të folur për këtë projektligj.

Parafolësit tim do të doja t'i thosha që foltorja, të cilën ne e përmendim shumë herë, nuk duhet përdorur për fushatë elektorale, sepse nuk mendoj se është vendi i duhur. Duke qenë se po diskutojmë për ligjin e medies, mendoj se të paktën duhet të flasim për të drejtat themelore të njeriut dhe se si ato duhen respektuar.

Si respektohen sot e drejta e informimit, liritë dhe të drejtat e njeriut kur edhe në këtë sallë asgjë nuk shkon siç duhet, kur edhe kjo foltore përdoret për fushatë elektorale, për të abuzuar dhe për të linçuar një gjuhë urrejtoje ndaj çdo deputeti të kësaj salle? Në fakt, ka ardhur momenti që të flasësh në këtë sallë është bërë e kotë pasi nuk ka ndërgjegjësim të kësaj qeverie për të ndërmarrë masa të vërteta dhe reale.

Ligji për të cilin ne po flasim sot nuk duhet të kishte kaluar në mënyrë të përsheptuar, por duhet të ishte diskutuar thellësisht në të gjitha komisionet përkatëse për t'u përafuar 100% me direktivat e BE-së dhe të mos ishte i paplotë.

Ne e dimë çfarë ka ndodhur muajt e fundit, jemi në dijeni të sulmeve që janë bërë ndaj gazetarëve, ndaj medieve të shumta, ndonjëherë edhe me pasoja humbje jete. Këto janë kambana alarmi, ndaj të gjithë ne duhet të jemi përballë përgjegjësisë për të kontribuar me diskutime konstruktive për të arritur më të mirën në ligjin tonë, për sigurinë dhe garantimin e të drejtave të

njeriut dhe për të mos pasur më probleme të tilla. Megjithatë, nuk mendoj se diçka të tillë do të ndodhë, sepse qeveria e mendon këtë sallë si një platformë ku mund t'i caktojë çdo deputeti kur të flasë, si të flasë, si të qëndrojë, sa të flasë dhe kur të mos thotë asgjë ndaj qeverisë, e cila në të vërtetë nuk e ka bërë detyrën e saj, nuk po arrin dot të ecë përpara, sepse i ka akoma sytë tek e kaluara e errët që e mban peng Shqipërinë.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** - Këtu mbyllet diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë në pikën tjetër, diskutimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW-së e Fondit Shqiptar të Zhvillimit për projektin “Zhvillimi i Integruar Rajonal””.

Fillojmë me diskutimet.

Fjalën e ka zonja Hatixhe Konomi. Të përgatitet zoti Vullnet Sinaj.

**Hatixhe Konomi** – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Shqipëria dhe Gjermania kanë një bashkëpunim ekonomik të gjatë dhe të frytshëm, që ka ardhur duke u rritur dhe forcuar në vite. Që nga fillimi i këtij bashkëpunimi qeveria gjermane, nëpërmjet Bankës Gjermane për Zhvillim KfW, një ndër institucionet gjermane më aktive në Shqipëri, ka financuar rreth 1,2 miliardë euro për vendin tonë, duke e bërë Shqipërinë një ndër vendet më të rëndësishme të bashkëpunimit në Europën Juglindore.

Sektorët kryesorë ku janë përqendruar këto projekte zhvillimore janë energjia dhe klima, ujësjellës-kanalizimet, mbështetja për sipërmarrjet e vogla e të mesme, qeverisja e mirë, zhvillimi i qëndrueshëm urban, zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, trajnime, punësime e të tjera. Unë do të ndalem pak më specifikisht te mbështetja që ka dhënë qeveria gjermane për përmirësimin e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në Shqipëri.

Gjermania është aktualisht donatori më i madh në këto fusha, duke financuar nëpërmjet KfW-së një sërë projektesh të suksesshme në vend. Berati është një ndër bashkitë përfutuese nga financimet e KfW-së në sektorët e sipërpërmendur. Projekti i sistemit të ujësjellës-kanalizimeve në rajonin nr.1, një prej

lagjeve me të populluara të Beratit, me një vlerë prej 10 milionë eurosh dhe përfitues mbi 20 mijë banorë, është një ndër projektet më serioze dhe më me ndikim në komunitet. Falë këtij projekti, jo vetëm kjo lagje, por i gjithë qyteti i Beratit sot furnizohet me ujë 24 orë në ditë.

Gjithashtu, së shpejti do të fillojë një tjetër projekt i rëndësishëm i mbështetur po nga KfW-ja, ai i sistemimit të ujërave të zeza në të gjithë territorin e Bashkisë së Beratit, i cili parashikon ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza në vlerën 12, 7 milionë euro. Me përfundimin e këtij projekti mund të themi fare mirë se Berati do të ketë një infrastrukturë të denjë jo vetëm për qytetarët e vet, por edhe për të gjithë vizitorët e turistët, numri i të cilëve sa vjen e rritet.

I citova këto investime në Bashkinë e Beratit për të theksuar edhe një herë se bashkëpunimi i KfW-së me qeverinë shqiptare ka sjellë rezultate konkrete dhe projekte cilësore, të cilat e kanë përmirësuar ndjeshëm jetën e komuniteteve përfituese të këtyre investimeve.

Edhe projektligji i sotëm vjen në kuadër të këtij bashkëpunimi. Ky projektligj synon ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe KfW-së gjermane e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, e cila është agjencia e zbatimit të projektit “Zhvillimi i Integruar Rajonal”, me qëllim akordimin e vlerës së financimit prej 21 milionë eurosh.

Programi “Zhvillimi i Integruar Rajonal” është pjesë e strategjive afatgjata të qeverisë shqiptare për të gjallëruar ekonominë vendore dhe jetën komunitare nëpërmjet një vëmendjeje të shtuar ndaj zhvillimit urban dhe turizmit.

Ky projekt financohet nga Banka Gjermane për Zhvillim, KfW nëpërmjet marrëveshjes së huas në vlerën 21 milionë euro, ku 20 milionë euro do të jenë kredi dhe 1 milion euro do të jenë grant për projektin “Zhvillimi i Integruar Rajonal”.

Zonat në të cilat do të implementohet ky projekt janë bashkitë Pogradec, Pustec dhe Himarë. Këto bashki do t’u nënshtrohen një transformimi domethënës urban, sepse ky projekt synon përmirësimin e integruar të infrastrukturës urbane, ku përfshihen përmirësimi i infrastrukturës në sitet turistike dhe përmirësimi i infrastrukturës publike, si: furnizimi me ujë, sistemimi i ujërave të zeza, rrugët hyrëse, rehabilitimet ujore, përmirësimi i fasadave,

rikualifikimi urban i shesheve publike, shëtitoreve, parkingjeve, ndriçimit, duke përmirësuar kështu ndjeshëm jetën e banorëve të këtyre bashkive, por edhe duke i kthyer ato në pole të vërteta turistike.

Projekti do të fillojë menjëherë zbatimin e tij pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes përkatëse të huas dhe të grantit dhe ka afat përfundimi datën 30.7.2028.

Pa dashur të zgjatem në detaje, sepse jam e sigurt që ju e keni diskutuar dhe keni marrë informacion të thelluar në mbledhjet e komisioneve, dua të ritheksoj edhe një herë se ky projektligj ka ardhur në mbështetje të nenit 81, pika 1, dhe nenit 100 të Kushtetutës, si dhe nenit 17 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Ne në Komisionin për Politikën e Jashtme e mbështetëm unanimisht këtë projektligj, prandaj, kolegë të nderuar, ju ftoj ta mbështesni edhe ju duke e votuar pro, për t’i dhënë dritë jeshile zbatimit të projektit “Zhvillimi i Integruar Rajonal” në bashkitë Pogradec, Pustec dhe Himarë.

Faleminderit!

*(Drejtimin e seancës e merr nënkryetarja e Kuvendit, zonja Ermonela Felaj.)*

**Ermonela Felaj** - Faleminderit, zonja Konomi!

Fjalën e ka zoti Leskaj!

**Bujar Leskaj** – Në fakt, problemi te ky projektligj nuk qëndron te ndihma e ofruar nga një institucion prestigjioz, i cili e ka ndihmuar prej kohësh ekonominë shqiptare, siç është Banka Gjermane me kapital shtetëror, KfW-ja, as te forma e kredisë, e cila është e butë, por problemin ne e kemi brenda vetes me njësinë zbatuese të tij, që është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit, i themeluar 30 vjet më parë, në vitin 1993, me mbështetjen e Bankës Botërore, në pjesën më të madhe të kohës së tij është përpjekur dhe i ka realizuar ata objektiva që kishte. Misioni i atëhershëm i këtij projekti modest ishte lehtësimi i varfërisë veçanërisht në zonat rurale të vendit.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit u mbijetoi edhe trazirave të vitit 1997. Për afër dy dekada ky institucion fitoi mbështetjen e institucioneve të fuqishme financiare ndërkombëtare, tenderoi miliona euro për ndërtimin e rrugëve të reja, furnizoi me ujë zona rurale, mbështeti zhvillime

rajonale, kontribuoi në projekte rajonale dhe komunitare për një qeverisje më të mirë e të tjera. Gradualisht ai u shndërrua në pikën fokale të donatorëve, agjencive dhe bankave ndërkombëtare të zhvillimit.

Në vitin 2017, me mbështetjen e donatorëve buxheti i Fondit arriti mbi 100 milionë euro, mirëpo në vitin 2018 tri agjenci u shkrinë dhe u bënë pjesë strukturore e Fondit. Kjo strukturë tashmë e pa veten në pozicionin monopol në investimet rajonale e qarkuar nga struktura të dobëta monitorimi dhe llogari-kërkuese të shtetit.

Në vitin 2020 Fondi Shqiptar i Zhvillimit arriti rekordin e shumëzës së prokuruar me rreth 40 miliardë lekë ose 350 milionë euro, ku më shumë se gjysma i përkiste fondit të rindërtimit të objekteve që u shkatërruan nga tërmeti. Mungesa e programit të transparencës së këtij institucioni solli përshpejtimin e keqmenaxhimit të tij.

Programi i transparencës u miratua në shtator të vitit 2014 dhe, natyrisht, të gjitha autoritetet publike janë përpjekur dhe përpiqen të përfshihen në këtë program. Edhe pse sot numri ka arritur në qindra dhe ka mangësi, për fat të keq, Fondi Shqiptar i Zhvillimit qëndron ende jashtë këtij programi.

Në 4-5 vjetët e fundit Fondi Shqiptar i Zhvillimit i është larguar misionit të tij, duke përfaqësuar institucionin publik më të keqmenaxhuar në vend, duke vepruar larg parimeve dhe rregullave të qeverisjes së mirë publike të vendosura nga OECD-ja. Kjo strukturë, me tenderët problematikë që përgatit dhe me kontratat që realizon, është në nëpërkëmbje dhe injorim të interesit publik, për t'u shërbyer sa më mirë interesave dhe urdhrave të sektorit "Rama" në qeverisje.

Specifikë e tenderëve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit vitet e fundit është fryrja e qëllimshme e vlerës së projekteve të tij, për t'i fituar me vlera 20 – 30 për qind poshtë fondit limit, gjoja për kursim të parasë publike, por, në të vërtetë, sikurse do ta shpjegoj më poshtë, e gjitha kjo bëhet në shkelje të ligjit "Për prokurimin publik".

Fondi në këto vite ka uzurpuar plotësisht të gjitha kompetencat e qeverisjes vendore dhe ka lënë tokë të djegur për nismat e bashkive në drejtim të investimeve kapitale të rajoneve të tyre. Çka është më e keqja, gati për të gjitha projektet që tenderon, në kundërshtim me frymën e misionit të tij për të sjellë zhvillimin ekonomik dhe social

aty ku investon, Fondi përcakton kompani fituese ato kompani që nuk janë në rajonin ku zhvillon projektin. Për shembull, në rajonin e Vlorës asnjë nga investimet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit në këto vite nuk është kryer nga kompani vendore, por nga firma me vendndodhje në Tiranë. Po kështu ka ndodhur edhe në rajone të tjera të Shqipërisë. Le të dalë ndonjë nga deputetët e mazhorancës dhe ta kundërshtojë këtë që unë po them.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është kthyer në një agjenci që keqmenaxhon paratë publike. Janë të shumta tenderët dhe kontratat e përfituara dhe të zbatuara nga Fondi kur, në kundërshtim të hapur me ligjin e prokurimeve publike dhe rregulla të tjera në fuqi fituese, nuk shpallen kompani që ofrojnë vlerën më të ulët ekonomike për cilësi të barabartë oferte, por kompani të favorizuara nga drejtuesit e Fondit, drejtuesit e pushtetit vendor, të dirigjuara nga drejtuesi i sektorit.

Në vetëm 7 tenderë të zhvilluara gjatë vitit 2022 për ndërhyrje për përmirësimin e strukturave rrugore në disa rajone të vendit me vlerë totale mbi 22 milionë euro, Fondi Shqiptar i Zhvillimit i ka shkaktuar një humbje disa milionë euro buxhetit të shtetit nga përzgjedhja klienteliste e firmave fituese me oferta dukshëm më të larta se kompanitë e tjera në garë.

Shembulli më i qartë i keqpërdorimit nga Fondi të parave të taksapaguesve shqiptarë edhe në rastin e granteve, të parave të taksapaguesve të vendeve anëtare të BE-së, në kundërshtim flagrant me "E"-të e famshme, efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet, vjen nga Vlora. Investimet e Fondit në të tria sheshet kryesore në Vlorë, Sheshin e Flamurit, të Skelës dhe përpara bashkisë, kapin shifrën mbi 14 milionë euro për punë pjesa e madhe e të cilës është kryer 5 ose 10 vjet më parë, sepse pjesa tjetër janë vetëm rifinitura. Madje, tashmë Sheshi i Flamurit është shpërfytyruar dhe denaturuar në vlerat e tij si simbol kombëtar. Për këtë gjë kam folur edhe në seanca të tjera.

Shpenzimet joesenciale për rifinitura në qendra qytetesh, shpenzime luksi për fasada apo menu digjitale të projektit të 100 fshatrave turistike përbëjnë raste tipike të keqmenaxhimit të parasë publike nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Madje, për këtë të fundit dje më tërhoqi vëmendjen një postim i shkurtër i një gazetari

kurajoz dhe ekspert i ekonomisë, Klodian Tomorrit, i cili në shkrimin e tij thekson: “Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hapur tender me vlerë 5 milionë dollarë për të promovuar 100 fshatra. Objekti i tenderit është kontraktimi i sazeve me gërnëtë, foni dhe bokse. Sot kishte hapur një tender tjetër në vlerë 800 mijë dollarë për të kontraktuar një privat që të regjistrojë në hipotekë tokat e 100 fshatrave. Pra, regjistrimin e tokave nuk e bën as bashkia dhe as kadastra, por do ta bëjë një kompani private, e cila do të marrë 800 mijë dollarë”. Ky fakt që flet vetë dhe nuk ka nevojë për koment.

Gjithashtu, për t’u trajtuar sot është edhe politika e pagave të stafit të Fondit, e cila ka shkaktuar natyrshëm revoltë në nëpunësit e tjerë të administratës publike.

Mjafton të kujtoj këtu që një shofer i Fondit (personalisht kam respekt për të gjithë punonjësit dhe shoferët) paguhet sa dyfishi i mësuesve apo policëve. Drejtori i Fondit paguhet 7 mijë dollarë ose sa trefishi i Presidentit të Republikës apo Kryeministrit.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është një agjenci që shkel rëndë ligjin e prokurimeve publike. Këtu del edhe një tjetër fakt flagrant. Projekti “Eden” i korrikut 2022 për vendosjen e një instilacioni druri në oborrin e Kryeministrisë nuk është parashikuar më parë në planet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, është bërë pa fondin përkatës dhe u zhvillua me procedurë prokurimi të kufizuar pa pasur asnjë emergjencë. Për çudi, e fitoi ajo kompani që zhvilloi punime të padeklaruar në godinën e Kryeministrisë kur ju erdhët në pushtet në vitin 2013. Pra, për një tekë të personit që drejton Fondin Shqiptar të Zhvillimit, të sektit në qeverisje, shqiptarët duhet të paguajnë 3,7 milionë euro për kopsht me tre kate druri dhe pemë të varura. Fondi e shkeli ligjin për prokurimet duke hapur një prokurim që nuk e kishte në programin vjetor të investimeve.

Më tej, në këto kohë të vështira, në gusht 2022, Fondi vazhdoi me një projekt tjetër “të madh”, ekstravant, për të investuar në infrastrukturën ndihmëse të një piste ndërkombëtare garash të makinave të shpejta sportive në Shqipëri. Gjithashtu, Fondi organizoi tenderin për ndërtimin e infrastrukturës mbështetëse për kompleksin “Auto Moto Park” në Elbasan dhe hapi dy tendera, një me vlerë 4,7 milionë euro për rrugët lidhëse dhe tjetrin me

vlerë 6,4 milionë euro për argjinaturat mbrojtëse të lumit Shkumbin. Janë 11,1 milionë euro të taksapaguesve shqiptarë. 6,4 milionë eurot që do të shpenzohen për argjinaturat Fondi mund t’i investonte shumë mirë në argjinatura mbrojtëse në zonat e banimit, në tokat bujqësore në rrezik dhe në ato pozicione ku lumenjtë shkaktojnë përmbytje në qytete si Elbasani Vlora e të tjera.

Prokurimet skandaloze jashtë misionit fillestar të Fondit Shqiptar të Zhvillimit vazhdojnë. Për fat të keq, në relacion ju keni thënë që ky projektligj ka lidhje me Agjendën 2013 të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm, por abuzimi me paratë publike nuk ka asnjë lidhje me Agjendën 2013 të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe 17 objektivat e saj.

Nga ana tjetër, Fondi Shqiptar i Zhvillimit i fryn qëllimisht vlerat e projekteve të tij në mënyrë që t’i fitojnë ato kompani që realizojnë uljen 20% apo 30%, kurse kompani që ofrojnë vlera të tjera më të ulëta përjashtohen me pretekstin e ofertës anomalisht më të ulët. Këtu ka një kontradiktë.

Të gjitha arsyet që unë përmenda më sipër dhe shumë të tjera më shtynjë mua ta votoj kundër projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së huas, i bindur që, megjithëse me kushte të favorshme, duke falënderuar edhe donatorin, qeverinë gjermane dhe Bankën Gjermane për Zhvillim KfW, nga drejtuesit e Fondit do të abuzohet me këto para.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** - Faleminderit, zoti Leskaj!  
Zoti Balla, keni kërkuar fjalën?

**Taulant Balla** – Po flas nga vendi.

Së pari, shpreh shumë mirënjohje për qeverinë gjermane, e cila përmes KfW-së arrin të sigurojë një pjesë të rëndësishme të investimeve për infrastrukturën jetike në Shqipëri. Nuk gjen një bashki në Shqipëri që të mos jetë përfituese e projekteve të KfW-së për furnizimin me ujë të pijshëm, për trajtimin e ujërave të zeza apo për projekte të rëndësishme të infrastrukturës së transportimit të energjisë elektrike. Gjithashtu, po vlerësojmë faktin që në 3 vjetët e fundit Gjermania mbetet donatori kryesor i zhvillimit dhe i transformimit të vendit në shumë fusha të rëndësishme. Janë plot 1,2 miliardë euro të investuara drejtpërsëdrejti nga qeveria gjermane, kryesisht përmes KfW-së. I gjej të padrejta dhe të pavërteta të gjitha ato keqinformime dhe akuza që

u hodhën kundrejt Fondit Shqiptar të Zhvillimit. E vërteta është tërësisht ndryshe: Fondi Shqiptar i Zhvillimit është një prej institucioneve më transparente për sa u përket procedurave të tij të prokurimit publik. Ka vendosur një standard ndër më të mirët prej vitesh dhe kjo është arsyeja që një pjesë e madhe e asistencës financiare të huaj kanalizohet përmes Fondit, pra Fondi ka arritur të krijojë besueshmërinë si një partner i rëndësishëm. Projekte shumë të rëndësishme, që transformuan Vlorën për ta kthyer atë në një prej porteve kryesore, por më shumë se kaq, në një prej destinacioneve më të rëndësishme të turizmit shqiptar, janë zhvilluar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Meqenëse këtu u përmend automotoparku në Elbasan, apo paratë që po hidhen kot nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit aty, së pari, më lejoni të them se koncepti i automotoparkut nuk është koncepti i një hapësire për gara me mjete. Koncepti i automotoparkut është koncepti i krijimit të një destinacioni për qytetarët shqiptarë, jo vetëm për banorët e Elbasanit, por nga Tirana deri në Veri të Shqipërisë, nga Fieri, Lushnja deri në Jug të Shqipërisë të shkojnë në Elbasan. Është një koncept që ka rezultuar shumë i mirë në shumë vende të tjera; një koncept që ka rezultuar shumë i mirë në Hungari para pak vjetësh; një koncept që ka rezultuar shumë i mirë në Bullgari para pak vjetësh, ku në një pozicion të caktuar gjeografik në mes të vendit ndërtohet një hapësirë e tillë, e cila do të sigurojë disa qindra vende pune për Elbasanin, por do ta shndërrojë Elbasanin në një destinacion. Pra, duhet të kesh një arsye të shkosh atje dhe një prej arsyeve është edhe ky investim. Nuk është e vërtetë që po ndërtohet në Elbasan një pritë lumore në një zonë të pabanuar, sepse në gjithë atë hapësirë, ku po ndërtohet prita lumore, pra në zonën e Krastës, jetojnë me mijëra banorë, dhe e vërteta është se gjithmonë lumi Shkumbin ka qenë një problematikë në atë zonë, duke përfshirë këtu edhe përrenj të tjerë. Investimi i qeverisë jo vetëm siguron më shumë tokë, e cila për shkak të erozionit po rrezikonte të merrej vit pas viti nga lumi Shkumbin, por ky investim kaq i rëndësishëm i qeverisë shqiptare përmes Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe përmes projekteve që zhvillon vetë Bashkia e Elbasanit aty (duhet të kuptojmë se është një projekt shumë i madh), do të sigurojë që edhe Shqipëria të hyjë në hartën e atij që quhet turizmi i garave me automjete, sepse

është e vërtetë që është një turizëm, i cili në vendet ku është aplikuar, ka siguruar më shumë të ardhura. Prandaj, dua t'u bëj thirrje kolegëve: nëse flisni me fakte, faktet në këto raste, kur thoni se shkelen parimet e barazisë në tenderë apo shkelen procedurat e prokurimeve publike, janë vepra penale dhe, si vepra penale, detyrë e gjithkujt që disponon një informacion për një vepër penale, është ta kallëzojë atë në institucionet përkatëse. E vërteta është, dhe duhet ta themi, se falë Fondit Shqiptar të Zhvillimit po ndërhyhet në çdo cep të territorit pa asnjë dallim. Mund të them këtu që projektet, të cilat po zhvillon Fondi Shqiptar i Zhvillimit në Shkodër, janë projekte të mëdha, që po e transformojnë dhe vazhdojnë ta transformojnë kryeqendrën e Veriut, sikurse është Shkodra. Ne deputetët kemi detyrën dhe nderin të përfaqësojmë komunitetet tona në sallë, kështu që mendoj se për të gjithë atë punë të mirë që ka bërë Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe vazhdon të bëjë, meriton një falënderim. Natyrisht, gjermanët nuk gabojnë që këto fonde ia besojnë këtij institucioni, sikurse është Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Kështu që, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, ne do ta votojmë këtë marrëveshje tepër të rëndësishme.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Balla!

Sqaroj kolegët që zoti Balla e ka emrin e regjistruar te diskutantët.

Zoti Tritan Shehu, keni fjalën.

Të përgatitet zoti Vullnet Sinaj.

**Tritan Shehu** – Faleminderit, zonja drejtuese!

Kolegë deputetë,

Së pari, dua të sqaroj diçka, sepse ju gjithmonë kërkonte të ngatëroni dy koncepte: konceptin e borxhit të huas e të kreditit me konceptin e grantit. Këto para që kërkohen të merren, nuk janë grant, por janë borxh, janë hua, që do t'i paguajnë qytetarët shqiptarë në një hapësirë kohore. Pra, janë një rëndesë mbi xhepat, mbi të ardhurat, mbi mundësitë financiare të buxhetit të Shqipërisë. Unë nuk jam kundër huave dhe as borxheve, sepse edhe ato përdoren për zhvillimin e një vendi, por baza e zhvillimit të një vendi nuk mund të jenë borxhet, nuk mund të jenë huat, por zhvillimi ekonomik i vetë vendit është prodhimi, janë të ardhurat buxhetore, të cilat krijohen nga zhvillimi i vendit. Ju këtu i ngatëroni konceptet me një qëllim, sepse, duke pasur një ekonomi në degradim, në rënie të thellë,

ju kërkoni të mbushni buxhetin me dy mënyra: me rritjen e taksave, duke rënduar mbi qytetarët, nga ana tjetër, duke tentuar të merrni sa më shumë hua gjithandej. Pavarësisht nga kushtet e saj, huaja është hua dhe do të paguhet nga qytetarët shqiptarë. Ju realisht kërkoni ta mbushni momentalisht buxhetin, thesin pa menduar për perspektivën, pa menduar për efektin afatgjatë, pa menduar sa rëndon kjo barrë financiare mbi qytetarët në tërësi gjatë zhvillimit.

Së pari, një shtet zhvillohet duke zhvilluar ekonominë, duke zhvilluar të ardhurat e saj, duke zhvilluar prodhimin, duke shtuar investimet në vendin përkatës. Te ne po ndodh e kundërta, ju kërkoni të krijoni një buxhet të bazuar mbi huat. Realisht këto para që merren, askush nuk e di si përdoren; sa është rentabiliteti i tyre; sa është efikasiteti i tyre; si është përqindja e asaj që shkon për projektin dhe përqindja e atyre që shkojnë për korrupsionin në xhepat e të tjerëve. Ju prej kohësh, që në vitin 2017, keni deklaruar se në Shqipëri do të kishte 100% uji. Sot merrni shuma gjigante, kredi në euro, për uji dhe thoni do të arrijmë në 40%-50% të furnizimit, kur keni marrë shumë të tjera (e njëjta gjë edhe kjo). Pra, nuk kontrollohen si shkojnë dhe si avullojnë këto para që merren. Pra, kemi edhe këtë elementin tjetër: ju vetëm që zhvillimi i ekonomik i një vendi nuk bazohet në hua, por këtu kemi devijime të mëdha fondesh, të cilat përfshihen në korrupsion. Ku po shkojmë kështu? Po shkojmë në një vend që po varfërohet, megjithëse borxhi është rritur në mënyrë galopante, ka arritur shifra të paimagjinueshme, jashtë asaj që lejon Kushtetuta e vendit; të ardhurat e qytetarëve po bien; ekonomia është në krizë dhe prodhimi ka rënë. Shikojeni në tërësi! Shikoni qarqet! Shikoni qarkun e Gjirokastrës: një bujqësi e shkatërruar, një blegtori, e cila ka rënë në 40% të kapacitetit të saj, një papunësi e thellë dhe vetëm braktisje. 45% e njerëzve kanë ikur në vitet e fundit duke krijuar një shkretëtirë. Pse kanë ikur? Sepse kushtet ekonomike janë të tilla që nuk mund të jetohej. Pa dyshim, njerëzit kërkojnë që të jetojnë më mirë, prandaj largohen. Ku është rentabiliteti i të gjitha këtyre huave që keni marrë ju, që e kanë rritur në këtë mënyrë borxhin tonë?! Nuk ekziston. Përkundrazi, nuk ka dhënë asnjë efekt pozitiv. Pse? Sepse bazoheni në mënyrën e gabuar, bazoheni vetëm te momenti i gërryer nga korrupsioni. Këtu jemi?! Pse në Shqipëri nuk ka

investime të mëdha të huaja prej gati 8 vjetësh?! Realisht nuk ka politika të vërteta atraktive për investimet, por ka vetëm një mundësi të marrjes së kësaj huaje vetëm për të kaluar momentin, sepse në Shqipëri ka një nivel shumë të lartë korrupsioni; ka një sistem drejtësie të degraduar; ka një administratë të paafte dhe të politizuar që pengon investimet e huaja në tërësi, aq më shumë tani që deklarohet nga Kryeministri se do të dalë edhe nga Gjykata e Arbitrazhit. Kjo është “*colpo di grazia*” e ekonomisë. Kjo do të thotë se investitori, i cili nuk gjen zgjidhje në drejtësinë shqiptare, as në administratë, sepse është korrumpuar, nuk ka të drejtë të drejtohet në nivelet e arbitrazhit ndërkombëtar. Ai çfarë do të bëjë? Nuk do të vijë në Shqipëri; nuk do të ketë investime dhe ekonomia do të bjerë më tej. Pse ndodh kjo gjë?! Sepse ju edhe ndaj investitorëve të huaj silleni në mënyrë arrogante, klienteliste, me koncepte e pikëpamje politike dhe kërkoni t’i përzini ata, sepse nga investitorë seriozë të mëdhenj nuk merrni dot para nën dorë. Nuk janë mësuar me atë mentalitet dhe psikologji ata, nuk e pranojnë atë gjë. Atëherë, kërkoni t’i përzini ata. Shikoni investimet tuaja në infrastrukturë, cila kompani i merr?! Sa kanë marrë kompanitë e huaja dhe serioze? Sa nga ata tenderë të famshëm kanë fituar? Nuk kanë fituar. Pse? Sepse ata nuk paguajnë 30% të vlerës për atë që jep tenderin, sepse këtu kështu janë rregullat e lojës dhe ju deklaroni që do të largoheni nga arbitrazhi.

Së pari, nuk e bëni dot atë gjë, sepse izoloheni dhe ktheni në kohën e izolimit, por edhe fjala që thoni, i tremb dhe i frikëson, i largon investitorët realë nga Shqipëria.

Nga ana tjetër, gjobat shtohen, janë qindra miliona euro gjobat që do t’i paguajmë si pasojë e arbitraritetit tuaj, e arrogancës suaj, e mosrespektimit të ligjeve dhe e mosrespektimit të marrëveshjeve. Nuk ka gjë më të keqe për një vend sesa të mos respektojë marrëveshjet. Kjo do të thotë humbje totale e besimit; do të thotë që askush të mos vijë më; do të thotë që të ngelesh i izoluar; do të thotë që të ngelesh fatkeq në izolimin tënd dhe të rrënohesh çdo ditë e më tepër ekonomikisht, të jesh gjithmonë e më shumë i varfër. Kjo është e vërteta.

Prandaj, të nderuar kolegë, le t’i harrojmë huat, le të mendojmë për zhvillimin ekonomik, le të mendojmë për investimet, le të mendojmë për tërheqjen e investitorëve, duke respektuar



rregullat dhe marrëveshjet, duke krijuar një ambient të favorshëm për të investuar, sa më larg korrupsionit, duke mos futur duart në gjykata, duke i lejuar ata të bëjnë punën e tyre në bazë të ligjit, pa dyshim, duke pranuar rregullat ndërkombëtare, ligjet ndërkombëtare dhe institucionet ndërkombëtare, sepse sot zhvillimi është i gjerë; zhvillimi kërkon partneritet dhe partneritet do të thotë të respektosh institucionet dhe rregullat ndërkombëtare, përndryshe do të ktheheshim në një ishull të izoluar, në një sulltanat, me një sulltan në krye të tij, ashtu siç janë shumë vende të tjera të Lindjes që po degradojnë gjithmonë e më tepër ekonomikisht, sepse nuk dinë të integrohen në institucionalizimin europian, i cili është bazë e garancive edhe për investitorët e huaj, të cilët fatkeqësisht ne kërkojmë t'i trembim me gogolët tanë, duke thënë që do të dalim, nga ana tjetër paguajmë gjoba gjigante nga xhepi i qytetarëve.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit zoti Shehu! Fjalën e ka zoti Vullnet Sinaj.

Të përgatitet zoti Dashnor Sula, i cili do të jetë i fundit për këtë diskutim, natyrisht edhe kolegët që janë regjistruar për diskutimin tjetër.

**Vullnet Sinaj** – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Me afrimin e 14 majit, datës së zgjedhjeve të pushtetit vendor, duket sikur vëmendja e politikës zhvendoset më pak te puna institucionale dhe fokusohet më shumë te fushata elektorale, por, pavarësisht rëndësisë së zgjedhjeve, nga ku do të dalin kryetarët e 61 bashkive të vendit, institucionet shtetërore kanë dëshmuar dhe po dëshmojnë se janë të fokusuara me seriozitet te puna në dobi të qytetarëve. Duke e parë në këtë këndvështrim, më duhet t'i përgëzoj kolegët deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, të cilët, me gjithë angazhimet në terren, marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe diskutojnë me seriozitet për iniciativat ligjvënëse. Fatkeqësisht nuk mund të them të njëjtën gjë për disa nga kolegët e opozitës, të cilët Kuvendin e Shqipërisë e trajtojnë si institucion *ad hoc* dhe e ndiejnë veten të punësuar *part time*.

Në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave shqyrtuam dhe miratuam

projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Frankfurt am Main (KfW) e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSZH), agjencia e zbatimit të projektit, për projektin “Zhvillimi i integruar rajonal”. Përmes kësaj marrëveshjeje synohet akordomi i shumë në vlerën 20 milionë euro hua dhe 1 milion euro grant për këtë projekt, i cili synon t'i zhvillojë më tej disa zona turistike dhe rurale të Shqipërisë. Projekti “Zhvillimi i integruar rajonal”, i iniciuar nga qeveria shqiptare, ka si qëllim kryesor të kontribuojë në rritjen ekonomike të Shqipërisë, si dhe për gjenerimin e punësimit dhe të të ardhurave. Ky program pritet të zgjasë 5 vjet dhe parashikon ndërhyrje infrastrukturore në funksion të nxitjes dhe zhvillimit ekonomik të zonave turistike. Programi në tërësi parashikon ndërhyrje në tri bashki kryesore: në Pogradec, në Pustec dhe Himarë, ku fokusi specifik është në zonën e Lukovës. Këto 3 bashki janë përzgjedhur në bazë të potencialit të lartë turistik, por edhe të problematikave përkatëse që kanë nevojë për zgjidhje.

Si deputet i qarkut të Vlorës, unë kam qenë dhe jam në komunikim të vazhdueshëm me banorët e Bashkisë së Himarës. Para pak ditësh isha pikërisht në Lukovë, ku me kënaqësi konstatova se mjaft nga kërkesat e banorëve në fushat, që prek edhe ky program i qeverisë, janë në rrugën e zgjidhjes. Megjithatë, ka nevojë për vëmendje dhe investime. Me gëzim konstatoj së projekti “Për integrimin e zhvilluar rajonal” fokusohet te nevojat e komunitetit. Konkretisht, ky projekt parashikon të sjellë rritjen e numrit të turistëve, rrjedhimisht rritjen e të ardhurave për sipërmarrësit dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Meqenëse në këtë projektligj përmenden Bashkia e Himarës, sidomos Lukova, si deputet i asaj zone gjej rastin t'u drejtohem kolegëve të opozitës, do t'i drejtohesha Sali Berishës në radhë të parë, nëse do të ishte këtui: si ka mundësi që të mbështesë në Himarë një kandidat, të cilin ai vetë e ka akuzuar për ngjarjet në postën kufitare të Peshkëpisë në Gjirokastër? Si ka mundësi që të mbështesë një kandidat, i cili para se të dalë në fushatë në Himarë duhet të japë llogari para zgjedhësve të tij pse ka qenë i dënuar në Greqi për armëmbajtje pa leje, për çfarë i duhej armëmbajtja atij? Duhet të japë llogari para zgjedhësve pse

është dënuar në Shqipëri ky njeri për përdhosje të simboleve kombëtare? Më vjen shumë keq për ju, si opozitë, që mbështesni një kandidat si puna e Fredi Bejlerit. Për këtë unë jam shumë i indinjuar dhe shumë i preokupuar. Edhe atij dua t'i drejtohem që të ketë kujdes kur përmend Progonatin, sepse Progonati është shqiptar dhe progonatasit janë labë.

Po kthehem te projektligji.

Të nderuar kolegë,

Projekti ka 3 komponentë kryesorë.

Komponenti i parë është përmirësimi i infrastrukturës dhe përmirësimi urban. Ai fokusohet në rrugët hyrëse, te furnizimi me ujë, sistemimi i kanalizimeve të ujërave të zeza, te rehabilitimi i bregdetit, përmirësimi i fasadave, si dhe rikualifikimi urban i shesheve publike dhe i shëtitoreve.

Komponenti i dytë është përmirësimi i infrastrukturës turistike, siç është lehtësimi i aksesit në rrugë dhe shtigje, ruajtja e këtyre shtigjeve në gjendjen natyrore, si dhe shërbime, si: parkingjet apo ndriçimi.

Komponenti i tretë janë masat shoqëruese. Ato nënkuptojnë planin e menaxhimit dhe mirëmbajtjen, rritje kapacitetesh për pushtetin vendor, kurse trajnimi, evente, panairë apo produkte të tjera turistike.

Programi për zhvillimin e integruar rajonal konsiderohet pjesë e dokumentit Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe 17 objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 2015.

Programi për zhvillimin e integruar rajonal është pjesë e strategjive afatgjata të qeverisë shqiptare për të gjallëruar ekonominë vendore dhe jetën komunitare përmes një vëmendjeje të shtuar ndaj zhvillimit urban dhe turizmit. Ky program do të zhvillohet në dy faza. Marrëveshja që ftohemi të miratojmë sot, i përket fazës së parë.

Projekti do të fillojë zbatimin e tij menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje përkatëse të huas e të grantit dhe ka afat përfundimtar datën 30 korrik 2028. Objekti final është gjenerimi i vendeve të reja të punës dhe krijimi i të ardhurave, ndaj duhet të ketë interes të shtuar për ta miratuar atë.

Duke vlerësuar rëndësinë e këtij projektligji, i cili do të ketë ndikim në ekonominë vendore dhe jetën komunitare ndërmjet një vëmendjeje të

shtuar ndaj zhvillimit urban dhe turizmit, të nderuar kolegë, ju ftoj ta miratojmë bashkërisht këtë projektligji!

Faleminderit!

**Ermonela Fela**j – Faleminderit, zoti Sinaj!

Zoti Sula, fjala është për ju. Këtu mbyllem diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës.

**Dashnor Sula** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Sigurisht, ne, si opozitë, nuk jemi kundër investimeve, të cilat do të kanalizohen në sektorët e bujqësisë apo ekonomisë në tërësi, por duhet të keni parasysh që këto 20 milionë euro, të cilat ne i marrim borxh, vazhdojnë të jenë në kuadër të borxhit që kjo mazhorancë vijon të marrë. Shuma deri tani, më 13 prill të këtij viti, në muajin e katërt, është 200 milionë euro, por po të shtojmë edhe vitin e kaluar 500 milionë euro, borxhi shkon 700 milionë euro të marra për një vit e 4 muaj.

Unë e dëgjova edhe parafolësin dhe është e rëndësishme që të investohet në zonat rurale, sidomos në fshatra, të cilat ne mendojmë se kanë nevoja jashtëzakonisht imediate, por unë do të mundohem t'i them gjërat me prova, me fakte dhe me letra përpara.

Zotërinj të mazhorancës, shikoni këtu!

*(Zoti Sula paraqet foto.)*

Kjo është një rrugë që lidh rrugën nacionale Rogozhinë – Elbasan me Bashkinë e Belshit. Në këtë rrugë, e cila ka 7 vjet që është prishur, është një gropë e hapur, e cila është kthyer në vend plehrash dhe shumë e rrezikshme për të gjithë fëmijët që kalojnë aty, si dhe për banorët e Belshit, Pekishtit, Rrasës, Trashit, Shezës, Karthnekës, Grykshit, Pajovës, Grykshit të Vogël e të tjerë. Të mos mbyllësh një gropë për 7 vjet dhe të mos investosh 30 milionë lekë të vjetër, të mos bësh 1 javë punë, çfarë të themi më ne?! Këtë problem e kemi ngritur një herë, dy herë; kam shkuar në vend dhe më është thënë se do të bëhet sot, do të bëhet nesër, por nuk e bëni. Pse nuk e bëni?! Sepse nuk doni dhe i orientoni paratë në vende të tjera.

Vazhdojmë më tej, përsëri për jetën në fshat, meqenëse ju dhimbset fshati kur diskutoni, siç diskutuat sot për taksën e hirrës.

*(Zoti Sula paraqet foto.)*

Urdhëroni, kjo familje këtu është në fshatin Trash të komunës Shezë. Këtu, në këtë kasolle, jeton kjo familje, sepse shtëpia i është dëmtuar nga tërmeti, së cilës i kanë dhënë vetëm 1,2

milionë lekë të vjetër. Ky është viti i katërt, nëse nuk gabohem, por përsëri nuk i kanë marrë lekët. Në një takim që bëra në atë fshat, ka disa shtëpi, të cilat do të t'juja tregoj me foto.

*(Zoti Sula paraqet foto.)*

Shikoni, a mund të jetohej këtu?! Ky është realiteti. Po flas për fshatra, të cilat janë buzë rrugës automobilistike, sepse po të flasim për fshatrat e malësisë së Peqinit, malësisë së Elbasanit apo të Librazhdit, pastaj, o nënë, o nënë... Urdhëroni, shikoni!

*(Zoti Sula paraqet foto.)*

Këto janë shtëpitë e shembura nga tërmeti; duhet të marrin ndihmë, por nuk kanë përfituar asgjë.

Vazhdojmë më tej. Ne kemi pasur takime në shumë fshatra gjatë këtyre ditëve dhe fshati më i largët i Bashkisë së Peqinit, në kufi me Tiranën, është Cacabeja dhe është për të ardhur keq. Unë po ju deklaroj publikisht që atje maksimumi për 2-3 vjet nuk do të ketë më banorë, qoftë në Cacabej, qoftë në Garunjë të Cacabejës. Kur kemi shkuar në atë fshat për t'i takuar njerëzit para dy vjetësh, situata ishte pak më ndryshe, por sot ishte e trishtueshme të shihje që në të gjithë fshatin Cacabej, i cili ka 400-450 votues, të ishte vetëm ky fëmijë...

*(Zoti Sula tregon foto.)*

I ati e çon atë çdo ditë në shkollën 9-vjecare në Garunjë, 4 kilometra vajtje, 4 ardhje çdo ditë. Në dy fshatra, ku ka pasur 2500 banorë, sot janë shumë pak dhe në 9 klasa janë vetëm 7 nxënës: në klasën e parë janë vetëm 3 nxënës, Eseda, Klarisa dhe Marsida; në klasën e dytë është vetëm një nxënëse, Emineja; në klasën e tretë është vetëm një nxënëse, Naida; në klasën e pestë janë dy nxënës, Andrea dhe Eraldi; në klasën e gjashtë janë dy nxënëse, Klea dhe Amelia, ndërsa në klasën e nëntë është vetëm një nxënëse, Alkida. A e kuptoni që e gjithë ajo shkollë 9-vjeçare ka vetëm 7 nxënës?! A e kuptoni në çfarë gjendje jemi, miqtë e mi?! Po ju them dhe po ju paralajmëroj që fshatrat e zonave të Peqinit, të Gramshit, të Elbasanit dhe të Librazhdit janë në një situatë jashtëzakonisht të vështirë.

Në fshatrat Sinametaj, Drangaj, Kazije, Galush, Hasnjok, Haspiraj, Cacabej dhe Garunjë, të cilat unë i ndjek me shumë vëmendje, deri në vitin 2015, kur ekzistonin komunat, kishte çdo ditë lëvizje, sepse shkohej edhe me makinë të vogël në rrugët që u bënë në ato vite, por,

fatkeqësisht, në momentin që u shkatërruan komunat, të cilave ua bëtë grumbullimin në bashki, ku bashkitë janë mbifryrë me punonjës, të cilët nuk punojnë fare aty, pasi janë militantë, nuk ka më fonde për të pastruar një kanal të rrugës. Rrugët në këto fshatra janë të shkatërruara dhe nuk shkohet më atje. Dilni dhe shikoni! Le të shkojë t'u bëjë një vizitë këtyre fshatrave një ministër, një anëtar qeverie apo kushdo, qoftë edhe të shohë situatën atje, e cila është jashtëzakonisht e vështirë.

I bëj thirrje mazhorancës t'i kthejë sytë nga fshati, sepse fshati është në periudhën më të vështirë të ekzistencës së tij. Çdo takim në fshat sot nuk shtyhet më. Ju më 23 dhjetor të vitit 2022, kur u bënë rialokimet e fondeve të buxhetit, të cilat kishin tepruar nga viti 2022, ju dhatë për bujqësinë, për fshatin dhe fermerët 1,7 milionë euro, në një kohë kur në janar të vitit 2022 futët në fuqi TVSH-në për plehrat dhe pesticidet që përdorin fermerët, ndërkohë që Kosova dhe vendet e rajonit nuk e kanë. Ju e dini fare mirë që në vitin 2013, kur ne u larguam nga pushteti, e kemi lënë me 35 mijë lekë kuintalin e dapit, uresë dhe nitratit, ndërsa sot është 140-150 mijë lekë. Këto janë të vërtetat. Të gjithë indikatorët dhe raportet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, të Bankës Botërore dhe EUROSTAT-it deklarojnë se në Shqipëri ka negativitet. Nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dje u publikua një raport që Shqipëria deri në vitin 2028 do të jetë përsëri një vend i varfër dhe lëmë poshtë në rankim vetëm Kosovën, me të ardhura për frymë 6100 dollarë, në një kohë që të gjitha vendet e rajonit, sidomos në ato të Europës Lindore ka pasur rritje pozitive.

Miqtë e mi, bujqësia, të cilën vazhdojmë ta diskriminojmë, gjeneron 20% të vendeve të punës dhe jep 20% të GDP-së, ju i ktheni bujqësisë vetëm 0,7% nga buxheti i shtetit. Fshatarët, të cilët shkojmë t'i takojmë, ankohen, sepse ju keni gjetur mekanizma, të cilët thonë se do t'ia paguani fshatarit, ndërkohë nuk ia paguani. Pse?

Nëpër fshatra të gjithë fshatarët kanë lopë, të shkretët, por ju thonë se duhet të kenë 10 lopë, sepse, po të kesh 9 lopë, nuk merr subvencion; ju thonë se duhet të kesh 100 dele apo 100 kokë krerë dhi, sepse, po të kesh 99 dele apo dhi nuk merr subvencion; duhet të kesh 50 koshere bletësh, sepse, po pate 49, nuk merr subvencion.

Për sa i përket raportit të fundit që nxori Banka Botërore lidhur me ndihmën për periudhën

e pandemisë dhe periudhën e agresionit rus, jemi përsëri vendi i fundit në rajon, kemi vetëm Malin e Zi mbrapa, me 0,1%, ndërkohë që Kosova, vendi më i varfër, 4,7% të prodhimit të brendshëm bruto e ka dhënë për qytetarët e saj. Ndërkohë që ju në total, duke përfshirë edhe subvencionin 1,3% për energjinë, të cilin ju e trumbetuat me të madhe, vutë 1,9% të prodhimit të brendshëm bruto në dispozicion të shtresave në nevojë dhe të shoqërisë shqiptare për të përballuar krizat. Këto janë shifrat, 1,9% e ka Banka Botërore, dhe nuk i them unë, nuk i thotë opozita, sepse, po t'i thoshte opozita, ju do të thoshte: "Ju shpifni dhe nxini gjithçka", por raportet e Bankës Botërore, të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të organizmave të Bashkimit Europian janë raporte serioze, të mirëstudiuara, me shifra konkrete, të sakta dhe nuk ka shanse që të jenë ndryshe. Kjo është e vërteta. Nëse më jepni një raport ndërkombëtar të një organizmi ndërkombëtar, i cili e vlerëson pozitivisht Shqipërinë, atëherë po...

E kam thënë edhe herë të tjera këtu, dhe po e përsëris, ndoshta mund të jem i vetmi politikan që e them: po të mos ishin paratë e trafikut të drogës dhe të korrupsionit, ekonomia e këtij vendi nuk do të ekzistonte.

Keni dhënë leje për ndërtim 6 milionë metra katrorë, ku nga 10 kompani 6 prej tyre nuk i kanë mjetet e ligjshme për të financuar. A ka logjikë ekonomike që të ndërtohet një pallat dhe investitori të mos marrë asnjë lek kredi? Ku i gjejnë paratë që ndërtojnë, si i ndërtojnë?

**Ermonela Felaj** – Ju lutem, përfundoni, zoti Sula!

**Dashnor Sula** – Do ta përfundoj, edhe pak, ju lutem!

Faleminderit!

Ky realitet tregon se jemi në ditën më të keqe!

Së fundi, nuk jemi kundër rritjes së pagave, por na ka dalë gjuha, llapa, duke thënë: "Rriteni ndër vite", por nuk e bëtë, pra të ishte një program 4-vjeçar dhe të rritej vit pas viti. Pse e thatë një javë para fushatës elektorale që do të rrisni rrogat?! Ju mund ta thoshit edhe pas datës 14 maj dhe do të ishit edhe më të besueshëm, por kjo është thjesht propagandë. Megjithatë, unë ju them se mund të thoni çfarë të doni, shpifni dhe mashtroni sa të doni, por është e garantuar që 14 maji do të jetë një moment reflektimi për të gjithë qytetarët shqiptarë. Nëse ju deri sot, në datën 13

prill, nuk i keni futur duart në zgjedhje, nuk keni intimiduar administratën dhe nuk keni vënë akoma në funksion paratë dhe të fortët, sigurisht që vota e qytetarëve në çdo bashki, nga Kopluku në Konispol, do të jetë një votë e lirë dhe ju do të ndëshkoheni me votë popullore.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Sula!

Këtu mbyllen diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë në diskutimin e projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për ndërtimin e urës ndërkufitare mbi lumin Buna/Bojana".

Referuar nenit 73, pika 2 e Rregullores, normalisht duhet të kishte pyetje, por meqenëse nismëtarja e këtij projekti, zëvendëskryeministria, është duke ardhur, do t'u lutem kolegëve ta kalojmë momentin e pyetjeve.

Fjalën ia kaloj zotit Koçi, si diskutanti i parë i listës.

**Petro Koçi** – Faleminderit, zonja Felaj!

Së pari, dua të falënderoj organizatën, e cila në hyrje të Kuvendit na vendosi këto stema, si demonstrim i një dite simbol për solidaritetin për komunitetin autik, i cili meriton, pa dyshim, përkujdesje, vëmendje dhe standarde trajtimi gjithnjë e më të larta.

Së dyti, më erdhi keq që, pa dashur, zëdhënës të opozitës i thurën lavde trafikut të drogës për merita të pazëvendësueshme, sipas tyre, në zhvillimin ekonomik të vendit. Ky është një autogol, besoj, jo i qëllimtë, por gjithsesi shkon më shumë drejt vlerësimit pozitiv për ata që merren me trafikun e rrezikshëm të drogës.

Po kaloj te rendi i ditës. Sot po diskutojmë, besoj dhe do të miratojmë, një marrëveshje historike midis qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për ngritjen e urës mbi lumin Buna. Më në fund ka ardhur koha që në këtë rajon të ngrihen ura dhe jo më mure. Kjo është, natyrisht, meritë e një vizioni të ri që ka filluar të sundojë në rajon, ku, pa dyshim, qeveria shqiptare ka një rol dhe protagonizëm të padiskutueshëm. Është koha e "Ballkanit të hapur" dhe jo e Ballkanit të mbyllur. Nga "Ballkani i hapur" nuk përfitojnë qeveritë, por përfitojnë të gjitha vendet tona dhe, pa dyshim, përfituesit e parë janë shqiptarët, sepse Shqipëria, siç e dinë të gjithë, e dinë jo vetëm shqiptarët, por

edhe të tjerët, është e rrethuar nga komunitete shqiptarësh, sepse rrethohet me Kosovën, me Maqedoninë e Veriut dhe me Malin e Zi, pra vende, rajone kufitare, ku banojnë kryesisht shqiptarë.

Ne në Komisionin e Jashtëm e diskutuam me shumë përkushtim këtë projekt marrëveshje dhe dua t'i falënderoj të gjithë kolegët e mazhorancës që e votuan këtë marrëveshje, por më vjen keq që opozita, natyrisht nuk arriti deri aty sa të votonte kundër, por abstenoj, pra as pro, as kundër. Imagjinoni, është një projekt që 1,5 orë udhëtim e kthen në 5 minuta; 73 kilometra i kthen vetëm në 300 metra dhe, pa dyshim, ata që kanë lidhje me ekonominë e makinës, e kuptojnë që 10 litra karburant do të kthehen vetëm në 10 mililitra. Pra, është një përfitim në praktikë i jashtëzakonshëm, sigurisht, në radhë të parë për komunitetet e qytetarëve të Shkodrës dhe të Ulqinit dhe, pa dyshim, për të gjitha subjektet që merren me turizëm. 360 mijë turistë të Velipojës tashmë do të kenë mundësinë që shumë shpejt të mund të kalojnë në Ulqin, ashtu siç 170 mijë turistë në Ulqin të mund të shfrytëzojnë hapësirën turistike shqiptare të Velipojës apo edhe më tej. Pa dyshim që shfrytëzimi turistik i 34 kilometrave plazh do të arrijë maksimumin e vet me ndërtimin e kësaj ure. Natyrisht, dua të shpreh mirënjohjen e veçantë për të dy kryeministrat, Edi Ramën dhe Abazoviçin e Malit të Zi, për arritjen e kësaj marrëveshjeje, që thashë se i shërben zhvillimit të të gjithë ekonomisë ndërkufitare, por sidomos të turizmit ndërkufitar mes Shkodrës dhe Ulqinit dhe, pa dyshim, të gjithë atyre që janë të interesuar për shfrytëzimin e të gjithë pjesës turistike të dy hapësirave në Shkodër dhe në Ulqin, që vijnë jo vetëm nga Shqipëria dhe Mali i Zi, por edhe nga vende të tjera. Ky është një zhvillim model, që duhet ndjekur edhe nga vendet e tjera, për të krijuar edhe mundësi të tjera bashkëpunimi të Shqipërisë me vendet kufitare. Gjithsesi, ngritja e kësaj ure besoj se është një moment historik.

Kishte një interes në lidhje me lartësinë e urës, sepse bëhet fjalë që lumi Buna, historikisht i lundrueshëm, të shfrytëzohet si i tillë, pse jo edhe për të ngritur industrinë e ndërtimit të mjeteve lundruese apo të jahteve që shfrytëzojnë hapësirën liqenore, por edhe vetë lumin. Unë besoj se lartësia e urës 10,3 metra mbi sipërfaqen e ujit është krejtësisht e mjaftueshme që të gjitha pikëpyetjet dhe interesat përkatëse të marrin një

përgjigje adekuate, të përshtatshme teknike, që nuk pengon, por, përkundrazi, nxit edhe lundrueshmërinë e lumit Buna, patjetër edhe të gjithë operatorëve të mundshëm të së ardhmes, që mund të përdorin mjete të tilla jo vetëm për kalimin nga liqeni drejt detit, por edhe për të zhvilluar mole në hapësirat përkatëse, qoftë në brigjet liqenore të Shqipërisë, por edhe në atë të Malit të Zi, në mënyrë që edhe turizmi në hapësirën liqenore dhe në bregliqenin përkatës të marrë energjinë përkatëse, pse jo të arrijë maksimumin.

Kështu që, ta gëzojnë Shqipëria dhe Mali i Zi urën e re! Ta gëzojnë Shkodra dhe Ulqini urën mbi Bunë, ose urën Bajana!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Koçi!

Fjalën e ka zonja Koliqi.

**Emilja Koliqi** - Të nderuar qytetarë,

Marrëveshja për ndërtimin e urës ndërkufitare mbi lumin Buna, që po shqyrtohet sot, ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj të Malit të Zi, nuk është një gjë e re, por është përfolur prej disa vitesh, dhe në qershor të vitit të kaluar, me një pamje ure 3D, na u prezantua si një sukses pas forumit për Ballkanin e Hapur në Ohër.

Këtu, në këtë foltore, maxhoranca premtoi se financimi do të fillonte me rialokimet e buxhetit të vitit 2022 dhe me projektbuxhetin 2023 – 2025. Na u bë një pyetje ne, deputetëve të opozitës, në veçanti ne shkodorëve: a do ta votoni buxhetin nëse kjo urë do të jetë në buxhetin e vitit 2023? Turp, nëse nuk e votoni! Por premtimi u harrua dhe nuk u parashikua as te rialokimet, as në buxhetin 2023-2025. Tani, që u afruan zgjedhjet lokale, u kujtuan edhe një herë për urën Velipojë –Ulqin!

Në nenin 5 të marrëveshjes thuhet se hartimi i projektit është përgatitur me burimet financiare të FSHZH-së. A ka një projekt të plotë, apo është vetëm një dizajn me pamje 3D, që qarkullon në rrjetet sociale? Për këtë pyetje përfaqësuesit e FSHZH-së thanë se projekti ishte prokuruar, dhanë edhe vlerën e projektit, dhe theksuan se është i publikuar në faqen ueb të FSHZH-së, por asnjëherë nuk u përmend fjala projektues, vetëm konsulent. Edhe Kryeministri ka thënë se Shqipëria ka paguar për idenë e projektit.

Unë kërkova në faqen e FSHZH-së dhe në atë të APP-së, por nuk pashë askund gjurmë prokurimi dhe projektit. Nuk mora asnjë përgjigje

se me cilat fonde do të zbatohet ky projekt. Megjithëse kostoja e vlerësuar nga 20 milionë, tani ka shkuar në 26 milionë euro, Kryeministri është shprehur që këtë projekt mund ta paguajë edhe administrata vendore dhe jo buxheti i shtetit. Pra, nuk ka asnjë fond të parashikuar për këtë urë. Pse do të hapet llogari e veçantë bankare në qoftë se do të financohet me fondet e buxhetit? Kush e monitoron?

Deri sot nuk është zhvilluar asnjë dëgjese publike me pushtetin vendor dhe nuk merret vesh nëse projekti është në përputhje me planin e përgjithshëm vendor. Sipas vlerësimit strategjik mjedisor unë dua të di: sa do të ndikojë në përmbytjet e zonës? Në komision përfaqësuesit e FSHZH-së thanë se ka një vlerësim të ndikimit në mjedis, por Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit në Malin e Zi, në një intervistë të disa ditëve më parë për radion “Europa e lirë”, theksoi se për ndërtimin e urës është e nevojshme që të përgatitet një raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Në planin e përgjithshëm vendor zona ku do të ndërtohet cilësohet si njësi strukturore me karakter natyror. Ndërhyrjet duhet të ruajnë kushtet aktuale të mjedisit dhe lejohen vetëm nëse janë në shërbim të ruajtjes dhe mirëmbajtjes së kushteve aktuale. Ndërhyrjet duhet të jenë me karakter mjedisor, si dhe të garantojnë përmirësimin e natyrës dhe sigurinë e specieve në zonë.

Ditët e fundit aktivistë nga Ulqini për mbrojtjen e mjedisit janë shprehur se pala shqiptare e ka injoruar përfshirjen e një zone të njohur ndërkombëtarisht. Të vjen pak keq që pala malazeze nuk e ka marrë parasysh ndikimin negativ në vlerat natyrore të kësaj zone vërtet unike. E gjithë zona e lumit Buna, së bashku me Deltën dhe ishullin e Franc Jozefit, rezervatin e Velipojës është e shpallur peizazh ujor/tokësor i mbrojtur. E përfshirë në listën e zonave “Ramsar” të ligatave me rëndësi ndërkombëtare, zonë natyrore veçanërisht e mbrojtur si habitat i shpendëve ujorë.

Megjithëse nuk ka një projekt të mirëfillt teknik, nuk ka burim financimi, nuk ka vlerësim të ndikimit në mjedis, përsëri projekti propagandohet të përfundojë në vitin 2024. Objektivi i ndërtimit të urës është përmirësimi i aksesit ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi. Nga ana a Malit të Zi rruga është e ndërtuar deri te Sveti Nikola, po nga ana shqiptare si do të

shkohet deri tek ura, ku është rruga? Po ato 360 mijë turistët e Velipojës, si dhe kur do ta arrijnë urën? Ato 170 mijë turistë të Ulqinit peizazhin që të ofron grykëderdhja e Bunës do ta shijojnë mbi urë, por jo me tej.

Në fillim le të ndërtojmë një urë me projeksione 3D në Facebook, të ratifikojmë një marrëveshje para zgjedhjeve vendore dhe në vazhdim të mendojmë edhe për urën, edhe për rrugën që na çon tek ura, pra do të jetë ashtu siç u reklamua rruga Shëngjin - Rana e Hedhun-Baks Rrjoll, në të cilën që verën e kaluar nuk punohet. Pse janë ndërprerë punimet edhe në këtë segment, kur premtohet se do përfundonte në vitin 2019?

Sot në rendin e ditës kemi edhe një marrëveshje huaje po nga FSHZH-ja për projektin “Zhvillimi i integruar rajonal”. Ku është FSHZH-ja me projektet e premtuara për Shkodrën? Edhe pse në listën e “100 fshatrave turistike”, të përcaktuar nga qeveria shqiptare Drishti dhe Zogaj, dy zona historike e turistike, janë në pritje të investimeve të premtuara. Kalaja e Drishtit mban statusin “Monument kulture” që nga viti 1948. Për rrugën Shirokë – Zogaj tenderi u krye nga FSHZH-ja që në vitin 2021, me një financim të BERZH-it. Në korrik të vitit 2022 shkruhej se jemi në fillim të punimeve, por jemi në prill të 2023 dhe ende asnjë punim nuk ka filluar. Edhe për këtë investim po priten zgjedhjet lokale që të fillojnë punimet?!

Sa i përket projektit të hyrjes së qytetit të Shkodrës, në shtator të vitit 2020 FSHZH-ja hapi tenderin për këtë projekt, por, pa kaluar as edhe një muaj, ky tender u anulua pas një inspektimi të punimeve në bajpasin perëndimor nga Kryeministri. FSHZH-ja e kishte shpallur prokurimin e këtij projekti pa leje.

Premtime pafund u bënë për këtë projekt në fushatën e vitit 2021, por po kalojnë 2 vjet e, përveç reklamave të herëpashershme, me arkitektë të huaj e vizatime të bukura, ky projekt mbetet përsëri në letër.

Kur është parashikuar të realizohet rikostruksioni i rrugës së Dukagjinit? FSHZH-ja, me programin e rrugëve lidhëse rajonale dhe lokale, shpalli fituesin e tenderit në mars të 2022-shit për projektimin e ndërtimit të rrugës Prekal – Qafa e Shoshajt – Lotaj; Lekbibaj – Qafa e Agrit – Ndërlisë.

Ka kaluar një vit, u zhvilluan dy protesta model nga banorët e Dukagjinit, por nuk ka asnjë

shenjë për fillimin e punës për projektimin, e kushedi kur për zbatimin e këtij projekti. Si gjithë të tjerët, edhe ky investim mbetet te premtimet elektorale, ashtu siç ndodhi në vitin 2013, kur u hoqën fondet nga kjo rrugë. Këto janë mundësi ekonomike të humbura për Dukagjinin.

Autostrada adriatiko-joniane, projekti për përgatitjen e projektit preliminar dhe vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social për segmentin e parë Murriqan – Lezhë të korridorit adriatiko-jonian, ka filluar më 15 dhjetor të 2021-it, por para 2 javëve u zhvillua një konsultim publik, përsëri edhe ky para fushatë zgjedhore. Kur do të përfundojë ky projekt, për të cilin kishte vërejtje për ndikimin në zonat që përmblyten, për zgjidhjen e urës mbi lumin Buna, për aksesin e rrugëve ekzistuese të qytetit të Shkodrës me këtë autostradë, për impaktin mjedisor dhe zhvillimor, që kjo rrugë do të ketë në zonat ku do të shtrihet? Kur do të fillojë ndërtimi i këtij segmenti, duke pasur parasysh lidhjen me autostradën e Malit të Zi, si dhe fluksin e lëvizjeve në këtë segment, sidomos gjatë sezonit veror?

Po për bajpasin lindor të Shkodrës kur do të fillojë financimi, një projekt strategjik që shërben për lehtësimin e qarkullimit të hyrje-daljeve të qytetit më të madh në Veri dhe lidhjen kryesore të transportit rrugor të Shqipërisë me BE-në? Megjithëse projekti është i gatshëm që prej vitin 2017 me dy variante, Autoriteti Rrugor nuk e ka në listën e prioritetëve.

Shkodra përmblytet nga kaskada e Drinit si pasojë e mungesës së investimeve në infrastrukturën mbrojtëse dhe shkarkuese. Po për argjinaturat a keni ndonjë premtim? Po për kompensimin e banorëve të zonave që u përmblytën 3 herë gjatë këtij dimri? Nuk është dhënë asnjë lek për përmblytjet e 2018-ës, ndërkohë që vlerësimi i dëmeve ishte 311 milionë lekë; po ashtu nuk është dhënë asnjë lek për përmblytjet e 2021-it dhe vlerësimi i dëmeve ishte 802 milionë lekë.

Shpresë për financim ka vetëm një projekt, ai i pyllëzimit të kurorës së gjelbër të qytetit të Shkodrës, i cili, megjithëse është kërkuar për tetë vjet rresht, asnjëherë nuk u financua, por besoj se do të financohet me fondin e fushatës. Shpresoj që ta realizoni plotësisht pyllëzimin, meqenëse edhe vlera e këtij projekti është sa gjysma e asaj që do të merrni ju në fushatë!

Premtimet elektorale janë të njëjtat, të cilat përsëriten si për çdo fushatë elektorale, por për Shkodrën asgjë nuk ka ndryshuar. Ju mendoni se shkodranët do t'i besojnë rrenat tuaja?! Ata janë të bindur që ju nuk keni asgjë seriozisht kur flitet për Shkodrën. Harrojeni votën e shkodranëve!

Ju faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Koliqi!

Ministrja e Sipërmarrjes, zonja Bilali, ka kërkuar fjalën.

**Edona Bilali** – E mora fjalën jo rastësisht pas fjalës së zonjës Koliqi, një eksperte shumë e mirë e ekonomisë; një partiake edhe më e mirë, por gjërat duhet t'i themi ashtu siç janë! Edhe unë bie dakord me atë çfarë tha zonja Koliqi dhe po e citoj: “Për Shkodrën s’ka ndryshuar asgjë!”. Në fakt, është e vërtetë, për Shkodrën nuk ka ndryshuar asgjë, sepse në 32 vjet Shkodra, në mënyrë të verbër dhe me tifozeri, vendosi të shkojë në një drejtim. Rezultatet dhe faktet, pikërisht mungesa e investimeve, janë tregueset kryesore se ky drejtim ishte mbrapa, ndërkohë jo rastësisht slogani ynë është për të ecur përpara!

Nëse ka një qark, nëse ka një bashki që, në mënyrë të dëshpëruar thërret për ecje përpara, për ecje përpara dhe me marsh shumë të shpejtë, ajo është Bashkia e Shkodrës!

Gjithashtu, bie dakord që problematikat më të mëdha të Shkodrës janë në infrastrukturë. Nuk është rastësi që kandidat të Partisë Socialiste kemi vendosur pikërisht personin që ka ndryshuar faqen e të gjithë Shqipërisë nga ana infrastrukturore, kolegun e deridjeshëm, zotin Beci. Uroj që Shkodra të ketë vizionin ta votojë për të mirën e saj dhe të ekonomisë, me qëllim që ta çojë këtë qytet, ekonominë dhe infrastrukturën e tij përpara!

Duke u kthyer tek ajo që po kalojmë sot, dua të them se si deputete e qarkut të Shkodrës jam shumë krenare për këtë marrëveshje midis dy qeverive, e cila favorizon në mënyrë direkte Bashkinë e Shkodrës.

“Ulqin e Shkodër, vëlla e motër!”- nuk është vetëm slogan, por është tregues i marrëdhënieve të këtyre dy qyteteve ndër shekuj! Lundrimi i dikurshëm me varka me vela dhe më vonë me varka me motor, i ka sjellë gjallëri në atë kohë tregtisë dhe ekonomisë së Shkodrës. Ndërlidhja aktuale e lëvizjes ndërmjet Ulqinit dhe Velipojës është 37 kilometra, ose 90 minuta, ndonëse në vijë

ajrore është më pak se 1 kilometër. Për konfigurimin aktual është e vështirë që turistët t'i konsiderojnë të dyja anët e kufirit për pushim.

Kur u lançua ky projekt nga Kryeministri ne, si shkodranë, sigurisht që ishim skeptikë. Projekte të përmasave të tilla kërkojnë kohë, por padurimi për të parë investime të mëdha në qark, në fakt, justifikohet. Për të treguar një angazhim serioz ndaj Shkodrës qeveria vendosi ta financojë vetë fazën e projektimit, duke shkurtuar edhe kohën midis vizionit dhe prejjes së këtij realiteti të ri. Në më pak se 1 vit nga lançimi i idesë fillestare, sot propozojmë për miratim nisjen e punës për ndërtimin e kësaj ure. Kjo urë bën të mundur që 37 kilometra të reduktohen në 300 metra dhe 90 minuta të shkurohen në 5 minuta!

Ndërlidhja e vijës bregdetare Velipojë-Ulqin, e shoqëruar edhe me lidhjen Shëngjin-Velipojë, do të krijojë një tjetër panoramë për cilësinë e turizmit në plazhin më të mrekullueshëm ranor të Shqipërisë, plazhin e Velipojës.

Si ministre Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, jam entuziaste për ndikimin ekonomik që do të ketë investimi në zonë. Sot vija bregdetare prej 34 kilometrash e Velipojës vizitohet nga 360 mijë turistë dhe 170 mijë turistë vizitojnë sot Ulqinin. Ndërtimi i urës, përveç 500 mijë vizitorëve të Velipojës dhe të Ulqinit, një ofertë e përbashkët dhe e maksimalizuar turistike do të sjellë rezultate të matshme për më shumë turistë nga të dyja anët e kufirit.

Me këtë investim hapet rruga për zhvillimin potencial të produkteve të ndryshme dhe të përbashkëta turistike, bazuar në pasuritë natyrore, vlerat kulturore dhe historike të dy zonave.

Pasuritë e patundshme në Velipojë variojnë sot nga 800-1300 euro metri katror, por pas këtij investimi ato priten që të kenë sërish një hov të ri, po kështu edhe bizneset e tjera të shërbimeve, duke krijuar më shumë vende pune, por edhe duke rritur standardin e shërbimit. Kostoja totale e parashikuar për ndërtimin e kësaj ure është 20 milionë euro dhe vullneti i qeverisë shihet edhe te fakti se sa po bashkëfinancon: jo pak, por 1,5 miliardë lekë!

Jo vetëm si pjesë e qeverisë, por edhe si deputete e qarkut të Shkodrës, ju ftoj, të nderuar deputetë, që ta kalojmë së bashku, edhe me votat tuaja, këtë projektligj. Me këtë rast i japim shansin një menaxheri shumë të mirë, që t'i përfundojë

edhe investimet e përmendura nga zonja Koliqi, të cilat për arsye krejtësisht objektive, por edhe politike, janë sot aty ku janë. Mjafton t'ju jap vetëm një shembull: ju përmendët arkitektë të huaj, unë po përmend zotin Hernandez, është fat për qarkun e Shkodrës, sepse kudo që ai ka prekur me projektet e tij, ai vend ka pësuar transformim jo vetëm ekonomik, jo vetëm social, por të të gjitha formave dhe përmasave.

Nuk është rastësi që projekti i qilimit të qendrës së Shirokës fitoi çmim ndërkombëtar. Teksa qeveria, nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, angazhohet bëjë projekte me studio ndërkombëtare, të cilat vlerësohen me çmime ndërkombëtare, bashkia nuk bën minimumin e asaj që duhet të bëjë: të pastrojë! Sot dalim me grupe vullnetare, edhe me ata aktivistët e patronazhistët e partisë sonë, për të bërë detyrën e bashkisë! Me këtë rast, uroj të votoni zotin Beci më 14 maj!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Ministre!

Zonja Koliqi ka kërkuar fjalën për replikë.

**Emilja Koliqi** – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Nuk është e ndershme, zonja Bilali, që të deformoni kontekstin në të cilin unë u shpreha. Po, premtimet elektorale janë të njëjta për Shkodrën dhe përsëriten në çdo fushatë elektorale, pra ato nuk ndryshojnë për Shkodrën. Në programin e qeverisë për këtë mandat, por edhe në mandatet e tjera theksohej rilindja urbane dhe rilindja rurale, nga të cilat Shkodra prej 10 vjetësh nuk përfitoi asnjë lek. A nuk është Shkodra ajo që kontribuon në prodhimin e brendshëm bruto, a nuk jep kontributin e saj? Pse nuk ka një zhvillim normal dhe të gjithanshëm si për të gjitha qarqet e tjera? Kushtetuta e Republikës votohet për prosperitetin e të gjithë kombit dhe në nenin 18 të saj theksohet: "Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit". A nuk ju duket se ky është një dënim për shkodranët, për bindjet e tyre politike?

Është e vërtetë që ju keni vendosur një përfaqësues tuajin, zotin Beci, i cili ka pasur mundësi që si deputet i mazhorancës, pra që kur ishte këtu deputet, të bënte punë dhe të financonte projektet, por më tepër të jepte edhe votën kundër në momentet kur e shihte që Shkodra ishte e pafinancuar.



*(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj** – Zonja Koliqi, ju lutem, koha për replikë ka mbaruar!

**Emilja Koliqi** – Në buxhetin e të gjitha viteve nuk ka asnjë projekt për Shkodrën...

**Ermonela Felaj** – Faleminderit!

Ju lutem, sepse ju lashë edhe më tepër se koha!

Zonja Zhupa, për çfarë e keni kërkuar fjalën?

Me radhë, sepse unë i kam emrat në ekran, të cilin e keni edhe ju përpara.

**Ina Zhupa** – Faleminderit, e nderuar!

Siç e dini, unë isha regjistruar, por dua vetëm 1 minutë kohë për t'ju thënë...

**Ermonela Felaj** – Jo, nuk e kam emrin tuaj në listën e diskutantëve.

**Ina Zhupa** – Ju kërkoj ndjesë, mendova se isha regjistruar!

Ju kërkoj vetëm 1 minutë kohë për t'ju thënë se Shkodrën nuk e morët dot as me votën...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ermonela Felaj** – Zonja Bilali.

Ju kujtoj që replikë mbi replikën nuk ka.

**Edona Bilali** – Zonja Koliqi jua tha shumë qartë, por po jua citoj prapë: pse Shkodra? Pyetja është pikërisht: pse Shkodra?!

Ju përmendët programin e rilindjes urbane. Shihini sot Malësinë e Madhe dhe Pukën sa kanë përfutuar nga programi i rilindjes urbane. Pse Shkodra është kundërpedal? Pse qeverisja lokale është gjithmonë kundër qeverisjes qendrore? Pse të mos pranojnë dorën e bashkëpunimit, për të cilën ju vetë jeni koshientë sa herë është ofruar nga kjo qeveri? Unë uroj që përgjigjen për pyetjen se pse Shkodra jo, qytetarët e Shkodrës ta japin më 14 maj!

**Ermonela Felaj** – Kolegë, ju lutem, ju që sapo vini, zini vend dhe mbani qetësi që të dëgjojmë fjalën e diskutantëve në vijim!

Fjalën e ka zonja Resulaj.

**Pranvera Resulaj** – Faleminderit!

E nderuar drejtuese e seancës,

Në fakt, si vlonjate, që duhet të flasë për Shkodrën pas dy kolegeve të nderuara të Shkodrës, më duhet t'ju them se e kam një urim, sepse midis Vlorës dhe Shkodrës ka pasur lidhje shpirtërore dhe ekziston një ndjenjë e tillë. Është e vërtetë se nga qeveria shqiptare është investuar në të gjithë Shqipërinë, por investimet e mëdha që janë bërë në Vlorë janë kanalizuar nëpërmjet

bashkëpunimit të fortë që ka pasur me pushtetin lokal. Unë do të uroja që edhe për Shkodrën të investohet dhe të zhvillohet ashtu sikundër edhe Vlorë!

Të nderuar qytetarë,

Të dyja projektligjet, si ai që shqyrtoam pak më parë, për marrëveshjen e huasë ndërmjet qeverisë shqiptare dhe Bankës Gjermane për Zhvillim KfW, por edhe projektligji për ndërtimin e urës ndërkufitare mbi lumin Buna, ndërmjet qeverisë shqiptare dhe Malit të Zi, kanë një qëllim të vetëm: t'i japin fryte bashkëpunimit rajonal dhe të nxisin zhvillimin lokal. Ashtu sikundër është thënë, por edhe siç specifikohet edhe në projektligj, ky propozim synon ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për ndërtimin e urës ndërkufitare mbi lumin Buna.

Nëse do të ngrija pyetjen: pse duhet ky investim dhe kjo urë, përgjigja mund të ishte vetëm me një fjali të thjeshtë: si një bashkim shpirtëror jo vetëm ndërmjet hapësirës fizike, por edhe shpirtërore ndërmjet dy vendeve dhe popujve tanë. Një përgjigje tjetër do të ishte që zonat ndërkufitare në grykëderdhjen e lumit Buna përfaqësojnë një potencial në zhvillimin ekonomik dhe rajonal të turizmit, por që ende mbetet i pashfrytëzuar. Statistikat kanë treguar flukse të konsiderueshme të turistëve në të dyja kahet e lumit Buna. Në fakt, kjo është edhe dinamika e zhvillimit të turizmit, që të bazohet në zhvillimet turistike dypalëshe.

Nuk po u referohem statistikave për flukset turistike, pasi kolegu Koçi i theksoi me detaje pak më parë, por mjafton t'ju them se për 34 kilometra plazh me rërë, që lidhet sot nëpërmjet pikës kufitare të Muriqanit, do të duhen 1 orë e gjysmë për ta përshkruar, por me ndërtimin e kësaj ure distanca për t'u përshkruar do të jetë vetëm 300 metra, pra do të duhen vetëm 5 minuta. Do të jenë thjesht vetëm 5 minuta për ta bërë...

**Ermonela Felaj** – Kolegë të mazhorancës, ju lutem, a mund të mbani qetësi në sallë? Sepse nuk është kaq e vështirë!

**Pranvera Resulaj** – Pra, nga 1 orë e gjysmë, që ishte distanca, do të bëhet vetëm në 5 minuta. Kjo të bën të kuptosh rëndësinë e madhe që ka ndërtimi i kësaj ure.

Sigurisht që ndërtimi i urës shoqërohet me efekte shitesë në buxhetin e shtetit, efekte, të cilat

do të përcaktohen qartësisht nëpërmjet një marrëveshjeje zbatuese. Më duhet ta theksoj se jemi ende vetëm në fazën e projektimit, e cila përcakton edhe kostot specifike që do të shoqërojnë zbatimin e projektit. Kjo marrëveshje zbatuese do të ndiqet mbi projektin e krijuar dhe të hartuar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Palët kanë dakordësuar për bashkëfinancimin e projektit në masën 50%, nga secila palë, duke përfshirë koston totale të ndërtimit. Sigurisht, shlyerja e detyrimit do të bëhet nga buxheti i shtetit ose nëpërmjet një huaje, e cila do të specifikohet në momentin e zbatimit të projektit.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka bërë një vlerësim paraprak të kostove totale për ndërtimin e urës për palën shqiptare, e cila vlerësohet në rreth 1,5 miliardë lekë. Meqenëse jemi te Fondi Shqiptar i Zhvillimit, do të ndalem edhe për pak sekonda, për të ripërsëritur atë që kolegët thanë pak më parë sa i takon rëndësisë së madhe dhe vlerës që ky Fond u ka dhënë investimeve në të gjithë Shqipërinë nëpërmjet mirëmenaxhimit të tyre.

Një prej kolegëve pak më parë përmendi Vlorën, por ndërkohë ne jemi duke folur për investimet në Shkodër. Unë si deputete e kësaj zone nuk jam aspak dakord me atë që theksoi kolegu, pasi në Vlorë nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit janë kryer investime tepër të rëndësishme, që i kanë dhënë jetë dhe zhvillim gjithë kësaj zone.

Sa u takon firmave që nuk kanë përfituar, për të shkuar më tej te menaxhimi i shërbimeve që ne ofrojmë, sigurisht, një agjenci kombëtare e prokurimeve publike nuk mund të përcaktojë nëse do të jetë një firmë fituese nga Vlora, Shkodra apo kudo qoftë, por duhen respektuar kriteret e vendosura aty. Unë si vlonjate do të doja që kompanitë e Vlorës të ishin përfituese të projekteve shumë të rëndësishme të investimeve që përfitojnë rajonet, në rastin konkret në Vlorë.

Në fakt, dua të kaloj te një aspekt tjetër i kësaj marrëveshjeje, sepse, ashtu siç është theksuar edhe në raport, ka një detaj shumë të rëndësishëm, të cilin dua ta përmend për dy arsye.

Marrëveshja ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj malazeze ka filluar apo është ideuar më 3 tetor 2018, nëpërmjet një deklarate të përbashkët, e cila synonte mbështetjen e përpjekjeve të përbashkëta për të përmirësuar aksesin në zonën ndërkufitare të zonave Pulaj dhe

Velipojë për Shqipërinë dhe Shën Koll dhe Ulqin për Malin e Zi. Kjo deklaratë është pasuar me prezantimin në forumin për Ballkanin e Hapur në vitin 2022.

Siç jua thashë edhe pak më lart, janë dy arsye.

Arsyeja e parë është për të kuptuar edhe një herë rëndësinë e madhe që ka për qeverinë shqiptare zhvillimi rajonal jo vetëm duke përfituar akses në potencialet ekonomike, por duke ndikuar në drejtimin e politikave për rritjen e konkurrueshmërisë në rajon, kryesisht nëpërmjet shkëmbimeve ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Nuk është e tepërt të theksoj këtu rolin e madh që ka luajtur Shqipëria dhe qeveria shqiptare për krijimin e një mjedisi konkurrues për zhvillimin ekonomik rajonal, kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve të shkëmbimeve dypalëshe.

E përmenda këtë detaj edhe për një fakt tjetër (u përmend pak më parë këtu, por e kemi theksuar edhe nëpër komisione gjatë diskutimeve që kemi pasur për projektligjet që na kanë ardhur kohët e fundit), sepse shpeshherë thuhet që një projektligj bëhet për efekte elektorale. Kanë kaluar disa muaj që po diskutohet për qëllimet elektorale, por po të kemi parasysh kohën që i duhet një projektligji për të ardhur në parlament, duhet të themi se çdo 6 muaj në 2 vjet nuk duhet të ketë jetë parlamentare dhe parlamenti nuk duhet të funksiononte, sepse të gjitha projektligjet do të quheshin elektorale.

E njëjta gjë është thënë edhe për projektligjin për rritjen e pagave, por kjo ka qenë pjesë e programit të Partisë Socialiste në të gjitha mandatet e saj, kur ka konkurruar gjatë fushatave elektorale. Për hir të së vërtetës, ne nuk kemi nevojë për projektligje elektorale, sepse ne kemi një kontratë të fortë me qytetarët shqiptarë, që ka vetëm një synim, nuk është një mesazh elektoral “vetëm përpara dhe asnjëherë pas”, por është filozofia e qeverisjes që ne kemi.

Ashtu sikundër ky projektligj, që do të sjellë investime të rëndësishme, po ashtu edhe projektligjet e tjera që do të pasojnë do të shoqërohen me një zhvillim ekonomik dhe rajonal, duke pasur si qëllim të vetëm përmbushjen e misionit dhe të kontratës që Partia Socialiste ka me qytetarët shqiptarë.

Sa i takon përbashkës me 14 maj, kjo është një çështje që do ta vendosin vetë qytetarët.

Për këto dhe shumë arsye të tjera do t'i ftoja të gjithë kolegët ta miratojnë projektligjin për t'i dhënë një investim të ri Shkodrës, si dhe për t'u uruar të gjithë shqiptarëve suksese dhe një zhvillim sa më të mirë rajonal!

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Resulaj!

Shoh se kolegët që ishin regjistruar për ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës nuk janë në sallë, kështu që po ia jap fjalën zotit Çelaj.

Të përgatitet zonja Spiropali, e cila do të jetë folësja e fundit për këtë pikë të rendit të ditës.

**Isuf Çelaj** – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar qytetarë të Tropojës, Hasit dhe Kukësit,

Të nderuar kolegë,

Marrëveshja e Republikës së Shqipërisë me Republikën e Malit të Zi për ndërtimin e urës ndërkuftare me fondet e dy qeverive është një veprim, edhe pse jam deputet i opozitës, që e përshëndes. Uroj që kjo të mos mbetet në letër si shumica e marrëveshjeve që ju keni firmosur dhe firmosni vetëm për fasadë propagandistike të stilit tuaj historik, e trashëguar nga ajo që ju përfaqësoni si forcë politike, sepse nga ajo që po shoh sot këtu, po e përdorni vetëm për propagandë elektorale, sepse nuk ka projekt, fonde dhe asnjë gjë.

Dua të shpreh shqetësimin tim si përfaqësues i qytetarëve të Tropojës, që ka të bëjë me moszbatimin e një marrëveshjeje ndërmjet dy qeverive, të Malit të Zi dhe të qeverisë shqiptare, e vitit 2013, për hapjen e një pike të kontroll-kalimit me Malin e Zi në vendin e quajtur Vranicë, në fshatin Çerem të rrethit të Tropojës. Për marrëveshjen e miratuar para 10 vjetësh nga qeveria e Partisë Demokratike, edhe pse kanë kaluar 10 vjet që ju e drejtoni vendin si mazhorancë, nuk e keni vendosur ujin në zjarr për zbatimin e saj. Sa u takon arsyeve për moszbatimin e kësaj marrëveshjeje unë dhe qytetarët e mi të Malësisë së Gjakovës i kemi të qarta, pasi Tropoja, Hasi dhe Kukësi për ju si mazhorancë gjatë këtyre 10 vjetëve janë trajtuar si qytete të dorës së tretë, si dhe me një urrejtje deri në hakmarrje politike ndaj këtyre qytetarëve, për arsyen e vetme se ata nuk ju kanë votuar dhe as nuk do t'ju votojnë si Rilindje.

Shqetësimi im lidhur me moshapjen e kësaj pike të kontrollit të kalimit në Qafë Vranicë në

Çerem ka të bëjë me faktin se kjo pikë ka qenë historikisht e hapur në periudhën e mbretit Zog, deri në vitin 1948, kohë kur u mbyll kufiri me ish-Jugosllavinë. Kjo pikë u shërben mbi 15 mijë banorëve të rrethit të Tropojës, sidomos gjatë periudhës së verës, pasi lidhjet e këtyre zonave janë të forta me zonat shqiptare të Plavës e Gucisë, një prej trevave dhe luginave më të bukura natyrore, por edhe një prej zonave më patriotike dhe qëndrestare sa i takon çështjes së shqiptarisë dhe çështjeve madhore kombëtare. Lidhjet familjare dhe martesat e situara nëpërmjet këtyre zonave janë shekullore. Këto zona, sidomos pas rënies së diktaturës, vizitohen nga një numër i madh turistësh nga e gjithë bota, si nga brenda, ashtu edhe përtej kufirit, kështu që hapja e kësaj pike kontrolli do t'u shërbente shumë banorëve të zonave Plavë, Guci, Martinaj, Vuthaj, Zabel, Hot e të tjera. Këtyre banorëve, në raste vizitash familjare apo të ndryshme, do t'u duhet të bëjnë mbi 200 e ca kilometra rrugë dhe të kalojnë në dy dogana, në atë të Kosovës dhe të Malit Zi, dhe po kaq në kthim, kjo për vetë pozicionin gjeografik që kanë këto dy zona.

Po të hapej pika në qafën e Vranicës, kjo gjë do të bënte të mundur shkurtimin e distancës vajtje-ardhje në më pak se 70 kilometra, duke qenë një lehtësim për këta banorë, gjithmonë nëse qeveria do të kishte menduar për hallet dhe problematikat e këtyre zonave.

Kërkesa ime për Kryeministrin, për ministrat Çuçi dhe Xhaçka, është që të angazhohen për zbatimin e marrëveshjes me Malin e Zi, pasi kjo do të jetë në të mirë të qytetarëve të të dyja shteteve. Por, shpresa që ju do të angazhoheni është thujse zero, pasi, siç jua thashë edhe më lart, për ju këto zona nuk ekzistojnë, sepse nuk mendojnë dhe veprojnë politikisht si ju. Përgjigjen për harresën, varfërinë dhe shpopullimin e Tropojës, Hasit dhe të Kukësit do ta merrni me votë më 14 maj, ditë në të cilën këto bashki do t'u kthehen qytetarëve dhe do të jenë në shërbim të tyre, duke ua hequr nga kthetrat të emëruarve tuaj që i përfaqësojnë këto bashki me veprime abuzive dhe korruptive, ashtu siç është komplet modeli juaj qeverisës. Gjatë 10 vjetëve të qeverisjes suaj zhvillimi në këto zona ka ngelur në vend, ndërkohë që arritja juaj më e madhe është që e keni renditur qarkun e Kukësit në qarkun më të varfër në vend dhe në rajon.

Për të gjitha këto, më 14 maj vota e qytetarëve të Kukësit dhe e gjithë Shqipërisë do t'ju ndëshkojnë për të gjitha ato që i keni shkaktuar vendit, korrupsionin galopant, varfërinë e shtuar dhe shpopullimin.

Faleminderit!

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zoti Çelaj!  
Fjalën e ka ministria Spiropali.

**Elisa Spiropali** – Sot është një ditë e mirë jo vetëm për Shkodrën, por edhe për Shqipërinë, pasi në më pak se 2 muaj nga mbledhja e qeverive, të qeverisë së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, u ra dakord për ndërtimin e urës mbi Bunë. Vjen sot në parlamentin e Shqipërisë, pasi marrëveshja është ratifikuar dje në parlamentin e Malit të Zi, ratifikimi i kësaj marrëveshjeje për të filluar punën për ndërtimin e urës mbi Bunë, e cila do të shkurtojë lidhjen ndërmjet Velipojës dhe Ulqinit nga 73 kilometra në 300 metra. Projekti jo vetëm që ka një simbolikë të fortë të bashkimit të dy qyteteve, të cilat historikisht kanë pasur një lidhje me njëra-tjetrën, por e afron Shqipërinë me Malin e Zi dhe shton mundësitë ekonomike, turistike dhe kulturore të të dyja vendeve, duke pasur parasysh që Velipoja me mbi 300 mijë turistë në vit do të fitojë shumë nga ky afrim për shtuar ofertën e vet turistike dhe konkurrueshmërinë Ulqin-Velipojë, si dhe për t'i dhënë Shkodrës një dimension komplet tjetër sa i takon turizmit.

Sigurisht, ky nuk është projekti i parë dhe as i fundit, por është një ndër projektet që ne kemi në vizionin tonë për ta bërë Shkodrën “zonjë”, ashtu siç e meriton, për t'i kthyer dinjitetin e së shkuarës dhe për ta bërë një kryeqendër larg pjesëmarrjes politike që ia ka marrë frymën për 32 vjet. Ne nuk pretendojmë të jemi çlirimtarë dhe vijmë aty veçse me vullnetin tonë për të sjellë ofertën më të mirë, kandidatit më të mirë, alternativën më të mirë, dhe u takon votuesve shkodoranë të zgjedhin. Nuk u shkon fare përfaqësuesve politikë të Shkodrës në këtë Kuvend, që janë shumë të nderuar, disa prej tyre i njoh personalisht, apo përfaqësuesve të qarkut të Kukësit, dhe të tjerëve, të dalin në këtë foltore dhe të flasin me gjuhë kaq të vjetër, kaq partiake, kaq të politizuar, dhe të mos gjejnë një fjalë të mirë për të thënë për këtë projekt, për këtë marrëveshje, për këtë investim, që është një investim i ndarë mes qeverisë shqiptare dhe qeverisë së Malit të Zi. Pra, është vullneti i të dyja qeverive për të

investuar edhe pse projektin e ka bërë FSHZH-ja. Ne jo vetëm projektin, por edhe projektzbatimin, edhe preventivin i kemi gati, edhe fondin e kemi gati në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, por patjetër që duhet komunikimi, dakordësia për fillimin e punimeve me miratimin nga qeveria e Malit të Zi.

Tani dua të ndalem tek ajo që paska thënë në këtë foltore Sali Berisha në momentin kur unë nuk gjendesha këtu. Sigurisht, historikisht Sali Berisha e çon gjuhën aty ku i dhemb dhëmbi, dhe përmend këtu vrasjet politike, por përveç Sali Berishës dhe Flamurëve të tij, që kthehen nga ia do avazi Sali Berishës, asnjë nuk beson se Edi Rama është vrasës. Nuk ka një njeri në Republikën e Shqipërisë të thotë që Edi Rama ka vrarë kundërshtarët e tij politikë ose Edi Rama është vrasës. Nuk e di nëse thonë edhe për këta, por kjo nuk është detyra ime për ta thënë. Unë nuk e akuzoj Sali Berishën se ka vënë tritol në Vaun e Dejës. Nuk e bëj. Nuk jam si ai, që për çdo ngjarje kriminale në vend, ua drejton në çast gishtin kundërshtarëve politikë, pa pritur deklaratën e policisë, pa pritur hetim të plotë, pa i dhënë mundësinë organeve ligjzbatuese të zbardhin ngjarjen. Jo, nuk jam si ai. Nuk akuzoj Sali Berishën për këtë. Por, që tritoli u largua nga skena politike dhe e fushatave kur iku Sali Berisha dhe është kthyer tani që ai është kthyer në skenën politike, ky është fakt. Unë i kërkoj Policisë së Shtetit, prokurorisë, të gjitha organeve ligjzbatuese të zbardhin ngjarjen e Vaut të Dejës për të mos i dhënë rast dhe mundësi këtij njeriu dhe Flamurëve të tij t'i përdorin ngjarjet kriminale për të shtuar kapitalin e tyre të shterur politik. I ka kapur dëshpërimi patjetër edhe për Vaun e Dejës, edhe për Shkodrën, edhe për kudo. Unë e kuptoj shumë mirë këtë, por që ata duan t'i përdorin këto zgjedhje lokale, duan t'i përdorin bashkitë si pengje për të negociuar me ndërkombëtarët, që t'i marrin dhe të ulen në tryezë më ta, këtë nuk ua ka borxh asnjë bashki. Kandidatët me qira të Ilir Metës nuk e marrin dot peng të ardhmen e Shkodrës, të Vaut të Dejës, por as të Tropojës, as të Kukësit. Këto bashki duan t'i përdorin si pengje të tyre dhe nuk duan t'ia dinë këta as për urën mbi lumin Buna, as për hyrjen e Shkodrës, as për projektet zhvillimore, as se ç'do të bëhet me këto bashki. Këta duan të ngrenë flamurin e tyre të dëshpëruar politik në këto bashki dhe pastaj të thonë: ja e shikoni, ne njerëzit i kemi në xhep.

Shkoi edhe Ilir Meta, se vjen vërdallë andej nëpër qark natën, se ditën nuk del, por me tre njerëz është i rrethuar, tek pullë është. Shkoi nga Puka në Malësi, nga Malësia e Madhe në Shkodër me të njëjtët njerëz, nuk i bëhen katër kurrë, dhe u thotë: ec me zero, se ju kemi ne këtu. Jeni pronë jona, - u thonë njerëzve. Ne nuk u themi njerëzve se janë pronë jona, dhe as që do t'i fitojmë bashkitë me çdo kusht. Ne u themi njerëzve: votoni për më të mirin, votoni për ata që dinë të punojnë, votoni për ata që kanë alternativë për zhvillim. Shikoni si janë transformuar bashkitë e Shqipërisë nën drejtimin tonë! Këta i duan për pengje që t'i çojnë mbrapa, që ta çojnë Pukën aty ku ishte, ta çojnë Malësinë e Madhe në gjendjen e mjeruar ku ishte, edhe Tropojën, edhe Kamzën, dhe të gjitha bashkitë që historikisht i kanë përdorur si mish për top, jo për njerëzit, por për vete. Unë ju them: shkoni e shikojeni sot Kamzën si ka ndryshuar, shihni me dhjetëra shkolla, kopshte dhe çerdhe të ndërtuara. Shkoni e shikoni Pukën, që është bërë një perlë e vogël e Veriut. Shikojeni Malësinë e Madhe. Hapini sytë. Shkoni e shikoni si qeverisim ne dhe si do të qeverisim ne më 14 maj e tutje, ku do t'i çlirojmë bashkitë jo nga Saliu, jo, se më vjen keq ta them që është një hije e së shkuarës, që bashkë me atë tjetrin, që është hija e hijes, duan t'i mbajnë njerëzit peng. Nuk ka pengje sot. Ne do të ecim përpara. Kurrë më mbrapa me ju, deri sa të kuptoni që njerëzit i keni përdorur për vete dhe jo për ta.

Ky projekt sot është historik dhe me të tilla projekte, atë që ju nuk e keni bërë në 30 vjet, do ta bëjmë ne në 4 vjet.

*(Drejtimin e seancës e merr Kryetarja e Kuvendit, zonja Lindita Nikolla.)*

**Lindita Nikolla** - Faleminderit!

Këtu mbyllet kjo pikë e rendit të ditës.

Në fillim të seancës plenare ju njoftova se sot u mbledh Konferenca e Kryetareve, ku u diskutua kërkesa e deputetëve të opozitës së Kuvendit të Shqipërisë për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura nga institucionet shtetërore për verifikimin e projektit dhe të investimit të portit të Durrësit.

Konferenca e Kryetarëve nuk e arriti konsensusin për ngritjen e komisionit, ndaj, përpara se të fillojmë votimin, do të dëgjojmë një folës pro dhe një folës kundër, për jo më shumë se 10 minuta.

Zoti Oerd Bylykbashi, fjala për ju.

**Oerd Bylykbashi**- Faleminderit!

Të nderuar qytetarë që na ndiqni,

Ajo që ndodhi në Vaun e Dejës është akti më i qartë se si një qeveri e koncepton qeverisjen si banditizëm, se vetëm në atë mënyrë mund të hapë fushatën. Por, sigurisht, më 14 maj Vau i Dejës, Shkodra, Tirana dhe Elbasani me radhë do t'ju japin përgjigjen juve.

Nuk po e humbas kohën për këtë pjesë, sepse përtej retorikave boshe, që sapo dëgjuam, sot përsëri ju do ta rrëzoni Kushtetutën, por Kushtetuta e përcakton fare qartë, në mënyrë taksative dhe të padiskutueshme nga ju. Dëgjova sesi, në mënyrë qesharake, Kryetarja e Kuvendit tha se nuk u gjend konsensusi në Konferencën e Kryetarëve për të zbatuar Kushtetutën. Kushtetuta përcakton që, kur janë 35 firma deputetësh dhe kërkojnë komision hetimor, është detyrim. Këtë e ka thënë edhe Gjykata Kushtetuese: është detyrim.

Për turpin tuaj, më 24 dhjetor të vitit 2014, erdhën dy bashkëreporterë për Shqipërinë, nga Parlamenti Europian, për të detyruar mazhorancën tuaj të firmoste një marrëveshje, ajo që njihet si marrëveshja e dekriminalizimit, e cila, në fakt, kishte edhe një pikë tjetër të rëndësishme sipas së cilës qeveria, mazhoranca duhet të respektonte vendimet e Gjykatës Kushtetuese për ngritjen e komisioneve hetimore. Pra, ju duhet të bëni dhe marrëveshje që të zbatoni Kushtetutën, por tani as për këtë nuk pyesni më. E keni ndarë mendjen, votoni, pastaj na thoni: shkoni në Gjykatë Kushtetuese, se e kemi pastruar me vetingun, por, ajo, në fakt, nuk ka këllqe sot të kthejë as aktin më të thjeshtë kundër jush.

Pra, ju po e rrëzoni sërish Kushtetutën sot. Dhe pretendimi është në nivelet e kapërcimit të absurdit, doni të ndryshoni ligjin, paskeni amendamente për të ndryshuar ligjin e komisioneve hetimore. Por, meqë do të bëjmë edhe reformë zgjedhore, pse nuk anuloni edhe zgjedhjet e 14 majit?

Kur të ndryshoni ligjin për komisionet hetimore, zbatoheni, por ligji që është sot në fuqi, është detyrim kushtetues që ju ta ngrini atë komision. Për çfarë? Komision për hetimin e aferës më korruptive dhe skandaloze, të grabitjes së portit të Durrësit, asetit më strategjik që ka Shqipëria jo vetëm në planin ekonomik, jo vetëm

në planin e transportit, por edhe në atë ushtarak. Atë ju ofrojmë ne, nuk ju ofrojmë gjë tjetër.

Pra, ju vazhdoni me këtë argument absurd se do të ndërtoni ligjin, por për një arsye të vetme se doni të mbulonit këtë aferë. Po le të marrim disa elemente: në vitin 2019 ka mbaruar studimi i fizibilitetit për rikonstruksionin e portit të Durrësit, i financuar me grante nga shtetet e BE-së: Austria, Franca, Italia, Luksemburgu, Norvegjia, Polonia, Sllovenia dhe Suedia. Pra, institucione prestigjioze ndërkombëtare kanë financuar. E gjithë vlera shkon 63 milionë euro, që ishte investimi për ta rikthyer portin e Durrësit në kapacitet të plotë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ky është dokumenti. Sipas këtij projekti do të rritej kapaciteti nga 850 mijë tonë në vit, në 1 milion e 300 mijë tonë në vit; nga 400 mijë pasagjerë dhe përdorues në 1 milion e 300 mijë përdorues të portit të Durrësit në vit. Po mirë, si ka mundësi që këto shtete investuan gjithë këto para? Janë 29 milionë euro grante dhe 25 milionë euro kredi, prej të cilave mbi 25 milionë ne duhet t'i paguajmë ende sot. 9 milionë euro i ka investuar qeveria shqiptare. Paratë e taksapaguesve janë investuar, janë harxhuar dhe sot i keni hedhur në kosh. Po pse janë bërë të gjitha këto investime? Përgjigja është shumë e thjeshtë: po, ky dokument e thotë që porti i Durrësit është një nga portet më të mëdha në Adriatik dhe një nga portet më strategjike, me një rëndësi të jashtëzakonshme, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për rajonin. Rikonstruksioni i atij porti do të sillte në mënyrë të padiskutueshme fuqizimin e pozitës sonë strategjike, ekonomike, në transport, por edhe ushtarake. Është këtu në këtë dokument.

Çfarë thotë tjetër ky dokument? Në fundin e vitit 2020, në dhjetorin e vitit 2020 do të fillonin punimet për rikonstruksionin e portit të Durrësit. Çfarë ndodhi? Në dhjetorin e vitit 2020 ju miratuar marrëveshjen me Emiratet e Bashkuara Arabe. Është sjellje tipike prej atyre që quhen *rogue state*, apo *stato canaglia*, tani përkthejeni si të doni ju, por minimumi jeni shtet i pabesë. Pse? Sepse bëni marrëveshje, angazhoni, kontrakti, dhe, më pas, pa njoftuar, prishni edhe marrëveshjet. Kjo është arsyeja pse në një letër, me të cilën ju është përgjigjur, Komisioneri Varhelyi, thotë se u detyruam ta anulojmë atë fond, sepse ndryshoi projekti, ndryshoi

destinacioni. Pra, ndërkohë që duhet të fillonte zbatimimi, në atë moment, ju e prishët marrëveshjen. Pse? Sepse është historia gjigante e vjedhjes dhe e grabitjes së asetit më të madh. Kam dëgjuar një intervistë të Alabarit që thotë se si transparenca e qeverisë shqiptare nuk kam parë. Sigurisht është transparenca tipike e pazareve *medioorientale*, kokë më kokë, sy më sy, sepse biem dakord, shtrëngojmë dorën, shkëmbejmë atë që kemi për të marrë dhe kjo quhet transparençë. Ajo që kërkon MSA-ja është një gjë krejt tjetër, është konkurrencë e hapur për të gjithë, është kometicion dhe mbi atë del më e mira. Pra, çfarë kemi sot ne? Kemi pazarin përballë konkurrencës. Ju keni bërë pazarin. Kemi rryshfetin përballë interesit publik. Është edhe më keq sa kaq, do ta them me shifra, nuk është thjeshtë rryshfet, por është fjala më *mediorinetale* që ju përshtatet juve, Kryeministrit, keni pushtetin autokrat, që vendos si i do qejfi përballë ligjit dhe detyrimeve ndërkombëtare.

Në vitit 2020 do të niste projekti, por ju në vitin 2020 e prishët marrëveshjen që kishit, pa i njoftuar financuesit dhe donatorët, të cilët detyrohen ta anulojnë dhe të thonë se jemi të shqetësuar për MSA-në, se do të bëjmë kujdes herë tjetër, por këto para do t'i marrim dhe do t'i zhvendosim diku tjetër.

Tani për të kuptuar pse ju e bëni gjithë këtë. Këtu janë të dhënat, ju e bëni se do të ndërtoni 1 milion e 264 mijë metra katrorë apartamente; do të ndërtoni 47591 metra katrorë hoteleri, 47591 metra katrorë dyqane. Se çfarë lidhjeje kanë këto me portin? Nuk kanë fare, zero. Ju tregoni njerëzve modele marketesh që do të ndërtohen pas 20 vjetësh, por në krye të 2-3 vjetëve porti i Durrësit ka vdekur, sepse edhe hyrja e tij do të bllokohet me ndërtime. Çfarë keni bërë ju? Financimi nga aksionerët është vetëm 80 milionë euro, financimi bankar 80 milionë euro. Ky investitori privat pjesën tjetër do ta marrë lekë më lekë nga qytetarët. Pra, ju po vrisni portin që edhe BE-ja thotë se është strategjik jo vetëm për Shqipërinë për një histori pazari transparente midis Edi Ramës dhe Alabarit. Po sigurisht nuk mund të fitojë Alabari. Çfarë? 300 milionë euro është investimi i shtetit shqiptar në këtë histori korruptive. Po sa fiton mbrapsht? 282 milionë. Pra, del me humbje shteti shqiptar. Ndërkohë privati harxhon 80 milionë euro nga të vetat, 80 milionë ia merr bankës, pra 160 milionë gjithsej,

një pjesë të kredisë ia paguan shteti shqiptar, interesat, dhe në fund fare fiton 572 milionë euro. Pra, e ka normën e fitimit 494%. A mendoni ju se në këtë histori transparence pazari midis Edi Ramës dhe investitorit arab, kjo përqindje 494% i shkon në xhep Alabarit? Ne këtë kërkojmë të hetojmë për të dalë llumi i zi nga fundi i atij baseni, atij porti në këtë histori që ju po stisni, por ju e bllokoni. Arsyeja jonë është shumë e thjeshtë: ju duhet të bllokoni një nga marrëveshjet më korruptive që kanë ndodhur. Jo vetëm kaq, ju e rrëzoni këtë. Por ne do ta çojmë në Gjykatë Kushtetuese, sepse jemi para shkeljes edhe të kushtetueses, edhe të stabilizim-asociimit.

Por ajo që duhet të kuptojnë shqiptarët është që jua ka ulur kokën dhe ju detyron të bëni çdo gjë që ai do për fitimin e tij. Pse? Sepse më pas do të rishpërndajë para për të blerë vota. Në qytetin e Durrësit ka vetëm një gjë, e cila argumenton se ndoshta ju fitoni, paratë, të fortët, pushteti, asgjë tjetër.

Më 14 maj durrsakët do t'jua japin pazarin për këtë histori, por unë besoj se më 14 maj ju do ta merrni pazarin edhe në Shkodër, edhe në Elbasan, edhe në Tiranë, dhe në të gjithë Shqipërinë.

**Lindita Nikolla- Faleminderit!**

Kush e do fjalën për mendimin kundër? Zoti Balla.

**Taulant Balla-** E bëmë një diskutim në Konferencën e Kryetarëve, por po u rikthehem disa prej çështjeve që konstatoam në vlerësimin formal të kësaj kërkesë.

Zonja Kryetare,

Kolegë deputetë,

Është hera e disatë që nga opozita vijnë kërkesa, të cilat në formë, pa hyrë në përmbajtje, kanë probleme të rënda të integritetit të dokumentacionit të paraqitur.

Kërkesa është depozituar në datën 6 prill të vitit 2023, sipas numrit të protokollit 1224. Pasi paraqitet kërkesat, te grupi i deputetëve emri i parë është i Belind Këlliçit, i cili në ditën e parashtrimit të kërkesës kishte 8 ditë që kishte dhënë dorëheqjen nga mandati i anëtarit të Kuvendit të Shqipërisë. Pastaj, me sy të lirë shikon që edhe deputeti Luçiano Boçi, 8 ditë përpara depozitimit të kësaj kërkesë, kishte dhënë dorëheqjen. Nuk i hyj fare numrit nëse është apo nuk është 1/4-ta e anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë, këtu vihet në diskutim integriteti i një

dokumenti që vjen në Kuvend. Dhe nuk është hera e parë, është hera e disatë. Para disa javësh na u desh të shqyrtonim një kërkesë të firmosur nga deputetë, të cilët, në momentin e depozitimit të kërkesës, nuk gjendeshin në Shqipëri, dhe në asnjë moment nuk u dha asnjë shpjegim se si ka mundësi që ndodh kjo në një dokument zyrtar, sepse ne mbajmë përgjegjësi, jemi zyrtarë të Republikës së Shqipërisë, mbajmë përgjegjësi kur hedhim firmën, për të mos thënë këtu që ka edhe deputetë që përbri emrit të tyre firmosin dy herë dhe në secilën prej herëve ndryshe. E keni këtu në dokument.

Prandaj, të dashur kolegë, përveç pjesës formale, mendoj se kërkesa duhet të ishte rrëzuar, duhej të mos ishte pranuar që në momentin e depozitimit. Megjithatë, kjo është një çështje që e diskutuam në Konferencën e Kryetarëve.

Sot vihet me një kërkesë që të verifikohet zbatimi i ligjit, pra ligjshmëria e një kontrate, e cila është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, në mos gaboj, më 24 nëntor të vitit të kaluar dhe ka hyrë në fuqi diku nga mesi i muajit dhjetor, pas dekretimit nga ana e Presidentit të Republikës.

E para, Kuvendi ka një praktikë të konsoliduar, për sa i përket qasjes që ka ndaj komisioneve hetimore për çështje që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë, sepse ju kërkoni, në fakt, në një formë të çuditshme, të hetoni se çfarë ka miratuar Kuvendi. Kuvendi ka miratuar një ligj dhe ligji është i detyrueshëm për t'u zbatuar.

E dyta, nuk është hera e parë, por prej disa muajsh Kuvendi tashmë ka ngritur një komision të posaçëm për hartimin e ndryshimeve në ligjin për komisionet hetimore, si detyrim i Kuvendit përkundrejt vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Kompetenti tha këtu se po shkelet Kushtetuta. Është detyrimi i Kuvendit që vendimet e Gjykatës Kushtetuese t'i transpozojë në legjislacionin dytësor dhe prandaj është detyrim i Kuvendit të Shqipërisë që komisionin e posaçëm ta vazhdojë. I kam kërkuar zotit Alibeaj, si kryetar i Partisë Demokratike dhe si kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, të sjellë anëtarët në këtë komision. Ne jemi të gatshëm që puna të përmbillet brenda një afati të shkurtër, por transpozimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese te ligji për komisionet hetimore duhet të ndodhë.

Pastaj, sa i përket të gjithë asaj që keni sjellë këtu, keni marrë dhe keni përmbledhur të gjithë baltën që hodhët në komisione, që hodhët në

seancë plenare, kundër një prej investimeve më të rëndësishme që kanë ndodhur në Shqipëri në 30 vjetët që kaluan dhe në 30 vjetët që do të vijnë.

Sa për pazare dhe për hesape, unë sot po ju them vetëm kaq: ju duhet të vini këtu dhe të angazhoheni me deklaratimet tuaja, që të njihni rezultatin e zgjedhjeve të 14 majit, sepse rezultati i zgjedhjeve të 14 majit në Durrës do të jetë një ndër rezultatet më të mira që do të marrë Partia Socialiste dhe prandaj mirë është që edhe ndonjë nga ju këtu të vijë me ne, të ecim përpara, sepse nuk ka më kohë ta kthejmë kokën pas!

Faleminderit!

Në përfundim, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste do të votojë kundër kësaj kërkesë.

**Lindita Nikolla** – Zoti Bylykbashi, nuk ka debat tani! E kërkon fjalën për procedurë? Dakord, urdhëroni!

**Oerd Bylykbashi** – Zonja Kryetare,

“Dokumenti” nuk është dokument, por është një listë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po kështu e kupton, nuk ia zgjidh dot problemin e mungesës kronike dhe të thellë të kompetencës!

“Dokumenti” nuk është dokument, por është një listë me firma. Kushtetuta...

*(Debate pa mikrofon)*

**Lindita Nikolla** – E di unë sesi e zbatoj Rregulloren! Ju lutem, mos flisni të gjithë nga vendi!

**Oerd Bylykbashi** – Zonja Kryetare, a mund t’u kërkoj të mos flasin?

Unë po them këtë gjë: janë 35 firma deputetësh të parlamentit shqiptar, të cilët kërkojnë ngritjen e komisionit dhe çdo gjë tjetër që dëgjua këtu është karagjozllëk.

Çështja tjetër: në atë kërkesë kërkohet zbatimi i ligjit që është sot në fuqi. Se çfarë do të ndryshojë ligji në të ardhmen, duhet ta shohim!

**Lindita Nikolla** – Zoti Bylykbashi, i thatë një herë këto. Ju lutem, mos përsërisni fjalën tuaj!

**Oerd Bylykbashi** – Zonja Kryetare, a mundem ta përfundoj?

**Lindita Nikolla** – Përfundojeni, pra!

**Oerd Bylykbashi** – Ajo që ngrihet sot është antikushtetuese dhe ka një qëllim: të mbulojë vjedhjen skandaloze të portit të Durrësit, për llogari të Edi Ramës dhe të atyre që janë pas tij.

**Lindita Nikolla** – Atëherë, jeni gati për votimin?

*(Debate pa mikrofon)*

**Taulant Balla** – Më falni! Meqenëse një pjesë e kolegëve deputetë që presin të bëjnë betimin ka mbërritur, edhe dokumentacioni nga KQZ-ja ka mbërritur, të bëjmë 5 minuta pushim, që Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin të ketë mundësinë ta shqyrtojë dhe kolegët të bëjnë betimin.

**Lindita Nikolla** – Atëherë, bëjmë 5 minuta pushim.

*(Pas pushimit.)*

Ju njoftoj se nga KQZ-ja janë depozituar në Kuvend vendimi nr.347, datë 13.4.2023, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, të qarkut të Elbasanit, zotit Shkëlqim Shefqet Bullari; vendimi nr.348, datë 13.4.2023, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të “Partisë Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, të qarkut të Tiranës, zotit Asllan Shaban Dogjani; vendimi nr.349, datë 13.4.2023, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të “Partisë Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, të qarkut të Shkodrës, zotit Ludovik Stak Hasani; vendimi nr.350, datë 13.4.2023, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të “Partisë Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, Partia Republikane e Shqipërisë, të qarkut të Elbasanit, zotit Qani Rexhep Xhafa.

Në mbështetje të nenit 13 të Rregullores, sot është mbledhur Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin për të verifikuar mandatet e deputetëve të zgjedhur nga KQZ-ja. Raportin do ta paraqesë zonja Ermonela Felaj.

**Ermonela Felaj** – Faleminderit, zonja Kryetare!

Në fakt, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin sapo u mbledh dhe po ju paraqesim në mënyrë të përmbledhur një raport të këtij Këshilli, që lidhet me verifikimin e mandateve të deputetëve, të cilët u nominuan nga ana e Kryetares së Kuvendit.

Kuvendi, në mbështetje të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për ta njoftuar për vakancat e krijuara, pas dorëheqjes nga mandati i deputetit të ish-



kolegëve deputetë, zotërinjve Besion Ajazi, Belind Këlliçi, Luçiano Boçi dhe Zef Hila. Për shkak të njëhimit të vakancave, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimet nr. 347, nr.348, nr.349, nr.350 të datës 13 prill, ua ka dhënë mandatin deputetëve kandidatë vijues të listës shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, të koalicionit të “Partisë Demokratike-Aleanca për Ndryshim” dhe të koalicionit të “Partisë Demokratike- Aleanca për Ndryshim”, Partia Republikane e Shqipërisë. Përkatesisht, u është njohur mandati i deputetit zotit Shkëlqim Bullari, zotit Asllan Dogjani, zotit Ludovik Hasani dhe zotit Qani Xhafa.

Pas verifikimit që i është bërë mandatit të fituar dhe krahasimit me legjislacionin e aplikueshëm për secilin nga kandidatët, rezulton se vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka respektuar kërkesat e parashikuara në disa nene të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përkatësisht në nenet 69, 70 dhe 71.

Për sa i përket procedurës së dhënies së mandatit, është respektuar edhe pika 2 e nenit 164 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas të cilit mandati i ndërprerë i kalon kandidatit vijues të listës të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, si dhe është ruajtur ndërkohë edhe balanca e gjinisë më pak të përfaqësuar.

Në konkluzion, për sa më sipër, Këshilli vlerësoi se për deputetin, zotin Shkëlqim Bullari, për të cilin njoftohem se është prezent sot, nuk rezulton asnjë paligjshmëri në zgjedhje që ta pengojë atë të bëjë betimin në seancë plenare. Në fakt, shkaqe papajtueshmërie nuk ka as për deputetët e tjerë. Për pasojë, meqenëse zoti Bullari është këtu, më duhet të them, në emër të Këshillit, se ai e ka fituar mandatin e deputetit, sipas pikës 1 të nenit 4 të Rregullores së Kuvendit, dhe ftohet në seancë plenare për të bërë betimin, si kusht për të filluar ushtrimin e mandatit të deputetit.

Ju faleminderit, kolegë!

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po jemi në proces tani! Urdhëro!

**Oerd Bylykbashi** – Zonja Kryetare,

Momenti i betimit të një deputeti është momenti më solemn kushtetues që kanë ky deputet dhe parlamenti i Shqipërisë. Si rregull,

këtu duhet të ishin të ftuar, duhet të ishin prezentë deputetët të cilët nuk janë njoftuar. Sapo verifikuam se të paktën një nga deputetët që ju përmendët nuk është njoftuar për të qenë prezent dhe kjo ndodh kur, krejtësisht në shkelje të procedurës, futet një procedurë e paparashikuar më parë. E përsëris edhe një herë që është moment solemn kushtetues, si për parlamentin, edhe për deputetin, dhe nuk i keni njoftuar. Procedura për betimin e deputetëve nuk është se ju duhet juve, si numër, për të votuar një ligj apo një tjetër, por është një procedurë e cila duhet respektuar, sepse kështu respektohet Kushtetuta.

**Lindita Nikolla** – Faleminderit!

Në mbështetje të nenit 72 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 4 të Rregullores së Kuvendit, ftohet zoti Shkëlqim Bullari për të bërë betimin.

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 4 të Rregullores së Kuvendit unë do të lexoj tekstin e betimit, ndërsa ju do të ngriheni në këmbë dhe në fund do të deklaroni: “Betohe!”.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Teksti i betimit është: “Betohe me nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën si deputet i popullit në Kuvend, do të përfaqësoj denjësisht popullin, do t’u bindem Kushtetutës dhe ligjeve, do të mbroj lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë, do të respektoj dhe do të mbroj të drejtat dhe liritë e shtetasve dhe do të punoj me të gjitha fuqitë e mia për përparimin e atdheut dhe mirëqenien e popullit tim”.

**Shkëlqim Bullari** – Betohe!

**Lindita Nikolla** – Punë të mbarë dhe suksese!

Kalojmë në procesin e votimit.

Hapet votimi për prezencën.

Ju lutem, votoni për prezencën!

Mbyllet votimi.

Janë 71 deputetë prezentë.

Vazhdojmë me projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Procedura e votimit: 2 votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 65 vota pro, 6 kundër, 1 abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen me karton, sipas variantit të komisionit.

Raportin e komisionit përgjegjës, me ndryshimet përkatëse, e keni në faqen e Kuvendit.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?  
Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?  
Miratohet.

Përpara se të fillojmë votimin e nenit 3, në bazë të nenit 76 të Rregullores, do të votojmë amendamentet e zotit Fadil Nasufi, për disa shtesa në ligj. Pas pikës 2 shtohet një nen i ri. Në bazë të pikës 3 të nenit 75 të Rregullores, autori i amendamentit ka të drejtë ta paraqesë atë për jo më shumë se 7 minuta.

*(Debate pa mikrofon)*

**Fadil Nasufi** – Atëherë, lidhur me ndryshimet që paraqiten në projektligjin për mediet audiovizive, pas nenit 2 të projektligjit të shtohet neni 3, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Pika 3 e nenit 8 ndryshon si më poshtë: “Kryetari dhe zëvendëskryetari i AMA-s janë me kohë të plotë dhe pagat e tyre caktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”. Shpërblimi i 7 anëtarëve për çdo mbledhje është në masën 20% të pagës së kryetarit. Shpërblimi përfitohet për jo më shumë se 3 mbledhje në muaj, me kusht pjesëmarrjen në to””.

Në nenin 3 të projektligjit, i cili, me shtimin e nenit 3, do të bëhet neni 4, shtohet pika 3 me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Pas pikës 18 shtohet pika 19, me këtë përmbajtje: “AMA përcakton përbërjen, detyrat dhe shpërblimin e sekretariatit teknik, i cili ngrihet në funksion të mirorganizimit dhe të mbarëvajtjes së mbledhjeve të saj””.

Nuk po bëj komente, për arsye se edhe në fjalën time e sqarova domosdoshmërinë, për peshën që AMA ka për të qenë institucion kushtetues, sepse ka një trend detyrash dhe funksionesh, të cilat, edhe amendamentet e sotme, në zbatim të transpozimit të dispozitës, e fuqizojnë rolin e saj, edhe me shpërblimin e anëtarëve, sipas nenit që unë propozova.

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – Atëherë, hedhim në votim amendamentin e parë.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 64 vota pro, 6 kundër, 1 abstenim.

Miratohet.

Kalojmë tek amendamenti tjetër, për një shtesë në nenin 3 të projektligjit.

Hedhim në votim amendamentin.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 65 vota pro, 1 kundër, 1 abstenim.

Miratohet.

Vazhdojmë votimin me karton.

Neni 3. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

*(Nenet nga 4 deri te neni 18 u miratuan me të njëjtën procedurë votimi.)*

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 65 vota pro, 7 kundër, asnjë abstenim.

Projektligji miratohet.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), (“Agjencia e zbatimit të projektit”), për projektin “Zhvillimi i integruar rajonal””. Ky akt kërkon shumicë absolute votash për miratim.

*(Ndërrhyrje pa mikrofon)*

**Taulant Balla** – Për projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW-së, si dhe për marrëveshjen me Malin e Zi për ndërtimin e urës mbi Bunë, do të kërkoja shtyrjen në seancën pasardhëse, sepse do të kisha dashur që për të dyja marrëveshjet Kuvendi të kishte një shumicë deputetësh, pra të ishte e gjithë opozita prezente bashkë me ne.

**Lindita Nikolla** – Votojmë me karton propozimin për shtyrjen.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te projektvendimet.

Projektvendimi “Për miratimin e fondit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: 1 votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 67 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Projektvendimi miratohet.

Projektvendimi "Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura nga institucionet shtetërore për verifikimin e projektit dhe të investitorit të portit të Durrësit, për negocimin dhe ruajtjen e interesit publik, si dhe lidhjen e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Eagle Hills Real Estate Development, Albania Seaports Development Company sh.a. dhe Nshmi Development L.L.C". Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur.

**Sekretare e Sekretariatit për  
Procedurat, Votimin dhe Etikën  
Klotilda Bushka**

**Drejtoreshë e Shërbimit të Redaktorëve  
Suela Bala**

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 7 vota pro, 65 kundër, asnjë abstenim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, shpjegim për votën pro nuk ka, shpjegohet vetëm vota kundër.

Faleminderit!

Të regjistruar për çështje jashtë rendit të ditës nuk ka.

Këtu mbyllet seanca për sot.

Për seancën e radhës do të njoftoheni.

*(Seanca u mbyll në orën 15:30)*

**Kryetarja e Kuvendit**

**Lindita Nikolla**